

Maj 2017
Numri: 110
E përmuajshme

Revistë edukative-kulturore - www.revistaetika.com

ETIKA

Shqipëri: 200 Lekë
Kosovë: 1.5 Euro
Maqedoni: 90 Den
Evropë: 7 Euro



**Pasha qiellin
plot yje!**

*Shtëpia botuese Progresi
vjen me 6 libra të rinj, të cilët
do të ushqejnë botën tonë shpirtërore
dhe do t'i japin drejtim jetës sonë
individuale dhe shoqërore.*

TË
RINJ

Një këshillë
1001 mësimë
350 Lekë
3 Euro



Si edukonte
Ai (s.a.v.s.)
150 Lekë
1 Euro



101 Parime
në shërbim
200 Lekë
1.5 Euro



Shoqetësimi
për brezat
200 Lekë
1.5 Euro



Udhëtimi
drejt Zotit
200 Lekë
1.5 Euro



Shërbimi
200 Lekë
1.5 Euro

Maj 2017

VITI: XI

NUMRI: 110

BOTUESI

Shtëpia botuese "Progresi"

DREJTOR

Albert Halili

KRYEREDAKTOR

Alban Kali

REDAKTOR

Zija Vukaj

PËRKTHYES

Albert Halili

Fatmir Sulaj

Ilir Hoxha

DIZAJN

Bledar Xama

ADRESA

Rr: Studenti; Sheshi "2 Prilli"

Shkodër; Shqipëri

MOBILE

+355 67 340 6182

E-MAIL

rev.etika@gmail.com

WEBSITE

www.progresibotime.com

KOSOVË

Rr: Ardian Zurnaxhiu; pn. Ralin

Prizren; Kosovë

Mob: +377 45 639 143

Prishtinë; Kosovë

Mob: +377 44 566 577

MAQEDONI

Drvarska 28; Stara Carsija

Skopje; Makedonija

Mob: +389 7042 8245

Mob: +389 7145 6003

ABONIMI VIJETOR

Shqipëri: 2000 lekë

Kosovë: 15 Euro

Maqedoni: 900 Denar

Evropë: 80 Euro

Arsyeja se përse Zoti ynë na krijoi, dihet. Ai dëshiron që ne të bëhemi robër të Tij. Ai kërkon devotshmëri edhe prej atij që krijoi në shkretëtirë, edhe prej atij që krijoi në qytet. E njëjta gjë vlen edhe për ata që janë krijuar në të shkuarën, edhe për ata që krijohen sot. Allahu ka kërkuar të njëjtën gjë, si prej bijve të profetëve, ashtu edhe prej atyre që nuk i kanë ditur emrat e baballarëve të tyre. Të qenit rob, është e përbashkëta e çdo njeriu. Të jesh rob dhe të veprosh si rob, është një realitet prej të cilit askush nuk bën përjashtim. Nëse të gjithë njerëzi do të jetonin si robër të Allahut, duke bërë atë që duhet, pa bërë dallim në hapësirë dhe kohë, ata do të realizonin qëllimin e krijimit të tyre në këtë botë.


Ndërsa cilësia e robërisë që kërkon të shohë prej nesh Allahu i Madhëruar, i Cili na krijoi si robër të Tij, mund të quhet robëri, vetëm atëherë kur të jetë ashtu siç e kërkon Ai. Përcaktimi nga ana jonë si robër, i një forme të zbatimit të robërisë, është vetëm një punë e padobishme. A është e mundur që ne si robër të vendosim standardet dhe detajet e zbatimit të robërisë ndaj Allahut? Padyshim se kjo pyetje nuk mund të marrë tjetër përgjigje përveç fjalës "kurrë". Popujt që kanë jetuar para nesh, për shkak se kanë tentuar të vepronë në këtë mënyrë, tashmë kanë mbetur vetëm si pjesëtarë të një feje të devijuar. Formën e robërisë, e përcakton vetëm Ai që e ka urdhëruar atë. Kjo është e natyrshme.

Zoti ynë, me anë të librit të Vet që na ka zbritur, Kuranit dhe shpjeguesit të Kuranit, që janë hadithet e Profetit të Tij (a.s.), na e ka përcaktuar qartë se çfarë lloj robërie dëshiron prej nesh. Nisur nga kjo, të gjitha urdhrat dhe ndalesat që na ka vënë përpara libri ynë, Kurani Fisnik, janë lista e plotë e atyre që kërkohen prej nesh. Po ashtu, urdhrat e Profetit tonë (a.s.), ndalesat dhe të dhënat lidhur me mënyrën e tij të jetesës që kanë ardhur deri tek ne, janë përmbledhja e të gjitha informacioneve se çfarë dhe si duhet të jetë robëria jonë ndaj Allahut. Për rrjedhojë, ne si besimtarë, e kemi për detyrë t'i mësojmë nga këto burime detajet e atyre që priten prej nesh dhe t'i jetojmë ato në mënyrën më të bukur.

Ky është edhe kuptimi i thirrjes së ezanit në mes të shkretëtirës kur i vjen koha. Ky është edhe kuptimi i zbritjes me ashensor prej ndërtesave të larta në mes të qytetit për të shkuar në xhami në faljen e namazit. Kjo është arsyeja që e falim namazin edhe kur jemi duke udhëtuar me aeroplan apo kur shqetësohemi për namazin edhe kur gjendemi në spital në sallën e reanimacionit. Me këtë lloj botëkuptimi sipas kohës së namazit, përcaktojmë edhe udhëtimet, punët, mbledhjet apo dasmat tona. Ne e dimë mirë se namazi, është më lart se çdo kohë dhe çdo vend, sepse namazi është urdhri i Zotit tonë. Dhe, urdhri i Zotit tonë, është i vetmi dhe i pari në çdo kohë dhe vend që ka krijuar Ai.

Ju bëjmë të ditur se materialet e sjella në redaksi pavarësisht nëse botohen apo jo nuk i kthehen autorit. Koha e botimit të një materiali përcaktohet nga redaksia. Honoraret e shkrimeve autoriale ose përkthimeve duhet të vini t'i tërhiqni pranë Shtëpisë Botuese "Progresi" ose pranë zyrave të përfaqësimit në Kosovë dhe Maqedoni.

Përmbajtja



Marrëdhënia e umetit
me sunetin e Muhamedit (a.s.)
Prof. dr. Ismail Lutfi Çakan

10



Halid-i Bagdadi
Osman Nuri Topbash

34



19



46

Allahu ma dërgoi Islamin në shtëpi
Linda Delgado (Widad)

- 5 Të kapesh pas vegës së Islamit
Murat Kaja
- 7 Agjërimi i zembrës
Sulejman Derin
- 12 Zekati dhe edukata
Xhafer Durmush
- 16 Malli për vëllazëri
Ali Riza Temel
- 19 Duaja
Sadik Dana
- 20 A është globalizmi i mirë
për botën myslimane?
Abdullah Rinat Muhametov
- 22 Të jesh rob i Allahut
Nuredin Jëlldëz
- 24 Maj 1453
Dr. Ardian Muhaj



28

- Namazi, marrëdhënia ndërmjet Allahut dhe njeriut 26
Doç. dr. Kerim Bulladë
- Agjërimi si kurë ndaj kancerit 28
Mikro Univeris
- Një Ajet 30
- Një Hadith 32
- El - Aziz 40
Ilir Hoxha
- Ebul Hasan En-Nedvi 42
Personalitete botërore Islame
- Diagnoza dhe kurimi 49
Idris Arpat
- A ka njeri që dëshiron të më kuptojë? 52
- Urtësi 55
- 10 Përgëzime 56
Naim Drijaj



Begatia dhe fuqia e një rekati namaz
Xhemal Nar

44



Jeta e yjeve dhe vrimat e zeza
Elsad Cukali

58



Të kapesht pas vegës së Islamit

Murat Kaja

Kajs bin Ubad, tregon:

“Isha ulur në xhaminë e Medinës. (Aty ku ndodhesh, kishte edhe disa prej sahabëve të Profetit tonë -a.s.-) Atë çast hyri një person, në fytyrën e të cilit vërehej përkushtimi. Xhemati tha:

«Ky është një njeri prej banorëve të Xhenetit!»

Ky njeri fali dy rekat namaz duke lexuar lehtë Kur'an, pastaj doli dhe iku. Unë e ndoqa dhe i thashë:

«Kur hyre në xhami, njerëzit thanë se ti je prej banorëve të Xhenetit!»

Pas kësaj, personi në fjalë më tha:

«(Subhanallah!) Vallahi, askujt nuk i ka hije të thotë atë që nuk e di. Po të tregoj pse e thonë ata këtë: Në kohën e Rasulullahut (a.s.), pashë një ëndërr dhe ia tregova atij. Në ëndërr e pashë veten në një kopsht. (Abdullahu (r.a.), tregoi gjerësinë, gjelbërimin dhe bukurinë e kopshtit). Në mes të kopshtit ndodhej një shtyllë prej hekuri. Pjesa e poshtme ndodhej në tokë, ndërsa pjesa e sipërme, në qiell. Në majë të shtyllës gjendej një vegë. Mua m'u tha: “Ngjitu në shtyllë!”

“Nuk e bëj dot”- thashë unë. Aty për aty erdhi një shërbyes dhe më ngriti lart duke më kapur prej rrobës sime. Ndërsa unë u ngjita deri në majë të shtyllës dhe u kapa pas vegës. “Mbaje fort!”- m'u tha. Pastaj, u zgjova kur vega ishte ende në dorën time.

Unë ia tregova Profetit (a.s.), ëndërrën time. Ndërsa ai tha:

“Ai kopsht, është Islami. Shtylla, është shtylla e Islamit. Ndërsa vega, është “urue-i uska”, (pra, vega e fortë e besimit dhe Islamit). Ti do të jesh në Islam deri sa të vdesësh!”

Ky njeri, ishte Abdullah bin Selami (r.a.)» (Buhari, Menakibu'l-Ensar, 19; Muslim, Fedailu's-Sahabe, 148.)

Sipas një transmetimi tjetër, Rasulullahu (a.s.), ka thënë:

“Abdullahu do të vdesë duke qenë i kapur fort pas urue-i uska-s (vegës së besimit)!” (Muslim, Fedailu's-Sahabe, 149.)

Të zgjohesh i kapur fort pas vegës së sigurt të Is-

lamit... Këtë mund ta kuptojmë edhe si, “të flesh në këtë botë të përkohshme e të zgjohesh në botën e përvetshme”. Nëse mendojmë mbi faktin se “njerëzit janë në gjumë e kur të vdesin do të zgjohen!”, të jesh i kapur fort pas vegës së Islamit kur të zgjohesh në botën e vërtetë, do të jetë një lumturi e madhe. Të jesh në rrugë të drejtë deri në frymën e fundit...

Abdullahut (r.a.), nuk i pëlqeu që e lavdëruan dhe zgjodhi anën e modestisë dhe përvetshisë. Ai nuk u kaplue nga rehatia duke i besuar përgëzimit që i dha Profeti (a.s.), por përkundrazi, e shtoi edhe më tepër përvetshjen e tij me një vullnet të çeliktë. Ai u kap fort pas vegës së sigurt të Islamit dhe nuk e lëshoi kurrë lidhjen e tij.

Ndërsa **Harashe bin Hur** (r.a.), e tregon kështu këtë ndodhi:

“Isha ulur me një grup njerëzish në xhaminë e Medinës. Në atë grup ndodhej edhe një i moshuar me pamje të hijshme. Ky ishte Abdullah bin Selami (r.a.). Ai mbajti një ligjëratë të bukur për të pranishmit. Kur u ngrit dhe iku, xhemati tha:

«Kush dëshiron të shohë një prej banorëve të Xhenetit, le të shohë këtë njeri!»

Unë thashë me vete: «Vallahi do ta ndjek dhe do mësoj se ku e ka shtëpinë!» I shkova nga pas. Ai shkoi pothuajse në të dalë të Medinës, pastaj hyri në shtëpi. Ndërsa unë kërkova leje për të hyrë në shtëpinë e tij. Më dhanë leje dhe u futa. Abdullahu më pyeti:

«Si e ke hallin, o biri vëllait tim?» Ndërsa unë i thashë:

«Kur u ngrite dhe ike, dëgjova njerëzit të thoshin: “Kush dëshiron të shohë një prej banorëve të Xhenetit, le të shohë këtë njeri!” Për këtë arsye dëshirova të jem bashkë me ty!»

Ai më tha:

«Allahu e di më mirë se kush është banor i Xhenetit. Po të shpjegoj arsyen se pse kanë thanë ashtu:

Njëherë, kur isha duke fjetur, erdhi një burrë (në ëndërr), më kapi për dore dhe më tha: “Ngrihu!” Shkova me të. Në anën time të majtë pashë disa rrugica dhe filllora të ecja drejt tyre. Personi që ishte me mua më tha: “Mos shko andej, sepse ato janë rrugët e njerëzve të së majtës!” Më pas, pashë djathtas dhe vura re disa rrugica të qarta dhe të drejta. Personi më tha: “Ik nga ajo anë!” Pastaj më çoi afër një mali dhe më tha: “Ngjitu në këtë mal!” Unë përpiqesha të ngjitesha, por rrëzohesha mbi kurriz. E provova

shumë herë, por nuk u ngjita dot në atë mal. Gjithmonë rrëzohesha mbi kurriz. Më pas më mori dhe arritëm pranë një shtyllë. Kreu i shtyllës ishte në qiell, ndërsa pjesa e poshtme, në tokë. Personi më tha përsëri: “Ngjitu tek kjo shtyllë!”

“Si mund të ngjitem tek kjo shtyllë? Kjo shkon deri në qiell!”- thashë unë. Për këtë arsye, ai më kapi për dore, më ngriti sipër dhe më shtyu nga poshtë. Ndërsa unë e pashë veten të kapur pas një hallke. Më pas, ai e goditi shtyllën dhe e rrëzoi. Kurse unë mbeta i kapur pas asaj hallke. Kur u gdhiva në mëngjes, shkova menjëherë tek Profeti (a.s.) dhe i tregova ëndrrën time. Më pas, Profeti (a.s.), tha:

“*Rrugicat që pe në të majtë, janë rrugët e njerëzve të së majtës. Ndërsa rrugët që pe në të djathtë, janë rrugët e njerëzve të së djathtës. Mali është vendi i dëshmorëve/shehidëve. Ti nuk do ta arrish atë. Ndërsa shtylla është shtylla e Islamit dhe hallka, është vega e Islamit. Ti do të qëndrosh i kapur pas asaj vege deri sa të vdesësh!*”» (Muslim, Fedailu’s-Sahabe, 150.)

Lajmi i Rasulullahut (a.s.), se Abdullah bin Selami (r.a.), nuk do të binte dëshmor, por do të vdiste si mysliman, ishte një profeci dhe mrekulli. Për rrjedhojë, Abdullah bin Selami (r.a.), ndërroi jetë në Medinë, duke jetuar si një mysliman i devotshëm.

Ebu Burde (r.a.), tregon:

“Kur shkova në Medinë, u takova me Abdullah bin Selamin (r.a.), i cili më tha:

«A po vjen me ne? Do të të qeras me sevik (një ushqim me miell) dhe hurma. Pastaj do të vizitosh një vend shumë të çmuar (vendi ku Profeti (a.s.), falte namaz!)»

Më pas më këshilloi me këto fjalë:

«*Ti banon në një vend (Irak), ku kamata është shumë e përhapur. Nëse ke për të marrë ndonjë gjë prej dikujt dhe ai të dhuron qoftë edhe një fije kashte apo ndonjë gjë që peshon sa elbi apo jonxha, bëj kujdes e mos e merr, sepse ajo është kamatë!*» (Buhari, Menakibu’l-Ensar, 19, I’tisam, 16.)

Këto fjalë tregojnë qartë se sa jetë të devotshme ka bërë Abdullah bin Selami (r.a.). Përveç kësaj, ne shohim mikpritjen, dashurinë e tij për vëllezërit myslimanë, bujarinë dhe më të rëndësishmen nga të gjitha, dashurinë dhe respektin për Rasulullahun (a.s.). Këtë e tregon edhe fakti se ai e ruante me kujdes të madh vendin ku Profeti (a.s.), kishte falur namaz në shtëpinë e tij dhe i sillte vëllezërit e tij myslimanë të falnin edhe ata namaz në atë vend të bekuar.



Agjërimi i Zemrës

Rabia Brodbeck

Çfarë është jeta pa agjërim? Ne përmallohemi për gëzimin e iftarit dhe syfyrit. Përmallohemi për harrenë e pjesëmarrjes në dua duke thënë amin. Përmallohemi për ndjenjën e frymëzimit të përhershëm. Përmallohemi për gëzimin e pjesëmarrjes në leximet e Kuranit. Përmallohemi për burimin e mrekullueshëm të frymëzimit dhe shërimit. Përmallohemi për muajin e pashoq të edukimit. Përmallohemi për marrëdhënien e dashurisë dhe mëshirës ndërmjet njerëzve. Përmallohemi për qëndrimet në këmbë të besimtarëve gjatë namazeve të teravive në Ramazan, për rukutë, sexhdet dhe atë forcën e mrekullueshme të bashkimit.

Duhet të jemi të vetëdijshëm se një nga gabimet tona më të rënda është burgosja e agjërimeve brenda muajit të Ramazanit. Burgosja e haxhit në kohën e tij. Burgosja e Namazit brenda sexhades. Burgosja e zekatit duke dhënë vetëm një të dyzetën e tij në një vit. Dhe më e keqja është se edhe Natën e Kadrit e burgosim vetëm Natën e Kadrit.

A nuk zbret gjithmonë e vërteta? Ne duhet të arrijmë shpirtin e agjërit, haxhit dhe zekatit, me qëllim që të kuptojmë se fakti që janë nga kushtet e Islamit, është vetëm shkak e jo qëllim.

Biseda midis të Adhuruarit dhe adhuruesit, përbën thelbin e Namazit. Të vdesësh para se të të vijë vdekja, të sakrifkohesh prej trupit e shpirtit dhe ta

shndërrosh jetën në një rrugëtim drejt Zotit, përbën vetë shpirtin e haxhit. Sakrifca është arti i të jetuarit për të tjerët, arti i dhurimit, që formon thelbin e zekatit. Ndërsa zhveshja e egos prej çdo gjëje të kësaj bote dhe orientimi për tek Allahu, është shpirti i agjërit.

Edhe jashtë muajit të Ramazanit duhet të mbajmë shpesh agjërim për shqisat tona, si sytë, mendimet, ndjenjat dhe zemrën tonë. Edhe jashtë pesë kohëve të namazit ne duhet ta përkujtojmë gjithmonë dhe në çdo vend Allahun e Madhëruar, duhet t'i lutemi Atij dhe ta madhërojmë. Po ashtu, edhe jashtë detyrës së zekatit ne duhet t'i ndihmojmë gjithmonë vëllezërit tanë që kanë nevojë. Ne duhet të rinovojmë besimin dhe mendimet tona çdo ditë, çdo orë e çdo çast. Duhet të mbushemi dhe të rigjallërohemi përsëri. Kjo lloj dinamike, është Suneti i Muhamedit (a.s.).

Pika më e rëndësishme është se ne duhet të pajisemi me moralin e dhurimit duke dhënë zekatin. Duhet të bëhemi modestë duke falur namazin dhe duhet të ndiejmë dashuri ndaj Profetit tonë (a.s.). Duhet të digjemi nga dashuria e dorëzimit duke shkuar në haxh. Me anë të agjërit, duhet të bëhemi robër të Kuranit dhe duhet të bartim thelbin e zuhdit duke u pastruar nga kjo botë. Përse shkojmë në umre dhe në haxh? Për ta përjetuar thelbin dhe thesarin e umres dhe të haxhit në jetën tonë. Përse agjërojmë? Për të

fituar thesarin e kuptimit dhe dashurisë hyjnore. Përse japim zekat? Për t'i përngjarë familjes dhe shokëve të Profetit (a.s.). Përse falim namaz? Për të arritur nivelin e tij përfundimtar, që siç thotë edhe Profeti ynë (a.s.), është "drita e syve". Për rrjedhojë, në jetën tonë të përditshme ne jemi gjithmonë në umre, në haxh, në namaz, në agjërime dhe në dhurim.

Për të përfutur gjithmonë prej thesarit të muajit të Ramazanit, duhet ta kontrollojmë seriozisht zemrën dhe të edukojmë egon tonë. Kjo, sepse Allahu i madhëruar, zemrën e ka krijuar si krijesën më të lartë. Siç thotë edhe një shprehje: "Nuk më nxë as qielli as toka, por më nxë zemra e robit Tim besimtar." Zemra e njeriut, është qendra e vetëdijes dhe e vërteta shpirtërore. Ajo është e lidhur drejtpërdrejt me Allahun. Ajo është vendi ku shfaqet Allahu. Për rrjedhojë, puna e robit, është ta pastrojë zemrën dhe të largojë prej aty çdo gjë që nuk ka lidhje me dashurinë ndaj Allahut. Ato që i shohim si idhuj, duhet t'i nxjerrim prej zemrës, duke i hapur vendin më Mëshiruesit të mëshiruesve.

Armiku më i madh i thesarit të zemrës është shejtani, i cili përpigjet të pushtojë zemrën dhe tenton të vjedhë moralin dhe dashurinë hyjnore ndaj Allahut. Prandaj, ajo që do të na shpëtojë, është agjërimi i zemrës. Kur ruhem nga ndotja e zemrës, do të thotë se jemi duke mbajtur agjërimin e zemrës. Pra, për ta mbajtur agjërimin e zemrës, duhet të shkundemi prej barrës së kësaj bote që qëndron mbi ne. Nëse një besimtar e mban gjatë gjithë jetës agjërimin e zemrës, bën jetën më të bukur, sepse ai ka arritur të realizojë Sunetin e Profetit tonë (a.s.).

Për shkak se mbështetet në Sunetin (zbatimin praktik) e Profetit tonë (a.s.), Islami është një lloj edukimi i nivelit më të lartë, i vazhdueshëm, i pandërprerë dhe dinamik. Nëse do të mund ta arrijmë këtë vetëdije dhe ta vëmë në jetë këtë urtësi, do të thotë se kemi arritur të mbajmë agjërimin e zemrës dhe do të kemi arritur në kulmin e ekzistencës njerëzore.

Në zemrën e personit që mban agjërimin e zemrës, fillon ndryshimi. Treguesi më i rëndësishëm i kësaj është zbutja e zemrës. Në këtë mënyrë hapet syri i zemrës dhe shfaqet drita e udhëzimit, mëshira dhe dashuria. Po ashtu, përfitohet edhe prej ushqimeve të pafundme qiellore. Tashmë ajo zemër dashuron, qan, dridhet, djersitet, digjet, bashkohet, nuk kaplohet nga dëshira për Xhenetin dhe frika ndaj

Xhehenemit dhe nuk bie në shirk apo injorancë. Ajo zemër është vazhdimisht në sexhde, shpirti është gjithmonë në Miraxh, në një takim të vazhdueshëm, duke bërë tavaf rreth misterit të fshehtë të zemrës. Ai që mban agjërimin e zemrës, jeton së bashku me zemrën. Vetëm ai që është afër zemrës së vet mund t'i afrohet Allahut. Ai që mban agjërimin e zemrës hyn në ihram dhe përjeton gjendjen e modestisë, sedrës, varfërisë, nevojës dhe dorëzimit plot dashuri. Ai që mban agjërimin e zemrës, e sheh bukurinë dhe përsosmërinë me sytë e zemrës dhe vëren bukuritë hyjnore në ekranin e zemrës.

Ai që mban agjërimin e zemrës, bart edhe moralin e dhurimit. Vdes para se t'i vijë vdekja dhe jeton duke shpëtuar prej trysnisë dhe mizorisë së egos së vet. Ai që mban agjërimin e zemrës, shpëton plotësisht prej pavetëdijes, pandjeshmërisë dhe lidhjeve materialiste. Ai që mban agjërimin e zemrës, merr abdest për t'u pastruar prej papastërtive shpirtërore e egoiste, prej gjynaheve dhe indiferencës. Ai e pastron veten e tij prej cilësive të këqija, si urrejtja, dyfytërsia, lakmitë e kësaj bote, koprracia, egoizmi etj. Ai pastrohet edhe prej lakmisë, smirës, mendjemadhësisë, grykësisë, përtacisë dhe injorancës. Ai nuk jeton me një zemër të mbushur me idhuj dhe plehurat e kësaj bote. Allahu nuk i pranon ata që adhurojnë idhuj, dyfytërsë, lakmitarët dhe indiferentët. Pika më e rëndësishme, është se përsosmëria e sexhdes, arrihet vetëm me zemër. Nëse zemra jonë nuk bën sexhde, nuk lind as dashuria e dorëzimit dhe në këtë mënyrë nuk ka efekt as agjërimi i zemrës.

Përveç këtyre, agjërimi i zemrës do të thotë të kthehesh tek Allahu që na bën të përjetojmë vlerën e Ramazanit, të strehohesh tek Ai, të orientohesh, të zhytesh në detin shpirtëror dhe në namaz, të kapesht fort pas Fatihasë, sexhdes dhe Kuranit Fisnik. Ajo që na bën të përjetojmë muajin e Ramazanit, është meditimi dhe dashuria. Ajo që na bën të përjetojmë muajin e Ramazanit, është fakti se jemi në një luftë dashurie të vazhdueshme në jetën tonë. Ajo që na bën të përjetojmë muajin e Ramazanit, është shpëtimi i vetes sonë prej unit, prej jetës së kufizuar midis katër mureve dhe zhytja në shkretëtirën e ekzistencës për të jetuar urtësinë e ajeteve hyjnore. Ajo që na bën të përjetojmë muajin e Ramazanit, është bindja, besimi, dorëzimi, xhihadi, adhurimi dhe dashuria për të dhuruar.

Dashuria e dorëzimit, është një dritë. Dëshira për të

Duhet të jemi të vetëdijshëm se një nga gabimet tona më të rënda është burgosja e agjërimeve brenda muajit të Ramazanit. Burgosja e haxhit në kohën e tij. Burgosja e Namazit brenda sexhades. Burgosja e zekatit duke dhënë vetëm një të dyzetën e tij në një vit. Dhe më e keqja është se edhe Natën e Kadrit e burgosim vetëm Natën e Kadrit.

mësuar është e barabartë me dashurinë e dorëzimit. Të mësosh, do të thotë të zhvillohesh. Të zhvillohesh, do të thotë të arrish afërsi dhe sinqeritet. Dashuria për dorëzim, është drita që ndriçon rrugën tonë.

Në dashurinë e dorëzimit, arrihet me zemër. Përpara nesh ndriçon bukuria e bindjes. Kjo, është drita e besimit. Pa dorëzim, bindje, adhurim dhe dashuri për shërbim, nuk mund ta meritojmë të jemi prej ithtarëve të Sunetit. Pa qenë prej ithtarëve të Sunetit, nuk lind as dashuria për Profetin (a.s.). Dhe, pa ndjerë dashuri për Profetin (a.s.), nuk mund të na kaplojë as mëshira.

Ajo që na bën të përjetojmë muajin e Ramazanit, është kuptimi i domethënies së Miraxhit në namaz. Pa e kuptuar Miraxhin, nuk mund të kuptojmë as Muhamedin (a.s.) dhe as fenë islame. Çështja më e rëndësishme, është të falësh apo jo namazin me gjithë zemër. Pyetja themelore është: A punojnë pjesët e zemrës apo jo? Në fakt, e gjithë çështja është brenda nesh, jo të fitosh sevape, të lutesh, të agjërosh, të japësh sadaka apo të shkosh në haxh. Çështja është të arrish të bësh operacion zemre.

Ne ndjejmë vështirësi ndërkohë që zbatojmë urdhrat e Allahut, sepse adhurimet i bëjmë vetëm formalisht. Për shkak se e kemi lënë pas dore Sunetin e Profetit (a.s.), nuk arrijmë ta shohim as dritën dhe bukurinë e adhurimeve. Dr. Haluk Nurbaki, e shpreh kështu urtësinë e Miraxhit:

“Miraxhi, është një histori dashurie midis Allahut dhe të dashurit të tij. Sigurisht që ne nuk mund ta kuptojmë kënaqësinë e tij. Ajo që na takon ne, është të njohim delikatesën në misterin e Miraxhit dhe të kapemi fort pas namazit për të shtuar devotshmërinë tonë. Ne duhet të përpiqemi çdo çast të mësojmë të vërtetën e falënderimit. Përjetimi i Kuranit dhe perceptimi i misterit të pafundmë të ajeteve të tij, është i mundur vetëm në sajë të namazit që u urdhërua gjatë Miraxhit. Në mënyrë të veçantë, viza e profetit tonë (a.s.), në dokumentin tonë të identifikimit, është kusht i domosdoshëm. Pa u lidhur me Profetin tonë (a.s.) me një dashuri që i lë në hije të gjitha dashuritë e tjera, nuk mund të arrijmë askund me asnjë lloj mënyre. Kjo është urtësia më e rëndësishme që reflektohet tek ne.”

Ajo që na bën të përjetojmë muajin e Ramazanit, është mësimi i dashurisë prej të dashuruarve, sepse ata gjatë gjithë jetës mbajnë agjërim zemre. Ibn Arabiu, thotë:

“Ekzistojnë tre rreziqe që ju pengojnë të bëni llogarinë e vetes suaj. E para është pavetëdija, e dyta janë kënaqësitë që mendoni se i ndjeni brenda mashtrimeve të egos dhe e treta, është robërimi ndaj zakonëve tuaja.”

Ndërsa i nderuari Abdulkadir Gejlani, na jep këtë këshillë:

“Kultura shpirtërore, nuk arrihet me biseda të gjata, por me uri dhe edukimin e egos duke braktisur ato që i pëlqejnë asaj.”

Ndërsa Ibrahim bin Et'hemi, e këshillon kështu popullin e Basrës:

“Zemrat tuaja janë të vdekura për shkak të dhjetë gjërave:

1. Ju thoni se e njihni Allahun, por nuk ia jepni të drejtën Atij. E drejta e Allahut, është të ndihmohet nevojtarin.

2. Ju lexoni Kuran, por i anashkaloni urdhrat dhe ndalesat e tij dhe nuk i vini në jetë ato që lexoni.

3. Ju thoni se shejtani është armiku juaj, por ju e ndiqni dhe i bindeni atij.

4. Ju thoni se jeni prej umentit të Muhamedit (a.s.), por nuk i jepni rëndësi Sunetit të tij.

5. Ju pretendoni se do të hyni në Xhenet, por nuk i kryeni detyrat tuaja për të hyrë në Xhenet.

6. Ju dëshironi të shpëtoni prej zjarrit, por me gjenahet që bëni, e hidhni veten në zjarr.

7. Ju e dini se vdekja është realitet dhe kështu thoni, por ju nuk bëni asnjë përgatitje për të.

8. Ju i dalloni menjëherë gabimet që bëjnë vëllezërit tuaj, por nuk i shikoni kurrë gabimet tuaja.

9. Ju i konsumoni mirësitë e Allahu pa e falënderuar aspak Atë.

10. Ju i varrosni të vdekurit tuaj, por nuk merrni fare mësim prej tyre, sikur nuk do të keni edhe ju të njëjtin përfundim.”

Prishja e agjërimit të trupit, bëhet me të ngrënë e me të pirë. Mirëpo është e vështirë të dish se si prishet agjërimi i zemrës. Për të kuptuar se a është prishur agjërimi i zemrës, duhet të jemi të vetëdijshëm. Një zemër e verbër nuk e kupton që nuk punon. Ndërsa një zemër e dobët, nuk e kupton dot se e ka prishur agjërimin e vet. E rëndësishme është që ne të jetojmë me vetëdije. Sa më shumë besim të ketë në zemrën e njeriut dhe sa më gjallë të mbahet njohja e Allahut, aq më shumë sedër, dashuri dhe modesti do të shfaqet. Modestia, është një vetëdije hyjnore që vjen prej besimit dhe njohjes së Allahut.

Allahu i madhëruar, ua mundësoftë të gjithë besimtarëve të fitojnë thesarin e zemrave të tyre, potencialin e brendshëm, pastërtinë dhe dashurinë.

Shpërblimi më i madh i Allahut, është shpërblimi i atyre që e adhurojnë Allahun pa pasur në zemër as dashuri për Xhenetin dhe as frikë prej Xhehenemit. Ata bëjnë adhurime vetëm e vetëm për kënaqësinë e Tij. Ata do të hyjnë në Xhenet dhe do të gëzojnë nderimin që do t'u japë Allahu i Madhëruar e Bujar, duke parë bukurinë e Tij të pakufishme.



MARRËDHËNIA E UMETIT

me Sunetin e Muhamedit (a.s.)

Prof. dr. Ismail Lutfi Çakan

Umeti është një strukturë shoqërore, ndërsa fjalët, veprat/sjelljet dhe aprovimet e Profetit tonë (a.s.), i cili i ka dhënë formë këtij Umeti në kuadër të vullnetit të Krijuesit të Madhërishëm, janë Suneti i tij. Për të qenë më të qartë, mund të themi se, nëse i përdorim termat Umet dhe Sunet duke i lidhur me Profetin (a.s.), do të vërejmë një realitet shoqëror të ndërtuar me Umetin e Muhamedit (a.s.) dhe Sunetin e Muhamedit (a.s.). Atëherë, përgjegjësia më themelore e Umetit, është mospërjashtimi i Sunetit për asnjë lloj arsyeje nga jeta individuale dhe shoqërore. Kjo, sepse Umeti dhe Suneti janë dy “trashëgimi profetike”, të cilat nuk mund ta durojnë mungesën e njëra-tjetrës. Në themel dhe në qendër të të dyjave, gjendet Kurani Fisnik. Për këtë arsye, e vërteta e pakundërshtueshme e kësaj çështjeje mund të përkufizohet si, “Realiteti dhe struktura shoqërore e ndërtuar në boshtin e Kuranit fisnik, të Umetit të Muhamedit (a.s.) dhe Sunetit të Muhamedit (a.s.).”

Aisheja (r.anha), thotë: “Profeti (a.s.), bëri diçka dhe e lejoj veprimin e saj.” Mirëpo, disa myslimanëve nuk u pëlqeu dhe qëndruan larg atij veprimi. Kjo gjë, shkoi në vesh të Profetit (a.s.), i cili pasi falënderoi Allahun, tha:

“Çfarë kanë disa që ngurojnë të veprojnë diçka që unë e kam vepruar personalisht?! Betohe në Allahun se unë e njoh Allahun më mirë se ata dhe i frikësohem Atij më tepër se ata.” (Buhari, I’tisam, 5; Edeb 72; Muslim, Fedail 128; Ahmed b. Hanbel, Musned, VI, 45, 181.)

Domosdoshmëritë e të qenit Umet, Profeti ynë

(a.s.), ua ka mësuar vetë personalisht sahabëve dhe Umetit të tij. Ai i ka kontrolluar rreptësisht veprimet e sahabëve dhe përveç përgjegjësive që kanë qenë të posaçme vetëm për të, nuk i ka lejuar për asnjë lloj arsyeje që ata të dalin jashtë vijës së mënyrës së tij të jetesës. Kur mori vesh se disa sahabë i konsideronin të pakta punët e tyre dhe dëshironin të zbatonin disa mënyra jetese të vështira, si agjërimi i vazhdueshëm, adhurimi pa fjetur natën dhe largimi nga gratë, duke u arsyetuar me ndjenjat e devotshmërisë, përkushtimin ndaj adhurimeve dhe gjynaheve të shumta që kishin, Profeti (a.s.), i qortoi duke u thënë: “Unë e kam më tepër frikë Allahun ndër të gjithë ju. Mirëpo, unë edhe agjëroj, edhe nuk agjëroj. Natën edhe falem, edhe fle. Unë shkoj edhe tek gratë e mia. Kush ia kthen shpinën Sunetit tim dhe del jashtë mënyrës sime të jetesës, ai nuk është prej meje. Ai e ka braktisur rrugën time.” (Buhari, Nikah 1; Muslim Nikah 5; Nesai, Nikah 4; Darimi Nikah 3; Ahmed b. Hanbel, Musned, II, 158; III. 241, 259, 285; V, 409.)

Me këto fjalë, Profeti (a.s.), ka theksuar se, respekti dhe devotshmëria ndaj Allahut, tregohet duke ndjekur Sunetin e Muhamedit (a.s.) dhe se është e domosdoshme që feja islame të jetohet brenda kuadrit të Sunetit të tij.

Nisur nga këta dy shembuj, është e mundur të nxjerrim këtë përfundim: Suneti i Muhamedit (a.s.), është udhëzuesi, garancia, shembulli dhe rruga e vetme e Umetit të Muhamedit (a.s.), për të kuptuar dhe jetuar Islamin në mënyrën e duhur. Prandaj, të tentosh të jetosh jashtë Sunetit, qoftë me arsyen e



devotshmërisë, qoftë për neglizhencë apo përtaci, nuk përputhet aspak me të qenit Umet i Muhamedit (a.s.). Kjo, sepse **“për besimtarët, Profeti (a.s.), vjen para vetes së tyre.”** (shih. Ahzab, 6.)

Jeta e tij, fjalët, këshillat, përgëzimet dhe paralajmërimet e tij, duhen pranuar pozitivisht në jetën e të gjithë Umetit Islam. Ky pranim pozitiv, vlen për çdo gjë që i përket atij. Nëse do ta shprehim më qartë, përgjigja ndaj atyre që ushqejnë armiqtë dhe zgjasin gjuhën ndaj Profetit dhe Sunetit të tij, lufta me bid'atin dhe bid'atçinjtë dhe përpjekja për ta bërë mbizotëruese në shoqëri jetën dhe hadithet e tij, zënë vend në domosdoshmëritë e besnikërisë ndaj Profetit tonë (a.s.). Nisur nga kjo, ashtu siç nuk mund të bëhesh mysliman duke e përjashtuar Profetin (a.s.), nuk mund të bëhesh mysliman as duke e anashkalluar apo mos e marrë parasysh Sunetin e tij.

Suneti është modeli i jetës që ka shfaqur Profeti (a.s.). Për rrjedhojë, duke qenë se ekziston ky shembull praktik i Islamit, ta nxjerrësh atë nga të qenit shembull për besimtarët dhe të përpiqesh ta mbash larg prej të qenit argument fetar, është vetëm produkt i një fantazie të myslimanizmit pa profet. Mirëpo, të mendosh një Islam pa Muhamedin (a.s.), nuk mund të ketë lidhje me asnjë individ të Umetit dhe nuk mund të pritë kurrë me tolerancë.

Myslimanët që e gjejnë madhështinë, nderin, kuptimin, këtë botë dhe botën tjetër në rrugën e ndritur të Sunetit të Profetit (a.s.), që e kuptojnë Islamit me shpjegimet e Sunetit dhe që përpiqen me sa kanë mundësi të jetojnë brenda kuadrit të Sunetit, mund ta shohin veten e tyre në pikën e duhur nga aspekti i marrëdhënies Umet-Sunet.

Ashtu siç ka ndodhur në të shkuarën, edhe sot ka persona që tentojnë ta përjashtojnë Profetin (a.s.)

dhe të bëhen vetë profetë. Ndërsa disa të tjerë, kërkojnë forma të reja të fetarisë përtej botëkuptimit profetik, duke shfaqur sjellje të devijuara. Mirëpo, me qëllim që individët e Umetit ta kryejnë me sukses edhe detyrën e tyre më të rëndësishme, por edhe të drejtën e tyre të natyrshme që është detyra e devotshmërisë, duhet të veprojnë në përputhje me shembullin e Profetit (a.s.).

Siç dihet, prijësi i vetëm dhe i vërtetë i Umetit në kuptimin e fesë dhe të botës, është Profeti (a.s.). Për rrjedhojë, siç u pa edhe në hadithet e përmendura më sipër, Profeti ynë (a.s.), u ka dalë kundër në mënyrë të prerë mendimeve dhe zbatimeve fetare të tepruar dhe jashtë Sunetit të tij.

Atëherë mund të themi në mënyrë të sigurt se akush prej individëve të Umetit nuk ka të drejtë të dalë jashtë Sunetit, as me arsyetimin e devotshmërisë dhe as me atë të përtacisë.

Nga ana tjetër, të mos vihesh në rolin e Profetit, është një domosdoshmëri tjetër e vetëdijes ndaj marrëdhënies Umet-Sunet. Ndonjëherë, dëgjohen shprehje të tilla injorante dhe arrogante si, “Profeti nuk mund ta ketë thënë këtë. Nëse e ka thënë, unë nuk mund ta pranoj. Profeti nuk mund të thotë diçka të tillë, etj...” Fjalë të tilla, janë thjesht tentativa për ta kufizuar Profetin (a.s.) brenda mendjes dhe botëkuptimit personal, gjë e cila të shpie larg vetëdijes së Umetit.

Atëherë, fetaria e vërtetë për myslimanët që janë individët e Umetit, është ta jetojnë fenë nën dritën e Sunetit të Muhamedit (a.s.). Dhe ky, është identiteti dhe virtyti më i spikatur që i dhuron jetës sonë marrëdhënien e Umetit të Muhamedit (a.s.) me Sunetin e Muhamedit (a.s.).



ZEKATI DHE EDUKATA

Në aspektin leksikor, fjala zekat do të thotë pas-trim, purifikim, të meritosh dhe të jetosh në bollëk e begati. Ndërsa në aspektin terminologjik, nënkupton dhënien tek të varfrit të një të dyzetës së një pasurie në sasinë e nisabit¹ që ka kaluar një vit.

Fakti që urdhri i qartë për dhënien e zekatit, jepet në ajetin lidhur me ithtarët e librit, ku thuhet: **“ata qenë urdhëruar vetëm që të adhuronin Allahun me përkushtim të singertë, duke qenë në fenë e pastër (të Ibrahimit), si dhe të falnin namazin e të jepnin zekatin...”**², tregon se zekati ka qenë farz/detyrim edhe për popujt e mëhershëm. Ilaçi i të këqijave të fshehura në egot njerëzore, mund të jepet vetëm nëpërmjet kanaleve të bujarisë të hapura me anë të zekatit dhe bamirësisë. Nisur nga kjo, Profetit tonë (a.s.), i ka ardhur urdhri hyjnor ku thuhet: **“Merr nga pasuria e tyre lëmoshë me të cilën t’i pastrosh ata dhe t’ua rrisësh veprat e mira!..”**³ Megjithëse në disa transmetime thuhet se lëmosha e cila është urdhëruar të merret në këtë ajet, nuk është zekati farz, por një lëmoshë e veçantë që është marrë për të larë gjynahet e atyre që nuk morën pjesë në luftë, shumica e fakiheve/juristëve, janë të mendimit se aty flitet për zekatin farz.⁴

Në hadithet që na lajmërojnë se, **“Islami është for-**

1. Nisab: Sasia e caktuar e një malli prej të cilit është detyrim të jepet si zekat një e dyzeta ose 2.5% e saj. Po të kesh rreth 80 gr ar, 200 dirhem argjend, 40 kokë dele, 30 lopë etj., të cilat kanë një vit që qëndrojnë në pronësinë e tënde, duhet të japësh një të dyzetën e tyre. Nëse nuk plotësohet sasia e nisabit, atëherë nuk është detyrim të jepet zekat.

2. Bejjine, 5.

3. Teube, 103.

4. shih. Hakk'in Daveti Kuran-ı Kerim Mealı ve Tefsiri, Prof. Dr. Ömer Çelik, Erkam Yay, 2013, c. 2, s. 444.

muar mbi pesë parime⁵, zekati përmendet i treti në radhë dhe Profeti ynë (a.s.), na paralajmëron se: **“ata që nuk e japin zekatin, konsiderohen sikur kanë grabitur të drejtën e të varfrit nga malli i vet dhe se në botën tjetër, trupat e tyre do të damkosen me këtë (mall).”**⁶ Ndërsa përgëzimi i Profetit (a.s.), se: **“Zekati, namazi dhe ruajtja e lidhjeve fafëfisnore, janë prej veprave që të çojnë në Xhenet”**⁷, vazhdon të lexohet me shekuj të tërë si një prej lajmeve të shenjta që i mbajnë në këmbë parimet e Islamit. Dhe në çdo lexim, i nxit myslimanët të kapen fort pas këtyre përgëzimeve të Xhenetit.

Paralajmërimet dhe përgëzimet në ajetet dhe hadithet fisnike, na bëjnë të mendojmë se, jemi të detyruar që namazin dhe zekatin që përmenden së bashku në ajetet fisnike, t’i përvetësojmë si shoqëri në tërësi. Sikurse namazi, që nuk përbëhet thjesht nga një sërë lëvizjesh që bëhen në kohë të caktuara, ashtu edhe zekati nuk është thjesht të japësh diçka në një farë mënyre. Përkundrazi, edhe ai që e jep, edhe ai që e merr zekatin, duhet të respektojnë një edukatë të caktuar.

Kur flasim për rëndësinë e një farzi, është e domosdoshme të flasim edhe për edukatën e tij, që e bën atë të përsosur. Padyshim se dhënia e zekatit në mënyrën e duhur është e mundur në sajë të respektimit të kushteve të edukatës së tij të dukshme dhe të fshehtë. Për rrjedhojë, dijetarët islamë kanë tërhequr vëmendjen në kujdesin ndaj hollësive në lidhje me këtë çështje. Nisur nga kjo, këtu do të japim

5. shih. Buhari, Iman; l, 2.

6. shih. Muslim, Zekat; 24.

7. shih. Buhari, Edeb, 10.

MOS KËMBËNGUL NË GJYNAH!

përmbledhjen e edukatës të cilën Imam Gazaliu e ka theksuar si të rëndësishme:

“Ai që jep zekat, duhet të jetë i vetëdijshëm se po kryen një adhurim farz dhe nuk duhet të harrojë se në sajë të zekatit ai po vihet në sprovë. Ai duhet ta dijë se zekati është një falënderim ndaj mirësisë që i është dhënë. Për t’u ruajtur nga syfaqësia dhe mburrja, duhet pasur kujdes që zekati të jepet në mënyrë të fshehtë. Po ashtu, duhet qëndruar larg prej veprave të këqija, si përçmimi dhe rëndimi me fjalë gjatë dhënies së zekatit, sepse këto e shkatërronjë shpërblimin e tij.

Gjatë dhënies së zekatit, duhet zgjedhur personi që ka familje të madhe ose ai që nuk ka mundësi të dalë e të punojë për shkak të moshës, sëmundjes dhe shkaqeve të tjera të ngjashme. Gjatë përzgjedhjes duhet ruajtur farefisnia dhe njerëzit e afërt, sepse këtu merret shpërblim edhe për zekatin e dhënë, por edhe për kujdesin ndaj të afërmeve.

Nëse nuk është mundësia të bësh zgjedhjen e personave që përmendëm më sipër ose kur zekati dërgohet në vende të largëta të panjohura, atëherë mund të përfitohet nga shërbimi që japin vakëfet dhe shoqatat bamirëse në këtë çështje.

Ndërsa i varfri që pranon zekatin, duhet të bëjë kujdes në këto çështje:

Pikësëpari, ai duhet ta konsiderojë si mirësi të madhe që Allahu e ka shpëtuar nga shqetësimi për të mbledhur pasuri e për ta ruajtur atë dhe, brenda mundësive të veta, duhet ta shpenzojë kohën në përgatitje për botën tjetër. Ai duhet ta kuptojë se mirësitë që i janë dhënë, janë më të dobishme për të se sa ato prej të cilave ai është privuar. Ndërsa ato që i merr si zekat apo sadaka, duhet t’i përdorë në rrugë të drejtë. Nëse i përdor ato në gjynah, atëherë do bëhej mosmirënjohës ndaj mirësive.

Ai duhet ta falënderojë dhe të lutet për atë që i jep sadaka apo zekat. Mirëpo, falënderimi dhe lutja e tij nuk duhet të jetë e tepruar, duke e nxjerrë të pasurin përtej të qenit një shkak mirësie. Ai duhet të ketë kujdes për burimin e asaj që merr dhe nuk duhet të marrë atë që nuk është hallall. Madje, ai duhet të ruhet edhe nga sasia që merr. Nëse është një sasi e dyshimtë, ai duhet të mjaftohet me atë që është më e pranueshme.”⁸

Shkurtimisht, çdo adhurim që e kemi për detyrë ta kryejmë, ka kushtet e dukshme dhe të fshehta të edukatës së vet. Dhe për të arritur ndikimin pozitiv të zekatit në shoqëri, pra, të kurojë koprracinë dhe lakminë për pasuri të të pasurve dhe të largojë smirën dhe urrejtjen prej të varfërve, duhet pasur kujdes në të dyja aspektet njëkohësisht.

Gjynah është një punë që bëhet në kundërshtim me urdhrat e Allahut. Gjynahet mund të jenë fjalë apo vepra që konsiderohen faj në aspektin fetar. Në Kurranin Fisnik bëhet thirrja: **“Largohuni nga gjynahet e hapëta dhe të fshehta!..”** (En’am, 120) dhe urdhërohet: **“...Ndihmoheni njëri-tjetrit në punë të mira dhe në të ruajturit nga të këqijat dhe jo në gjynahe e armiqësi!”** (Maide, 2)

Profeti (a.s.), thotë se, “çdo gjynah është si një njollë e zeze që bie në zemër”. Ai na ndalon prej çdo lloj gjynahu. Madje, ai na kujton se edhe gjynahet e vogla të cilat bëhen vazhdimisht me këmbëngulje, bëhen të mëdha duke u shumëfishuar. Allahu i Madhëruar na premtton në këtë mënyrë: **“Në qoftë se ju u shmangeni gjynaheve të mëdha, që ju janë ndaluar, Ne do t’ju falim gabimet tuaja të vogla dhe do t’ju shpiem në një vend të nderuar.”** (Nisa, 31)

Ndërsa Imam Gazaliu thotë:

“Një nga shkaqet që gjynahet e vogla kalojnë në nivelin e gjynaheve të mëdha, është vazhdimësia me këmbëngulje e gjynaheve që konsiderohen të vogla. Për shkak të “vazhdimësisë”, gjynahu i vogël zmadhohet, ndërsa me kërkimin e faljes, gjynahu zhduket. Nisur nga kjo, falja e gjynahut të madh që nuk përsëritet, shpresohet të jetë më e lehtë se sa falja e gjynahut të vogël që përsëritet vazhdimisht.

Në këtë pikë, duke u nisur nga hadithi: **“Vepra më e mirë është ajo e vazhdueshmja qoftë edhe e pakët!”**, mund të themi se: Veprat e mëdha që bëhen përnjëherësh por pa vazhdimësi, kanë pak mundësi ta ndriçojnë zemrën. Ndërsa veprat e vogla, por të vazhdueshme, kanë më shumë mundësi ta ndriçojnë zemrën. Po në të njëjtën mënyrë, edhe gjynahet e vogla që bëhen shpesh, kanë më shumë mundësi ta nxijnë zemrën se sa një gjynah i madh që bëhet vetëm një herë.” (shih. Ihjau Ulumi’ d-Din, Bedir Yay, c. 4, s. 59.)

Në fund të fundit, njeriu është i prirur të gabojë dhe të harrojë. Ajo që ka për detyrë njeriu me mendje të shëndoshë, është të kapet pas pendimit dhe të mos këmbëngulë në gjynahe.

8. shih. Ihjau Ulumi’ d-Din, Bedir Yay, c. 1, s. 618-634.





Një nga fakihët e Medines **ZIJAD IBN LEBID**

- RADIJALLAHU ANHU -

Mustafa Erish

Zijad ibn Lebid (r.a.), ishte një sahab i ngarkuar nga Rasulullahu (a.s.), me detyrën e mbledhjes së zekatit në zonën e Hadrameutit!..

Ai ishte një dijetar që kishte zënë vend midis fakihëve/juristëve të Medine-i Muneuures!.. Ndërsa midis sahabëve, ai ishte një trim që njihej si “muhaxhir-ensar”.

Ai ishte një fatlum, që u bë i njohur edhe me pyetjen që i bëri Rasulullahun (a.s.), në lidhje me hadithin që na lajmëron se dituria do të merret prej njerëzve afër Kiametit.

U lind dhe u rrit në Medinë, ku bënte pjesë në degën e Beni Umejje ibn Bejada, të fisit Hazrexh. Ai e njohu Islamit në sajë të Mus'ab ibn Umejrit (r.a.) dhe me anë të ftesës së tij u nderua me Islam. Ka qenë prezent edhe në Besëlidhjen e Dytë të Akabes.

Ai ishte prej muhaxhirëve të parë mekas që shkoi në Medinë. Më pas mësoi shpërblimin e emigrimit në Medinë. Dhe për të arritur këtë shpërblim, ai u kthye përsëri në Mekë, ku qëndroi për një farë kohe

pranë Profetit tonë (a.s.). Më vonë, së bashku me një grup muhaxhirësh, emigroi përsëri në Medinë. Për shkak të këtij veprimi, mendohet se ka fituar shpërblime edhe si muhaxhir edhe si ensar, gjë e cila u bë shkak që midis sahabëve të përmendëj si “muhaxhir-ensar”.

Zijad ibn Lebidi (r.a.), ishte një besimtar i devotshëm, i cili i ishte dorëzuar plotësisht Profetit tonë (a.s.). Ai e priste me dashuri dhe mall emigrimin e tij për në Medinë. Kur dëgjoji se Profetin ynë (a.s.), kishte emigruar dhe gjendej në vendin e quajtur Kuba, ai ndodhej në rrugën për tek fisi Beni Bejada. Prandaj mendoi ta priste Profetin (a.s.), si mysafir në shtëpinë e vet dhe filloi të përgatitej me një dashuri të madhe.

Zijadi (r.a.), ishte prej parisë së fisit të tij. Kur ishte duke kaluar në lagjen e vet së bashku me Ferue ibn Amrin (r.a.), ndaloi devenë e Rasulullahun (a.s.) dhe, duke i thënë se kishte aq njerëz sa për ta mbrojtur dhe aq mundësi materiale sa të mos binte në vështirësi, i kërkoi që të qëndronte si mysafir në

shtëpinë e tij. Mirëpo, Profeti ynë i dashur (a.s.), u tha ta lëshonin devenë e tij, sepse ai do të qëndronte në vendin ku do të ulej deveja. (shih. Ibn Hisham, II, 494-495.)

Pasi Profeti ynë (a.s.), u vendos në Medinë, Zijad ibn Lebidi (r.a.), nuk u nda më kurrë prej tij. Ai mori pjesë në të gjitha betejat, duke filluar që prej betejës së Bedrit, Uhudit dhe Hendekut. Ndërsa në fushatën e Hadrameutit u caktua si komandant. Ai mori detyra edhe në fushatat e tjera ushtarake që u zhvilluan. Në vitin 631 (e.r), Profeti ynë (a.s.), e dërgoi atë si nëpunës të mbledhjes së zekatit në zonën e Hadrameutit. Të njëjtën detyrë e kreu edhe gjatë kohës së Ebu Bekrit (r.a.). Madje, gjatë kësaj kohe, përgjegjësitë i tij u zgjeruan edhe më tepër, duke u urdhëruar të luftojë edhe kundër rebelëve që donin të dilnin nga feja pas vdekjes së Profetit (a.s.).

Emri i Zijad ibn Lebidit (r.a.), përmendej midis sahabëve që ishin fakihë të njohur. (Ibn Hibban, III, 141.) Në librat burimorë, emri i tij përmendet edhe në transmetimet e haditheve. Ndërsa ky transmetim që përmendet në shumë libra të hadithit, është nga më të njohurit:

Ebu Derda (r.a.), tregon:

“Ne ishim së bashku me Rasulallahun (a.s.), i cili e nguli shikimin e tij në qiell dhe më pas tha: «*Këto çaste, janë çastet kur dija po merret prej njerëzve. Aq sa njerëzit nuk kanë më fuqi për të!*»

Zijad ibn Lebid el-Ensari (r.a.), ndërhyri dhe tha:

«E si do të merret dija prej nesh, ndërkohë që ne jemi duke e lexuar Kuranin o Rasulallah!? Vallahi ne do ta lexojmë edhe vetë atë, por do t'ua mësojmë edhe grave dhe fëmijëve tanë!»

Ndërsa Rasulallahu (a.s.), tha:

“*Allahu të dhëntë mirësi o Zijad! Edhe unë të konsideroj si një nga fakihët e Medinës. (Shiko!) Teurati dhe Ungjilli ndodhet në duart e hebrenjve dhe të krishterëve. E çfarë dobie ka për ta? (Ata i lexojnë por nuk punojnë me to)*” (Musned, IV, 160, 218-219; Ibn Maxhe, Fiten, 26; Taberani, V, 264-265.)

Xhubejri (r.a.), thotë:

U takova me Ubade bin Samitin (r.a.) dhe i thashë:

“A e dëgjove se çfarë tha vëllai yt Ebu Derda!?”, dhe e lajmërova për atë që kishte thënë Ebu Derda (r.a.). Ndërsa ai më tha:

“Ebu Derda ka thënë të vërtetën. Nëse dëshiron, do të të them se cila prej dijeve do të ngrihet e para:

«Dituria e parë që do të ngrihet prej njerëzve, është përkushtimi (me frikë-respekt). Janë afër ditët kur do të hysh në një xhami të madhe e nuk do të shohësh qoftë edhe një person të përkushtuar (në adhurim)!»” (Tirmidhi, Ilim, 5/2653; Darimi, Mukaddime, 29.)

Marrja e diturisë prej njerëzve, do të thotë se ata do të mbeten larg prej urtësisë, thellimit dhe veprimit me dijen. Në fakt, ata duken sikur kanë dije, por nuk mund të hyjnë në të vërtetën e asaj dijeje. Ata nuk mund ta kuptojnë urtësinë e saj dhe nuk punojnë ashtu siç duhet me të.

Zijad ibn Lebidi (r.a.), e priti i habitur lajmin e Profetit (a.s.), për ngritjen e diturisë nga mesi i njerëzve dhe për këtë arsye tha:

- O Rasulallah! Ne dhe fëmijët tanë e lexojmë vazhdimisht Kuranin dhe kjo do të vazhdojë kështu deri në Ditën e Kiametit. Mirëpo, Rasulallahu (a.s.), iu përgjigj se; “Edhe pse Ungjilli dhe Teurati lexohen prej ithtarëve të tyre, ata nuk punojnë me gjykimet e tyre.” Për rrjedhojë, ata libra konsiderohen sikur nuk ekzistojnë fare. Në fakt, ky është një paralajmërim, që kjo të mos ndodhë edhe me ne myslimanët. (shih. Ahmed, V, 266; Hejthem, I, 200.)

Aliju'l-Kari, thotë: “O myslimanë! Mos u bëni edhe ju si ata që e lexojnë Ungjillin dhe Teuratin pa punuar fare me to! Nëse e kuptoni Kuranin dhe nuk punoni me të, ju nuk do të keni asnjë dobi prej tij.”

Zijad ibn Lebidi (r.a.), ka qenë një trim i vërtetë edhe në fushën e betejës. Ai luajti një rol të rëndësishëm në shtypjen e kryengritjeve në Xhuvasa, në zonat e Umanit dhe Mehres, në vitin 633. Ai e mundi Esh'as ibn Kajsin, liderin e fisit të fuqishëm të Kindes dhe e çoi atë përpara halifit Ebu Bekir (r.a.).

Ai ka marrë pjesë edhe në çlirimin e Irakut dhe Sirisë në kohën e Ebu Bekrit dhe Omerit (r.anhuma.), ku ka qëndruar për një farë kohe në Kufe dhe Damask.

Zijad ibn Lebid (r.a.), qëndroi larg ngjarjeve që plasën pas martirizimit të halifes Osman (r.a.) dhe nuk mbajti asnjë anë. Ai bëri një jetë në përputhje me Islamin dhe u mundua ta përhapte atë përreth vetes me mirësi dhe bukuri.

Sipas gjasave, ka ndërruar jetë në vitin 41 hixhri (661 e.r). Mirëpo, nuk dihet se në cilin vend ka ndërruar jetë. Allahu qoftë i kënaqur me të!

Allahu i Madhëruar na e mundësoftë të gjithëve ta jetojmë Islamin me përkushtim dhe devotshmëri si Zijad ibn Lebidi (r.a.). Amin!





Malli për VËLLAZËRINË

Ali Riza Temel

Njeriu hidhërohet së tepërmi kur humbet njeriun më të afërt. Por kur shijon pabesinë dhe tradhtinë e njeriut më të afërt, ai shkatërrohet plotësisht. Për këtë arsye thonë se *“shuplaka e mikut të djeg më shumë”*. Nga armiku pritet armiqësi, ndërsa nga miku pritet miqësi. Njeriu gëzohet kur armiku i bëhet mik. Por ai hidhërohet dhe mërzitet kur miku i tij i bëhet armik. Kjo, sepse shkatërrohet ndjenja e besimit dhe njeriu ndihet sikur i bie mbi kokë shtëpia ku është strehuar.

Ajo që na hidhëron më së shumti sot ne myslimanëve, është pozicionimi i miqve kundër njëri-tjetrit, duke qenë aleatë me armiqët dhe kacafytja e egër midis vëllezërve, gjë e cila vërehet shumë rrallë në historinë njerëzore.

Megjithëse Allahu i Madhëruar, ata që qëndruan në anën e Profetit (a.s.), i përkufizoi si: *“...të ashpër ndaj jobesimtarëve e të mëshirshëm midis tyre...”*¹, sot gjendja është kthyer në të kundërtën. Aq sa prej gjendjes së krijuar, armiqët ndihen të sigurt, ndërsa miqtë të pasigurt. Myslimanët sot, siç shprehet

edhe Kurani, ndodhen në *“...buzë të gremenës së zjarrit...”*²

Në hutben e tij të lamtumirës Profeti ynë (a.s.), ka thënë: *“Pas meje, mos u bëni mohues që vrasin njëri-tjetrit!”* Si është e mundur që ata të cilët thonë se janë umeti i Profetit (a.s.) dhe se e duan shumë atë, të gjenden në një pozitë, e cila do ta hidhëronte jashtë mase atë? Si është e mundur që nuk e mendojnë se po të grinden ndërmjet vete, do të humbasin fuqitë e do të shpartallohen, duke u bërë pre e armiqve të tyre?

Si është e mundur që ata të cilët bien salavatë kur përmendet emri i Profetit (a.s.), që lëshojnë mjekrën dhe përdorin misvakun, sepse është sunet i tij, që organizojnë programe përkujtimi të ditëlindjes së tij e që thonë, u bëfshim kurban në udhën tënde o Rasulullah, i mbyllin veshët para këtyre fjalëve të Profetit (a.s.)?

“Mos e urreni, mos e kini smirë dhe mos i ktheni shpinën njëri-tjetrit! Bëhuni vëllezër, o robërit e Alla-

1. Fet'h, 29.

2. Al-i Imran, 103.

hut! Nuk është e lejuar (hallall) që një mysliman të rrijë më shumë se tri ditë i hidhëruar (e të mos flasë) me vëllain e tij të fesë.” (Buhari, Edeb, 62.)

“Kush qëndron një vit i zemëruar me vëllain e tij mysliman, bën gjynah njësoj sikur të ketë derdhur gjakun e tij.” (Ebu Daud, Edeb, 47.)

“Besimtarët, në dashurinë ndaj njëri-tjetrit, në mëshirë dhe në butësi, janë si organet e trupit, të cilat nuk i zë gjumi, kanë temperaturë dhe e ndajnë dhimbjen kur sëmuret një organ i tij.” (Muslim, Birr, 66.)

“Shtrëngoni duart, që të largohet urrejtja mes jush! Jepini dhurata njëri-tjetrit, që t’ju shtohet dashuria dhe t’ju largohet armiqësia!” (Muuatta, Husnu’l-Huluk, 4.)

“Nuk do të hyni në Xhenet pa besuar dhe nuk do të besoni pa u vendosur dashuria në mes jush.” (Muslim, Iman, 93.)

Ndërkohë që Profeti ynë (a.s.), i ka bërë të qarta kushtet për të qenë umeti i tij dhe robërit e merituar të Allahut, si mund të veprojmë ne si myslimanë në kundërshtim me këto kushte? Si mund të jesh mysliman pa i zbatuar urdhrat e këshillat e Allahut dhe të Dërguarit të Tij (a.s.)? Edhe pse në Kuranin Fisnik urdhërohet disa herë t’i bindemi Allahut dhe të Dërguarit të Tij, sa myslimanë jemi ne me këtë tablo kundërshtimesh që shfaqim vazhdimisht, sa e duam Allahun dhe të Dërguarin e Tij (a.s.)? A nuk jemi të detyruar të shohim gjendjen e jetës sonë, të kontrollojmë myslimanizmin tonë dhe të rregullojmë veten tonë?

Si është e mundur që nuk arrijmë të bashkohemi, ndërkohë që kemi një Zot, një Profet, një Libër dhe një Kibël? A nuk mjaftojnë për të na bashkuar orientimi ynë drejt së njëjtës Kibël, falja në të njëjtën xhami dhe të njëjtin rresht dhe festimi i të njëjtit Bajram? A nuk dëshirojmë të takohemi në të njëjtin Xhenet? Atëherë, ç’është kjo ndarje, kjo kundërshti, kjo ngatërresë, ky kaos dhe kjo smirë?

Një mysliman i mençur është i detyruar ta dijë se çfarë bën dhe shkakun e pozicionit në të cilin gjendet. Ai duhet ta pyesë veten, “çfarë po bëj dhe pse po e bëj, përse ndodhem në këtë pozicion dhe në

këtë rresht?” Një mysliman, nuk mund të veprojë me logjikën e turmës. Në Kuran, paralajmërohet në këtë mënyrë: **“Mos shko pas diçkaje për të cilën nuk ke dijeni. Vërtet, dëgjimi, shikimi dhe zemra, të gjithë këta do të merren në përgjegjësi.”** (Isra, 36)

Në përgjithësi, shkaqet e ngatërresave dhe përçarjeve që përjetojmë, janë dobësitë e egos sonë, injoranca dhe fanatizmi i përkatësisë së një personi, një grupi apo një medh’hebi. Myslimanit nuk i ka hije të veprojë me “logjikën e turmës”, duke i vajtur pas një grupi, pa pyetur e kërkuar dhe pa mësuar shpirtin islam dhe vlerat e tij kryesore.

Nëse personat që ndjekim na bëjnë armiq të njëri-tjetrit dhe u prijnë përçarjeve dhe ngatërresave, ne duhet t’i braktisim menjëherë ata dhe të kthemi në drejtim të umetit. Në xhemat (bashkësi) ka mëshirë, ndërsa në ndarje ka dënim.


Prijësit e xhematëve dhe mendimtarët, kanë vlerë vetëm nëse na bashkojnë me njëri-tjetrin. Nëse ata vënë në plan të parë ekzistencën e xhematit të tyre dhe jo bashkimin dhe unitetin e umetit, do të thotë se ata synojnë shkatërrimin e umetit. Myslimali nuk mund të bëhet kurrë vegla e kapriçove të një personi dhe të ekipit të tij. Parësore, është uniteti i umetit.

Omeri (r.a.), na paralajmëron në këtë mënyrë, në lidhje me përçarjen e myslimanëve dhe rreziqet që do të sjellë kjo përçarje:

“Me sa kam dëgjuar, keni formuar vend-tubime të veçanta. Aq sa këto vend-tubime janë ndarë me parcela dhe kur dy persona

bashkohen, thonë; ky është nga filan grup, e ky nga filan ekip. Betohe në Allahun se kjo gjendje është një rrezik serioz edhe për fenë, edhe për nderin, edhe për paqen edhe për sigurinë tonë. Kjo gjendje, do t’u hapë rrugën atyre që do vijnë pas jush, që ta bëjnë Islamin copa-copa dhe të thonë; ky është mendimi i filanit. Pra, bashkujini vend-tubimet dhe uluni së bashku. Nëse veproni kështu, miqësia jonë do të jetë më e vazhdueshme dhe do të na bëjë të dukemi më madhështorë midis njerëzve”.

Nëse e mbajmë gjithmonë parasysh këtë paralajmërim, do t’i paraprijmë përçarjes dhe shpërbërjes,



Si është e mundur që nuk arrijmë të bashkohemi, ndërkohë që kemi një Zot, një Profet, një Libër dhe një Kibël? A nuk mjaftojnë për të na bashkuar orientimi ynë drejt së njëjtës Kibël, falja në të njëjtën xhami dhe të njëjtin rresht dhe festimi i të njëjtit Bajram? A nuk dëshirojmë të takohemi në të njëjtin Xhenet? Atëherë, ç’është kjo ndarje, kjo kundërshti, kjo ngatërresë, ky kaos dhe kjo smirë?



do të ruajmë unitetin e umetit, forcën, nderin dhe fisnikërinë tonë.

Një mysliman që falet në të njëjtin rresht, që bën tavaf të njëjtën Qabe, që ka si udhëzues Kuranin dhe Sunetin, nuk pozicionohet kundër vëllait të tij mysliman për hir të kapriçove të personave të pajisur me aftësi dhe fantazi të tepruara.

Përçarja nuk ka asnjë arsytim. Nëse ka kundërshtime, dihet mirë se çfarë duhet të bëhet. Parimi i bashkimit, është qëllimi i pastër dhe sinqeriteti. Me ata që janë bërë skllëvër të egoizmit, përfitimit personal dhe lakmisë, nuk shkohet askund. Të bartësh dru për zjarrin e këtyre njerëzve dhe të bëhesh vegël e lakmive të tyre, është një gjynah shumë i madh.

Gjendja e keqe në Ditën e Kiametit të atyre që lidhen verbërisht pas të tjerëve, tregohet në këtë mënyrë në Kuran:

Dhe do të thonë: “O Zoti ynë, ne iu bindëm parisë tonë dhe eprorëve tanë, por ata na shmangën prej rrugës së drejtë. O Zoti ynë, atyre jepu dënim të dyfishtë dhe mallkim të madh!” (Ahzab, 67-68)

“Të gjithë do të dalin para Allahut. (Atëherë), ata që kanë qenë të përlulur, do t’u thonë atyre që kanë qenë kryelartë: “Ne kemi qenë ithtarët tuaj. A do të mund të lehtësoni ju prej nesh diçka nga dënimi i Allahut?” Ata do të thonë: “Sikur të na kishte udhëzuar Allahu në rrugën e drejtë, edhe ne do t’ju kishim udhëzuar ju. Rënkojmë apo durojmë, për ne njësoj është, nuk do të ketë shpëtim.” (Ibrahim, 21)

Faji është individual. Po ashtu edhe dënimi. Gjithkush do të japë llogari sipas mendjes dhe punës së vet. Për rrjedhojë, gjithkush duhet të shohë me syrin e vet, të dëgjojë me veshin e vet dhe të mendojë me mendjen e vet. Ata që i kanë në rregull shqisat dhe mendjen, nuk kanë të drejtë të prodhojnë arsytetime. Gjynahu i veprave të bëra me dëshirë dhe vullnet të lirë, i takon vetëm atij që i ka bërë. Po kështu është edhe ndjekja e gjurmëve të shejtanit. Prandaj, askush

nuk duhet ta arsyetojë veten duke fajësuar shejtantin. Është e domosdoshme të dihet se përgjegjësia është individuale dhe, në bazë të kësaj të veprohet. Edhe vetë shejtani është një mjet sprove. Për rrjedhojë, shejtani e shpreh kështu pozicionin e tij:

“...Vërtet, Allahu ju bëri një premtim të vërtetë. Edhe unë ju premtova, por ju mashtrova. Unë nuk kam pasur kurrfarë pushteti mbi ju. Unë thjesht ju thirra e ju m’u përgjigjtë. Prandaj, mos më qortoni mua, por qortoni veten! Unë nuk jam shpëtimtari juaj e as ju nuk jeni shpëtimtarët e mi...” (Ibrahim, 22)

Kushdo qoftë ai që e prish miqësinë dhe vëllazërinë tonë dhe në cilëndo pozitë qoftë ai, kjo nuk na shpëton ne nga gjynahu nëse e ndjekim atë. Edhe pse ligjëratat e tij mund të jenë fetare, dhe bëhen në emër të Allahut dhe të Dërguarit të Tij (a.s.), nëse ato na bëjnë armiq të njëri-tjetrit, na bëjnë shkallë të lakmive të tij dhe të synimeve të armiqve tanë, ne nuk duhet të mashtrohemi kurrë nga fjalët dhe sjelljet e tij të bukura dhe entuziaste.

Gjatë gjithë historisë ne jemi mashtruar nga armiq të tanë e sidomos nga ata me petkun e mikut që duken prej nesh. Dhe për pasojë, kemi derdhur gjakun e njëri-tjetrit. Kjo gjë duhet të marrë fund njëherë e përgjithmonë. Besimtari nuk mund të kafshohet dy herë nga i njëjti gjarpër. Neve na takon të bëhemi të mençur dhe të marrim mësim nga e kaluara.

Edhe për sa kohë do t’i bëjmë të qeshin armiq të tanë dhe të qajnë miqtë tanë? E përse të mos na bashkojë Islami që i bëri vëllezër Bilalin, Selman Farisiun dhe Suhejb Rumiun, duke na bërë përsëri “umetin më të mirë”? Përse ata që duhet të jenë të rreshtuar e të kapur fort në rrugën e Allahut janë në anën e armikut? Përse i rregullojnë të tjerët dhe shkatërrojnë veten e tyre? Përse ua mohojnë njëri-tjetrit qoftë edhe një buzëqeshje? A do të na kalojë jeta duke u përmalluar për miqësinë e kohëve të shkuara? E përse duhet të mallkojmë e të mallkohemi, kur mund të duam e të duhemi?

DUAJA

Ebu'l Hasan el-Magribi Shazeli, ka thënë:

“Duhet të gëzohesh që ke fat të bësh dua dhe të është plotësuar dëshira! Kënaqu që arrin t'i drejtohesh të Dashurit tënd (Allahut), me qëllim që të mos bëhesh prej atyre që u është vënë perdja!”

Ndërsa Abdulkadir Geylani, ka thënë:

“Mos thuaj, «Unë nuk i lutem Allahut», duke u arsyetuar me fjalët, «lutja ndaj Allahut, është një adhurim i bukur që e kërkon devotshmëria, por sido që të jetë ajo që do të vijë do të vijë, e ajo që nuk do të vijë nuk do të vijë!»

Lutu vazhdimisht! Lutju Allahut duke iu përgjyruar për punët e kësaj bote dhe të botës tjetër që nuk janë haram! Kërko prej tij çdo gjë që nuk është haram dhe që nuk e cenon moralin, sepse Allahu i Madhëruar, urdhëron: **“...Lutmëni Mua, se do t’ju përgjigjem!..”** (Gafir, 60) **“...Kërkoni prej Allahut nga mirësitë e Tij!..”** (Nisa, 32) Por mos i bëni ato mirësi shkak mburrjeje ndaj njëri-tjetrit!

Kush bën dua, e di shumë mirë se Allahu i Madhëruar është Ai që jep çdo gjë. Kush bën dua nuk është mendjemadh. Për këtë arsye, duaja, duhet të jetë pjesë e virtyteve të bukura të besimtarit. Ai nuk duhet të largohet prej duasë, sepse ajo ka shumë dobi.

Disa dua të Profetit tonë (a.s.):

- O Allah! Strehohem tek Ti prej burracakërisë, koprracisë, sëmundjes së zemrës dhe dënimit të varrit!

- O Allah! Strehohem tek Ti nga e keqja e veshit, syrit dhe gjuhës sime!

- O Allah! Strehohem tek Ti prej burracakërisë, dobësisë së pleqërisë, fitnes së kësaj bote dhe dënimit të varrit!

- O Allah! Strehohem tek Ti prej dobësisë, përtacisë, koprracisë, rënies materiale dhe shpirtërore, dënimit të varrit dhe fitnes së jetës dhe të vdekjes!

- O Allah! Strehohem tek Ti prej mendimeve të

padobishme, hidhërimit dhe dobësisë, përtacisë dhe koprracisë, burracakërisë dhe borxhit dhe prej mundimit të njerëzve!

- O Allah! Strehohem tek Ti prej qëndrimit në vendet ku bëhen gjynahe dhe nga zhytja në borxhe.

- O Allah! Strehohem tek Ti prej urisë, varfërisë, poshtërimit, padrejtësisë sime ndaj të tjerëve dhe padrejtësisë së të tjerëve ndaj meje.

- O Allah! Strehohem tek Ti prej gabimeve, devijimit, padrejtësisë sime ndaj të tjerëve dhe padrejtësisë së të tjerëve ndaj meje, injorancës dhe rënies në dorë të injorantit.

- O Allah! Strehohem tek Ti prej çmendurisë, lebrës, sëmundjes së lëkurës dhe sëmundjeve të këqija!

- O Allah! Strehohem tek Ti prej të keqes së asaj që kam vepruar dhe nuk kam vepruar.

- O Allah! Strehohem tek kënaqësia Jote prej këputjes, rënies mbrapsht, mbytjes, djegies, prej sulmit të shejtanit në momentin e vdekjes, nga vdekja duke qenë larg rrugës Tënde dhe nga vdekja prej pickimit të gjarprit!

- O Allah! Strehohem te Ti prej dënimit të betimit! (Marrë prej Musahabe /4, Mahmud Sami, Suneni Nesai)

Ibrahim bin Et’hemini e pyetën:

- Përse nuk na pranohen duatë?

Ibrahimi u përgjigj:

“E njihni Allahun, por nuk i zbatoni urdhrat e Tij dhe Sunetet e Profetit (a.s.). E lexoni Kuranin, por nuk punoni me të. Hani mirësitë e Krijuesit, por nuk falënderoni. Besoni se ka Xhenet, por nuk e kërkonit atë dhe nuk keni frikë prej Xhehenemit. E dini mirë se ekziston vdekja, por nuk përgatiteni për të. I varrosni prindërit tuaj në tokë me duart tuaja, por nuk merrni mësim. E si t’ju pranohen duatë me gjithë këto gabime që bëni?”





A është **GLOBALIZIMI** i mirë për **BOTËN MYSLIMANE**?

Abdullah Rinat Muhametov

Sot, kur vjen puna për t'u diskutuar në qarqet shkencore dhe në masmedia ndikimi i globalizimit mbi botën islame, në debat sillen vetëm aspektet negative të këtij procesi.

Bota islame e gjeti veten në kapërcyell të shekullit në qendër të proceseve të globalizimit, të zhvilluara në planetin tonë në një përqindje në rritje dhe duke e ndryshuar karakterin e tyre teknik nga pikëpamja shkencore në një të tillë politik nga pikëpamja sociale. Pas ngjarjeve të 11 shtatorit erdhëm madje te një ndërhyrje e drejtpërdrejtë ushtarake e SHBA-ve dhe e aleatëve, që synonin, siç u shpreh Shtëpia e Bardhë, ta demokratizonin botën islame dhe t'i jepnin trajtë një "Lindje të Mesme të re".

E megjithatë, proceset e globalizimit nuk kufizohen me çka u përmendën më sipër. Globalizimi, duke qenë një proces objektiv, nxit dhe sjell tendencat më të larmishme në botën islame, e ato konstruktive dhe perspektive midis tyre. Këto shndërrime janë me interes të veçantë, sepse ato jo vetëm po e ndryshojnë seriozisht hartën e botës islame, por gjithashtu po ndikojnë mbi rendin ndërkombëtar në formimin e tij.

Nocioni i botës islame vetëm tani është shkëputur plotësisht nga dimensionin i vet gjeografik. Është pikërisht në sajë të përfitimit nga globalizimi që bota islame është bërë një fenomen eksterritorial ndërkombëtar politik, fetarisht, dhe kulturor, shoqërisht, që pretendon për një pjesëmarrje serioze në punët e botës, pas të qenit një bashkësi vendesh të hapësirës së gjerë myslimane.

IDENTITETI I RI MYSLIMAN TRANSNACIONAL

Nën ndikimin e proceseve të globalizimit po merr formë një identitet i ri transnacional mysliman dhe ideologjia pasuese. Sot mund të takosh në thuajse çdo cep të botës islame të tillë "myslimanë të rinj" apo "ulema të re".

Vetëdija e tyre karakterizohet nga globaliteti. Ata janë të orientuar nga marrja në konsideratë e trashëgimisë së tyre dhe e tërë njerëzisë, duke qenë të njohur një-lloj mirë me të dyja. Detyra e këtyre njerëzve është të riformatojnë bazën ideologjike të botës islame, duke ofruar rrugë origjinale për përtëritjen dhe modernizimin islam. Kjo kategori njerëzish mund të japë një kontribut të rëndësishëm për ndryshimin e pamjes së diasporave dhe vendeve islame në shekullin e 21-të.

Në të njëjtën kohë, diasporat myslimane të vendeve perëndimore që po nisin të përparojnë në pozicione udhëheqëse në botën myslimane, të lindura dhe të zhvilluara nga përfitimi i proceseve të globalizimit, shfaqin aftësinë për të formuluar një përgjigje adekuate të Islamit ndaj sfidave moderne. Në tërësi, pakicat myslimane, diasporat, po përbëjnë tani një të katërtën e ummetit mysliman të botës.

Ky mjedis paraqitet me një numër goxha të madh (së paku, krahasuar me vendet e hapësirës së gjerë myslimane) myslimanësh aktivë dhe tejet të shkolluar, të vetëdijshëm për realitetet e jetës perëndimore, e në gjendje për ta marrë në konsideratë në mënyrë kritike trashëgiminë e filozofisë dhe kulturës perëndimore nga një këndvështrim islam.

Nëse për brezin e parë të emigrantëve kishin rëndësi më të madhe çështjet ekonomike, është e zakonshme që fëmijët dhe nipëri e tyre të kenë interes të lartë për çështjet e besimit, identitetit, gjuhës, e trashëgimisë kulturore. Këto pakica po punojnë sot në mënyrë aktive në fushën e arsimit, në administratën lokale, dhe në masmediat e tyre. Xhamitë dhe mesxhidet, numri i të cilëve po rritet vazhdimisht, luajnë rolin jo vetëm të qendrave fetare, por dhe politike, duke organizuar kurse gjuhe, duke dhënë ndihmë ligjore, dhe, çfarë është më e rëndësishmja, duke u bërë qendra të komunikimeve myslimane.

Qendrave tradicionale të hapësirës myslimane, të përfaqësuara nga ca vende arabe, po u bashkohen tanimë vende islame të Azisë juglindore (Malajzia mund të nënvizohet posaçërisht në këtë pikëpamje), që e kanë shtuar peshën e tyre me anë të pjesëmarrjes ekonomike në proceset e globalizimit. Nën efektin e proceseve të globalizimit, dhe si rezultat i tyre, nuk duhet përfshuar nisja e integritit rajonal të botës myslimano-arabe, e forcimit të botës myslimano-turkike dhe e bashkësisë islame ruse, si dhe integrimi i përgjithshëm i botës islame mbi parime të reja, fare pak të dallueshme sot.

Këtu është e rëndësishme të vihet në dukje se integrimi i ri i vendeve të hapësirës së gjerë myslimane mund të sigurojë një aleat të ri, të përfaqësuar nga diasporat e shumta myslimane, e ato të vendeve perëndimore në vend të parë. Dhe e gjithë kjo do të lejojë forcimin e rolit të tërë botës myslimane në konfliktin e përgjithshëm global të aktorëve udhëheqës politikë, që po i jep formë rendit të ri botëror. Bota islame ka mundësinë për të siguruar një numër epërsish të rëndësishme: ajo mund të veprojë menjëherë në sferën ndërshtetërore (nëpërmjet shteteve me popullsi myslimane), në sferën ideologjike (përmes sistemit të diasporave, bashkësive, lëvizjeve, OJQ-ve ndërkombëtare islame, etj.), në sferën fetaro-shpirtërore (përmes rrjetit të xhamive dhe qendrave islame). Po ashtu mund të shtojmë këtu faktin se diasporat islame ekzistojnë në ditët e sotme në të gjitha vendet anembanë botës.

Është e qartë se qendrat e pushtetit rreth e rrotull botës do të duan të sigurojnë mbështetjen e vendeve të hapësirës myslimane në rritjen e rivalitetit në arenën ndërkombëtare, që inkurajon krijimin e termit “shtetet mike të myslimanëve”.

NDIKIMI I GLOBALIZIMIT

Nën ndikimin e proceseve të globalizimit janë forcuar veçoritë kulturore, ideologjike dhe social-kulturore të botës myslimane, dhe është në udhë e sipër formimi i një vetëdije të re politike transnacionale të myslimanëve.

Falë cilësisë së medias panarabe të shfaqur së fundi, e cila shfrytëzon përvojën dhe arritjet e gazetarisë perëndimore, është krijuar një hapësirë e re informativo-kulturore, ideologjike, e madje teologjike. Ndikimi i tyre nuk është kufizuar me vendet arabe. Këto media shihen nga njerëz rreth tërë botës islame, sepse arabishtja mbetet ende gjuha e komunikimit ndërkombëtar të të gjithë myslimanëve, e veçanërisht e elitës islame.

Nga të parët që do t'i shfrytëzonin avantazhet e globalizimit ishin bankat dhe kompanitë që e zhvillojnë aktivitetin e tyre në përputhje me normat e ligjit shehriatik.

Një tjetër fakt që tregon për ndikimin e globalizimit mbi bashkësinë myslimane të botës është ai i rritjes së sasisë së literaturës, ngurtësisht fetare apo të lidhur me tema të tjera, të botuar në anglisht, në gjuhën e internetit dhe të globalizimit.

Gjithashtu është me rëndësi të vihet në pah se gjuhët kombëtare të myslimanëve po nisin nën efektin e proceseve të globalizimit të qëndrojnë pranë arabishtes, persishtes dhe urdishtes, të përdorura më herët nga teologët dhe mendimtarët myslimanë. Në këtë pikëpamje, një dijetar i mirënjohur malajzian, Sejjid Muhammed Nakib el-Attasi, futi madje nocionin e veçantë të “gjuhës islame”, që ai e kupton si “shtënie të një fjalori bazë të termave islamë në gjuhët e popujve myslimanë”.

GLOBALIZIM I OKSIDENTALIZUAR?

Ndërkaq, vetëdija masive e myslimanëve ende e percepton globalizimin si një drejtim shumë negativ.

Globalizimi konsiderohet të jetë një “gjethe fiku” që mbulon dëshirën e qarqeve sunduese të SHBA-ve dhe të vendeve të tjera perëndimore për t'i imponuar me forcë një rend të tillë botëror tërë njerëzimit, duke përfshirë myslimanet, që do të përkojë ekskluzivisht me interesat e tyre. Nisma të ndryshme në botën myslimane, si operacionet në Afganistan dhe në Irak, mbështetja amerikane për Izraelin, përmendja e vendeve të tjera islame si pjesë të “boshtit të së keqes”, konsiderohen në mënyrë të argumentueshme të mos jenë asgjë tjetër, veç një luftë kundër Islamit, e nganjëherë, në rrethe të gjera popullore, si një kryqëzatë e re.

Shumë myslimanë janë veçanërisht të indinjuar me “makdonaldizimin” dhe “kokakolonizimin” e kulturës, që i shkatërrojnë traditat e vjetra. Produkteve lokale u duhet sot t'i imitojnë produktet ndërkombëtare për të mbijetuar.

Për më tepër, bizneset e mëdha dhe ndikimi amerikan e kanë sjellë planifikimin dhe arkitekturën e stilit amerikan në vendet e Gjirit. Janë zhdukur arkitektura tradicionale, pazaret orientale dhe kafenetë, dhe vendin e tyre e kanë zënë qendrat tregtare, lokalet e ushqimit të shpejtë, restorantet dhe hotelet. Edhe Meka, qyteti i shenjtë i Islamit, nuk mund t'i shmangej këtij fati.

Por veç reagimit të fortë negativ të botës myslimane ndaj globalizimit, ka përpjekje për ta parë në mënyrë kritike dhe për të dhënë një përgjigje konceptuale për të. Revolucioni intelektual islam po ngjet në shumë pjesë të botës myslimane, si dhe në bashkësitë islame në Perëndim.

Me fjalë të tjera, globalizimi aktual polemizues, bashkë me problemin e konsumit dhe të shpërbërjes së botës myslimane, ka gjithashtu një efekt paradoksal të kundërt. Ai nxit zgjimin dhe modernizimin e botës myslimane mbi bazën e themelit të saj teoriko-ideal, të rishqyrtuar brenda kontekstit të modernitetit.

Bashkë me vendosjen e një modeli të unifikuar kulturor dhe ideologjik, të përshtatur me standardet neoliberales perëndimore, globalizimi, sado e çuditshme të duket, stimulon shfaqjen e një formati të ri të botës islame, dhe i jep një impuls shtesë procesit të zgjimit të saj. Ky i fundit ka një perspektivë serioze për t'u bërë jo vetëm një proces thelbësishëm i rëndësishëm për vetë botën islame në shekullin e 21-të, por në të njëjtën kohë do të ndikojë në zhvillimin e të gjithë njerëzisë.



Përpyjekja e gjithë jetës:

TË JESH ROB I ALLAHUT

Nuredin Jëlldëz

Arsyeja se përse Zoti ynë na krijoi, dihet. Ai dëshiron që ne të bëhemi robër të Tij. Ai kërkon devotshmëri edhe prej atij që krijoi në shkretëtirë, edhe prej atij që krijoi në qytet. E njëjta gjë vlen edhe për ata që janë krijuar në të shkuarën, edhe për ata që krijohen sot. Allahu ka kërkuar të njëjtën gjë, si prej bijve të profetëve, ashtu edhe prej atyre që nuk i kanë ditur emrat e baballarëve të tyre. Të qenit rob, është e përbashkëta e çdo njeriu. Të jesh rob dhe të veprososh si rob, është një realitet prej të cilit askush nuk bën përjashtim. Nëse të gjithë njerëzi do të jetonin si robër të Allahut, duke bërë atë që duhet, pa bërë dallim në hapësirë dhe kohë, ata do të realizonin qëllimin e krijimit të tyre në këtë botë.

Ndërsa cilësia e robërisë që kërkon të shohë prej nesh Allahu i Madhëruar, i Cili na krijoi si robër të Tij, mund të quhet robëri, vetëm atëherë kur të jetë ashtu

siç e kërkon Ai. Përcaktimi nga ana jonë si robër, i një forme të zbatimit të robërisë, është vetëm një punë e padobishme. A është e mundur që ne si robër të vendosim standardet dhe detajet e zbatimit të robërisë ndaj Allahut? Padyshim se kjo pyetje nuk mund të marrë tjetër përgjigje përveç fjalës “kurrë”. Popujt që kanë jetuar para nesh, për shkak se kanë tentuar të veprojnë në këtë mënyrë, tashmë kanë mbetur vetëm si pjesëtarë të një feje të devijuar. Formën e robërisë, e përcakton vetëm Ai që e ka urdhëruar atë. Kjo është e natyrshme.

Zoti ynë, me anë të librit të Vet që na ka zbritur, Kuranit dhe shpjeguesit të Kuranit, që janë hadithet e Profetit të Tij (a.s.), na e ka përcaktuar qartë se çfarë lloj robërie dëshiron prej nesh. Nisur nga kjo, të gjitha urdhrat dhe ndalesat që na ka vënë përpara libri ynë, Kurani Fisnik, janë lista e plotë e atyre që

kërkohen prej nesh. Po ashtu, urdhrat e Profetit tonë (a.s.), ndalesat dhe të dhënat lidhur me mënyrën e tij të jetesës që kanë ardhur deri tek ne, janë përmbledhja e të gjitha informacioneve se çfarë dhe si duhet të jetë robëria jonë ndaj Allahut. Për rrjedhojë, ne si besimtarë, e kemi për detyrë t'i mësojmë nga këto burime detajet e atyre që priten prej nesh dhe t'i jetojmë ato në mënyrën më të bukur.

Ky është edhe kuptimi i thirrjes së ezanit në mes të shkretëtirës kur i vjen koha. Ky është edhe kuptimi i zbritjes me ashensor prej ndërtesave të larta në mes të qytetit për të shkuar në xhami në faljen e namazit. Kjo është arsyeja që e falim namazin edhe kur jemi duke udhëtuar me aeroplan apo kur shqetësohemi për namazin edhe kur gjendemi në spital në sallën e reanimacionit. Me këtë lloj botëkuptimi sipas kohës së namazit, përcaktojmë edhe udhëtimet, punët, mbledhjet apo dasmat tona. Ne e dimë mirë se namazi, është më lart se çdo kohë dhe çdo vend, sepse namazi është urdhri i Zotit tonë. Dhe, urdhri i Zotit tonë, është i vetmi dhe i pari në çdo kohë dhe vend që ka krijuar Ai.

Ne jemi robër dhe robëria jonë, është gjithçka që kemi, madje arsyeja e ekzistencës sonë. Këtë nuk e kemi caktuar ne, por Ai që na ka krijuar.

Me këtë sy i shohim edhe ndalesat para nesh. Edhe nëse alkooli nuk do ta dëmtonte trupin tonë, ne jemi robërit e një jete pa alkool. Nëse kamata do të ishte kafshata më e rëndësishme për jetën tonë, ajo prapë është e shëmtuar para syve tanë. Haramet i njohim si helm dhe po ashtu i shohim. Në jetën tonë s'mund të hyjë harami dhe, për këtë përpiqemi. Qofshin të ëmbla apo të hidhura haramet, ne kështu besojmë dhe kështu do të mundohemi të jetojmë. Ne jemi robër dhe formën e robërisë e ka caktuar Ai që na ka krijuar. Ne i bindemi Atij dhe prej Tij presim mirësi.

Çfarë të na ketë urdhëruar dhe ndaluar libri ynë që kemi në duar, Kurani, dhe çfarë të na ketë treguar profeti (a.s.), ato janë jetë për ne. Bindja ndaj atyre urdhrave dhe ndalesave, është qëllimi i jetës sonë, është fusha e betejës sonë. Sido që të quhet, çdo gjë që e ka burimin tek Kurani dhe Profeti (a.s.), është thelbi i robërisë sonë. Dhe, zbatimi i saj quhet xhihad, emri i luftës sonë. Nëse quhet farz, është xhihad

Zoti ynë, me anë të librit të Vet që na ka zbritur, Kuranit dhe shpjeguesit të Kuranit, që janë hadithet e Profetit të Tij (a.s.), na e ka përcaktuar qartë se çfarë lloj robërie dëshiron prej nesh.

Padyshim se ky është edhe rregulli për agjërimin.

Duke e parë kështu edhe haxhin, arrijmë të ndjehmë ëmbëlsinë e të qenit besimtar.

Po ashtu, edhe kur therim një kafshë në Bajramin e Kurbanit, para mishit dhe dhjemit, në plan të parë është entuziazmi i devotshmërisë. Ose së paku kështu duhet të jetë.

Edhe kur japim sadaka, qoftë atij që na kërkon para xhamisë, qoftë atyre që ua dërgojmë në anën tjetër të botës, atë nuk e merr ai të cilit ia japim. Ne e dimë se sadakanë ia japim Zotit tonë që e ka urdhëruar dhe me atë dhënie ndjehmë kënaqësi. Ky është besimi ynë, kështu është.

farz, nëse quhet sunet, është xhihad sunet. Ne jemi umeti i xhihadit dhe me xhihad jemi urdhëruar.

Nëse qëllimi është robëria ndaj Allahut, nëse çdo urdhër dhe ndalesë lidhur me robërinë, mbush një vend dhe shkruhet në emrin tonë, si mund të përcaktohet robëria, e madhe apo e vogël? Çdo punë, urdhëruesi i së cilës është Allahu, është një përfitim për ne. Prandaj, ne duhet ta çojmë në vend detyrën tonë të robërisë pa i kategorizuar ato si të mëdha apo të vogla, duke u përpjekur me entuziazëm që të arrijmë mëshirën e Allahut. Por, edhe nëse na bëhet e ditur se cila është e madhe dhe cila është e vogël prej atyre që ndodhen në listë, në kohën në të cilën ndodhemi, ne nuk mund ta përmbushim misionin tonë të robërisë ndaj Allahut, edhe nëse i përdorim të gjitha mundësitë që kemi.

MAJ 1453

FUNDI I ANARKISË DHE RIKTHIMI I PERANDORISË NË BALLKAN

✦ *Dr. Ardian Muhaj* ✦

Që prej kryqëzatës së katërt Perandoria Bizantine u shndërrua në një hije të asaj perandorie që kishte qenë kështjellë mbrojtëse e qytetërimit mesdhetar përballë valës shkatërruese të popujve të stepave që kishin sjellë aq shkatërrime e fatkeqësi në antikitetin e vonë dhe mesjetën e hershme. Përpara dyndjes së popujve, romakët kishin krijuar një rrjet urban të dendur dhe të shpërndarë racionalisht në përputhje me pozitën gjeografike dhe konfigurimin e relievit, duke favorizuar qendrat urbane në pikëtakime rrugësh tregtare, në nyje strategjike dhe në afërsi të zonave më pjellore dhe më të zhvilluara ekonomikisht. Për më se një mijë vjet nga fillimi i dyndjes së këtyre popujve në Ballkan, qendrat qytetare në lartësitë e ulta u shkatërruan plotësisht me përjashtim të pak porteve që gëzonin mbrojtje të mirë natyrore nga prapatoka dhe dalje të lehtë e të sigurt në det. Një nga arsytet e qëndrësës së Kostandinopojës përballë këtyre sulmeve ishte pikërisht kjo pozitë e favorshme strategjike që siguronte njëkohësisht mbrojtje dhe komunikim të lehtë e të shpejtë të qytetit.

Megjithatë gradualisht, duke filluar nga kryqëzata e katërt, Kostandinopoja shkon duke e bjerrë rëndësinë e saj derisa nga mesi i shekullit XIV e deri në marrjen e saj nga osmanët do shndërrohet në një kryeqytet të një perandorie relikte të kohës, në një kryeqytet pa shtet të mirëfilltë. Akoma pa u dukur osmanët në horizont Kostandinopoja ishte tkurrur si qytet dhe pasqyronte krizën e thellë të pushtetit bizantin. Ndërkohë që Kostandinopoja bizantine ishte në dekadencë të plotë, kolonia gjenoveze e Perës, dy hapa më tej lulëzonte. Doganat e Kostandinopojës në shekullin XIV mblidhnin jo më shumë se 30 mijë iperperë në vit, ndërsa dogana gjenoveze e kolonisë së Gallatës, mblidhte jo më pak se 200 mijë në vit. Në darkën e martesës së perandorit Joan V Palaeolog në 1347, ushqimet e pijet u servirën në enë balte e bakri, dhe sipas përshkrimeve të Niqifor Gregoras, as edhe një enë prej argjendi ose ari nuk shihej në tavolina. Rrobat dhe kurora ishin stolisur me qelq të lyer në vend të diamantëve. Thesari perandorak ishte bosh, dhe nuk kishte ngelur më asgjë në të veç ajër e pluhur. Ai e mbyll me trishtim rrëfimin e tij duke thënë se shkëlqimi dhe begatia e dikurshme e Bizantit ishte zhdukur dhe duke theksuar se “më vjen shumë turp që më duhet ta shkruaj këtë kronikë”. Vetë perandori ishte zhytur në borxhe, deri në atë pikë sa që në një udhëtim në Evropë, ai u arrestua për borxhe në kohën që ndodhej në Venedik dhe u mbajt deri sa pagoi shumat e marra.

Në maj 1453 gjendja e anarkisë në Ballkan dhe Lindjen e Afërt, do të shkonte drejt fundit. Frika dhe pasiguria që e kishte shoqëruar jetën e banorëve të Ballkanit për shekuj të tërë u venit ngadalë me rikthimin e pushtetit perandorak në Stamboll, më 29 maj 1453, mbas një rrethimi relativisht të shkurtër për rëndësinë që paraqiste ky qytet. Paraprakisht sipas praktikës më të mirë islame dhe parimet e humanitetit, Sulltan Mehmet Fatihu kishte kërkuar nga sundimtari bizantin Konstantini XI që ta dorëzonte qytetin në mënyrë paqësore, në mënyrë që të evitohet gjakderdhja e panevojshme, kur fati i qytetit tashmë ishte i qartë.¹

Perandori bizantin nuk pranoi dorëzimin paqësor të pushtetit duke rrezikuar në këtë mënyrë jo vetëm banorët e rrethuar, por edhe të ardhmen e tyre nën sundimin e ri. Megjithatë, në vend të hakmarrjes që popullsia e qytetit priste, perandori i ri Mehmeti II Fatihu, në atë kohë i ri, energjik dhe vizionar, arriti të kryejë një tranzicion paqësor të pushtetit nga linja perandorake bizantine që ishte treguar e paaftë për të përmbushur detyrën e vet, si zotërues të urës lidhëse më të rëndësishme mes Evropës dhe Azisë, mes Mesdheut dhe Detit të Zi, dhe si trashëgimtarë të perandorëve të shquar romakë.²

1. Timothy E Gregory, *A History of Byzantium*. Oxford: John Wiley and Sons, 2010, f. 394–399

2. Sulltan Mehmeti Fatihu u shpall me të drejtë si “Kaysar-i Rûm”, pra perandor edhe i bizantinëve duke mbartur me vete k -

Perandorët e parë, apo sulltanët siç quheshin në traditën osmane, treguan njëkohësisht aftësi përshtatjeje dhe inovacioni, duke nxjerrë mësim nga gabimet e perandorëve bizantinë dhe shpesh duke lehtësuar barrën fiskale nga nënshtetasit e tyre, siç ishte për shembull puna angari apo e detyrueshme, që në periudhën e mëparshme kishte përhapje të gjerë. Nga ana tjetër një nga arsyt e jetëgjatësisë befasuese të Perandorisë Osmane ishte edhe fakti që linja e re perandorake osmane kudo ku nënshtetasit e saj kërkonin ruajtjen e ligjeve dhe privilegjeve të mëparshme, dhe në rast se nuk binin në kundërshtim të hapur me ligjin e shtetit, i respektonte këto të drejta e privilegje lokale, madje garantonte edhe zbatimin e tyre. Në këtë rast, Perandoria Osmane sjell një kontribut të ri dhe një këndvështrim tërësisht të panjohur më parë në Ballkan, që ishte toleranca fetare dhe bashkëjetesa mes besimeve të ndryshme, duke u mbështetur në doktrinën islame që harmoninë fetare dhe bashkëjetesën paqësore mes feve monoteiste i konsideronte si detyra parësore të sundimitarit mysliman.³

Nuk duhet harruar se në perandorinë bizantine, apo në shtetin bullgar e serb, sundimtarët ndiqnin parimin e konvertimit kolektiv të bashkësive të ndryshme që binin nën sundimin e tyre. Sa herë që një territor katolik kalonte nën sundimin ortodoks dhe anasjelltas, suprimohej krejt organizimi kishtar i mëparshëm dhe vendosej organizimi i ri sipas fesë së sundimtarëve të rinj. Kjo intolrancë fetare mori fund me sundimin e ri perandorak osman. Perandoria një-fetare bizantine, ashtu si edhe shteti njëfetar bullgar e serb, u zëvendësuan me perandorinë shumë fetare osmane, në përputhje me të drejtat e njeriut të garantuara në të drejtën islame. Jo vetëm që Perandoria Osmane u kthye në një strehë shpëtimi për hebrenjtë e persekutuar në Evropë, por nuk duhet harruar se të krishterët përbënin në pjesën më të madhe të Ballkanit, shumicën e popullsisë gjatë gjithë ekzistencës së perandorisë. Jomuslimanët i nënshtroheshin juridiksionit të sulltanit dhe sheriatit në marrëdhëniet me myslimanët, dhe udhëhiqeshin prej prijësve të tyre fetarë të zgjedhur prej gjirit të bashkësisë së tyre fetare për çështje të ushtrimit të fesë dhe kodit ligjor civil.

Në dallim nga të gjitha praktikatat e mëparshme kur të mundurve u hiqeshin të drejtat fetare, një konkordatë apo marrëveshje e parë me të drejta e privilegje iu akordua patriarkanës ortodokse që më 1453, më pas fesë hebreje dhe armenëve e më vonë edhe komuniteteve katolike e protestante të perandorisë. Kisha kryesore e Konstantinopojës, Aja Sofia u shndërrua në xhaminë kryesore të qytetit të ripërtëritur. Kjo ishte e natyrshme, mbasi ashtu sikurse institucionet qendrore, ashtu edhe objekti kryesor fetar duhej t'i përkiste fesë së sundimitarit të ri. Por kishat dhe objektet e tjera të kultit nuk u prekën dhe dëshmi e kësaj janë edhe kishat e shumta ortodokse në lagjen më të vjetër të Stambollit modern. Në fakt, kjo nuk ishte hera e parë që kisha e Shën Sofisë shndërrohej nga një kishë ortodokse në një objekt kulti të një feje tjetër. Më 1204, Aja Sofia ishte shndërruar në kishë katolike, dhe për më tepër me atë rast edhe ishte zhbërë ose suprimuar patriarkana ortodokse dhe krejt organizimi kishtar bizantin. Kjo nuk ndodhi dhe nuk mund të ndodhte kurrësi me marrjen e pushtetit nga Mehmet Fatihu.

Rritja e jashtëzakonshme e Stambollit dhe rimarrja e rëndësisë perandorake solli me vete një frymë kozmopolite të kryeqytetit përmes së cilës sheshoheshin dhe tejkaloheshin si askund tjetër ndasitë etnike dhe fetare. Menjëherë mbas marrjes së Stambollit perandori Mehmet Fatihu iu përkushtua punës për ripërtëritjen e jetës qytetare të kryeqytetit. Ai ftoi që të rikthehen në shtëpitë e tyre të gjithë ata që kishin braktisur qytetin gjatë rrethimit dhe njëkohësisht ftoi që të vendosen në të bashkësi të tërë myslimanësh, hebrenjsh e të krishterësh nga Anadulli dhe Ballkani. Vetëm gjatë verës së atij viti u rivendosën ose u vendosën 5 mijë familje në qytetin e rigjallëruar.⁴ Ai nxiti dhe mirëpriti vendosjen e njerëzve jo vetëm nga perandoria osmane, por nga e gjithë Europa.⁵ Në këtë mënyrë Stambolli u kthye në qytetin më të madh në Evropë për dy shekuj e gjysmë, nga 1500 deri në 1750 kur u tejkalua nga Londra.⁶


shtu trashëgiminë e perandorisë bizantine. Pierre Béhar, *Vestiges d'Empires: La Décomposition de l'Europe Centrale et Balkanique*. Paris: Éditions Desjonquères, f. 38; Robert Bideleux, Ian Jeffries, *A History of Eastern Europe: Crisis and Change*. New York and London: Routledge, f. 71.

3. Shih për rastin më të afërt shqiptar dhe të Ballkanit perëndimor: Frederic F. Anscombe, *The Ottoman Balkans, 1750-1830* (Princeton, New Jersey: Markus Weiner, 2006); Metin Kunt, "Ethnic-Regional (Cins) Solidarity in the Seventeenth-Century Ottoman Establishment", *International Journal of Middle East Studies* 5 (1974): 233-39.

4. Halil Inalcik, "The Policy of Mehmed II toward the Greek Population of Istanbul and the Byzantine Buildings of the City." *Dumbarton Oaks Papers* 23, (1969), f. 236.

5. Peter M Holt, Ann K. S Lambton, Bernard, Lewis, eds. *The Cambridge History of Islam*, Cambridge University Press, 1977, f 306-3077.

6. Tertius, Chandler, *Tertius, Four Thousand Years of Urban Growth: An Historical Census*. Lewiston, New York, St. David's University Press, 1987, f. 463-505.





Namazi

MARRËDHËNIA NDËRMJET ALLAHUT DHE NJERIUT

Doç. dr. Kerim Bulladë

Pas pranimit të ekzistencës së Allahut, njëshmërisë së Tij dhe se Muhamedi (a.s.), është i dërguari i Tij, parimi më i rëndësishëm i Islamit është namazi.

Namazi është adhurimi kryesor i të gjitha feve hyjnore dhe të gjithë profetët janë urdhëruar me faljen e namazit. Kjo e vërtetë, shprehet edhe në këto ajete fisnike: **“Ne i dhuruam atij Is’hakun dhe Jakubin si dhunti dhe të gjithë i bëmë të drejtë. Ne i bëmë ata udhëheqës që udhëzonin sipas urdhrit Tonë dhe i frymëzuam që të bënin vepra të mira, të kryenin faljet dhe të jepnin zekatin, dhe ata vetëm Ne na adhuruan.”** (Enbija, 72-73) I njëjti urdhër i është dhënë edhe Profetit tonë (a.s.) dhe umetit të tij.¹

Qëllimi i krijimit të njerëzimit, është njohja e Allahut dhe adhurimi i Tij. Ashtu siç e shpreh qartë edhe ajeti: **“Përse të mos e adhuroj Atë, i Cili më ka krijuar e tek i Cili do të ktheheni të gjithë?”**², kushti themelor i krijimit si njeri, është adhurimi i Allahut. Thelbi i adhurimit është namazi. Ai është një detyrë që përfshin të gjitha llojet e adhurimit. Kreu i devotshmërisë dhe vazhdimësia e saj, plotësohet me namazin.

Lidhur me rëndësinë e namazit, Profeti ynë (a.s.), shprehet: **“...Ta dini se, vepra juaj më e mirë, është namazi.”**³ Ky hadith, tregon qartë se namazi është

adhurimi dhe vepra e lejuar më e rëndësishme ndër të gjitha.

Namazi është një adhurim shumë i rëndësishëm. Siç tregohet edhe në hadithin: **“Ndërmjet njeriut, idhujtarisë dhe mohimit, qëndron braktisja e namazit.”**⁴, vepra që e largon besimtarin nga idhujtaria dhe mohimi, është namazi. Çështja për të cilën njeriut do t’i kërkohet llogari në radhë të parë, është namazi. Lidhur me këtë çështje, profeti ynë (a.s.), thotë: **“Në Ditën e Kiametit, çështja për të cilën njeriut do t’i kërkohet llogari në fillim, janë namazet farz. Nëse namazet farz janë në rregull, s’ka më mirë. Por nëse nuk janë plotësisht në rregull, thuhet: Shikoni a ka namaze vullnetare? Nëse ka namaze vullnetare, me këto plotësohen pjesët e mangëta prej farzve...”**⁵ Siç shihet, namazi është treguesi i devotshmërisë në këtë botë, ndërsa në botën tjetër është pyetja e parë e llogarisë. Nëse mund të shprehemi kështu, kalimi i provimit në botën tjetër, do të arrihet me besim dhe me namaz.

Profeti ynë (a.s.), ka thënë se: **“Namazi është shtylla e Islamit”**⁶. Ndërsa në një hadith tjetër, ka thënë se **“Namazi është shtylla e fesë.”**⁷ Në këto hadithe, feja

1. shih. Bekare, 2/43, 110; Nisa, 103; Ibrahim, 14/31; Isra, 17/78; Ta Ha, 20/132; Haxh, 22/78., etj.

2. Ja-Sin, 22.

3. Ibn Maxhe, Taharet, 4.

4. Muslim, Iman, 134; Tirmidhi, Iman, 9; Ibn Maxhe, Ikamet, 77; Ahmed b. Hanbel, III, 370.

5. Ebu Daud, Salat, 149; Nesai, Salat, 9; Ibn Maxhe, Ikametu’s-Salat, 202; Darimi, Salat, 91.

6. Tirmidhi, Iman, 8; Ahmed b. Hanbel, V, 237.

7. Ismail b. Muhammed el-Axhluni, Keshfu’l-Hafa ve Muzilu’l-Ilbas, Bejrut, ts. II, 31.

është ngjasuar me një ndërtesë, ndërsa namazi është shpjeguar si shtylla e kësaj ndërtese. Kjo, do të thotë se mbajtja në këmbë e ndërtesës së fesë, është e mundur vetëm me namazin. E shprehur ndryshe, mbizotërimi i parimeve fetare në jetën e individit dhe të shoqërisë, mund të arrihet vetëm në sajë të namazit.

Pas besimit, adhurimi mbi të cilin flet më shumë Kurani Fisnik dhe i jep vlerë, është namazi. Namazi i falur në mënyrë të drejtë dhe të rregullt, bëhet shkak i shtimit të besimit dhe i vazhdimit të jetës në parimet islame.

Për një besimtar, namazi është mbështetja kryesore e suksesit material dhe shpirtëror. **“Kërkoni ndihmë prej Allahut me durim dhe me namaz!”⁸ “O besimtarë! Kërkoni ndihmë për veten nëpërmjet durimit dhe namazit!..”⁹** Siç shihet edhe në këto ajete, burimi dhe shkak i suksesit në adhurimet dhe në aktivitetet që bëhen në çdo fazë të jetës, është namazi dhe durimi.

Namazi është kreu i pjekurisë në lidhje me këtë botë dhe me botën tjetër, është përforsuesi më i mirë i besimit dhe pika e mbështetjes së veprave. Adhurimi i namazit është një mundësi shumë e mirë për t’iu afuar Allahut dhe për të arritur dashurinë e Tij. Në sajë të namazit, besimtari ia shfaq dëshirat e tij Allahut me gjithë shpirt.

Nëse shikojmë prej dritares së Kuranit, vihet re se namazi është një adhurim i lartë, i cili të çon drejt shpëtimit, qetësisë, sigurisë dhe paqes. Namazi është një adhurim aq i lartë, saqë në sajë të tij plotësohet devotshmëria ndaj Allahut, arrihet kënaqësia e Tij dhe hyhet në rrethin e umetit të Muhamedit (a.s.). Me të merr vlerë besimi, me të merr kuptim njerëzimi dhe me të fitohet Xheneti. Lidhur me këtë, Profeti ynë (a.s.), ka thënë: **“Namazi është çelësi i Xhenetit!”¹⁰** Dyert e Xhenetit do të hapen me çelësin e namazit, me të do të shkelet në Xhenet dhe me të do të fillojë ecja e lumtur dhe e pafund në botën e përjetshme.

Kur Profeti (a.s.), u pyet se: **“Cila është vepra më e dashur tek Allahut i Madhëruar?”**, ai u përgjigj, duke thënë: **“Namazi i falur në kohën e vet!”¹¹** Në një transmetim tjetër, Profeti (a.s.), është pyetur: **“O i Dërguari i Allahut! Cila prej veprave është më afër Xhenetit?”**. Ndërsa Profeti (a.s.), u përgjigj: **“Falja e namazeve në kohën e tyre!”¹²**

Fakti që pesë kohët e namazit janë një marrëveshje midis Allahut dhe njeriut, shpjegohet në këtë hadith: **“Allahu i Madhëruar, i ka bërë të detyrueshme për robin pesë kohët e namazit. Kush e merr abdestin në mënyrën më të mirë, i fal namazet në kohën e tyre, kryen të plotë rukunë dhe sexhden, duke u falur me përkushtim, Allahu i ka premtuar faljen atij njeriu. Kush nuk i bën këto, Allahu nuk i premtton asgjë atij. Nëse dëshiron, Ai e fal**

ose e dënon.”¹³

Në një transmetim tjetër, Profeti ynë (a.s.), na ka bërë të ditur se Allahu i Madhëruar, ka thënë: **“(O Muhamed!) Umetit tënd ia bëra farz pesë kohët e namazit. Kushdo që i fal ato vazhdimisht në kohën e vet, jap fjalën se do ta vendos në Xhenet. Por kush nuk i fal vazhdimisht, nuk i jap asnjë fjalë.”¹⁴**

Në të dy hadithet, është theksuar se namazi është një marrëveshje ndërmjet Allahut dhe rob-it. Ndërsa pikat kryesore të kësaj marrëveshjeje janë përcaktuar nga Allahu. Për ata që i plotësojnë pa mangësi të gjitha kushtet e kësaj marrëveshjeje, është dhënë fjala për falje dhe Xhenet. Kjo situatë e veçantë që është përcaktuar vetëm për namazin, tregon qartë se namazi është një adhurim shumë i lartë.

“Duke përjashtuar gjynahet e mëdha, pesë namazet dhe falja e namazit të xhumasë, janë shpagim për gjynahet që bëhen ndërmjet tyre (këtyre namazeve).”¹⁵ Ashtu siç kuptohet qartë edhe prej këtij hadithi, kush është i vazhdueshëm në pesë kohët e namazit dhe fal namazin e xhumasë, do t’i falen të gjitha gjynahet e vogla që bëhen ndërmjet këtyre namazeve. Nëse nuk ka as gjynahe të vogla, as të mëdha, atij do t’i shkruhen të mira dhe do t’i ngrihen gradat. Por, nëse ka gjynahe të mëdha, shpresohet që ato t’i lehtësohen.¹⁶

“Kush e merr abdestin dhe e fal namazin në mënyrën e urdhëruar, atij do t’i falen gjynahet që ka bërë më parë.”¹⁷ **“Qëndroni në rrugë të drejtë. Ju nuk mund ta llogaritni dot shpërblimin e kësaj. Dijeni se, vepra më e mirë është namazi. Vetëm besimtari e merr abdestin në mënyrën e duhur.”¹⁸**

Është e pamundur të përmendim këtu të gjitha hadithet lidhur me mirësitë e namazit. Prandaj, mund të themi se, namazi, është indeksi i të gjitha adhurimeve, ai i jep kuptim të gjitha pjesëve të jetës me kohët e tij, me përmendjen e Allahut, lutjet dhe madhërimet që përmban. Gjithashtu, namazi është një adhurim që liston fillimin dhe fundin e jetës, duke e shfaqur dhe përfunduar atë. Pra, edhe fillimi, edhe fundi i jetës merr vlerë me namazin. Besimtari, me namaz duhet të hedhë hapat në jetën e tij për të cilën mban përgjegjësi dhe po ashtu, me namaz do t’ia dorëzojë të zotit edhe amanetin e kësaj jete. Allahu i Madhëruar, i Cili ka falur jetën, i do shumë robërit e Tij. Prandaj, Ai ua ka bërë farz robërve të Tij namazin, me qëllim që ata të shfaqin dashurinë, bindjen dhe devotshmërinë ndaj Atij çdo ditë, çdo orë dhe çdo çast. Kjo duhet të jetë edhe urtësia më e madhe e namazit.

13. Ebu Daud, Salat, 9; Ibn Maxhe, Ikametu’s-Salat, 194; Ahmed b. Hanbel, V, 317.

14. Ebu Daud, Salat, 9; Ibn Maxhe, Salat, 194.

15. Muslim, Taharet, 14, 15, shih edhe. Buhari, Keffarat, 6; Tirmidhi, Meuakit, 46; Ibn Maxhe, Taharet, 79.

16. shih. Ahmed Davutollu, Sahih-i Müslim Tercüme ve Serhi, istan. 1978, II, 818.

17. Nesai, Taharet, 108.

18. Muuatta; Taharet, 6; Ibn Maxhe, Taharet, 4.

8. Bekare, 45.

9. Bekare, 153.

10. shih. Ahmed b. Hanbel, III, 330.

11. Muslim, Iman, 137-140; Ahmed b. Hanbel, III, 128, 199, 285.

12. Muslim, Iman, 138.

AGJËRIMI SI KURË NDAJ KANCERIT

Është një sunet, të cilin Profeti (a.s.), nuk e ka braktisur edhe kur ka udhëtuar... Agjërimi në ditët 13, 14 dhe 15 të muajve hënorë... Në hadithe të ndryshme theksohet se agjërimi i Ramazanit dhe i tri ditëve për çdo muaj, eliminon urrejtjen, armiqësinë, vesvesin etj., që ndodhet në zemër. Gjithashtu në një hadith transmetohet se agjërimi i tri ditëve për çdo muaj, eliminon “magarran/ndytësinë e shejtanit”.¹

Të dhënat e marra nga kërkimet shkencore po i tregojnë botës urtësinë e këtij suneti të pashoq. Sipas këtyre kërkimeve, thuhet se agjërimi për tre ditë me radhë rinovon sistemin mbrojtës të trupit edhe tek personat e moshuar. Në kundërshtim me mendimet e “specialistëve të ushqyerjes”, në lidhje me rreziqet që përmban agjërimi, është vëzhguar se agjërimi shton aktivizimin e qelizave embrionale, duke u bërë shkak i rinovimit të qelizave të sistemit mbrojtës, që janë rruazat e bardha të gjakut. Në këtë mënyrë, është vërtetuar se personat që agjërojnë, kanë një sistem mbrojtës më të përgatitur ndaj infeksioneve. Në mënyrë të veçantë, thuhet se me anë të agjëritit mund të pastrohen prej trupit edhe qelizat e sistemit mbrojtës, të cila janë dëmtuar si rezultat i seancave të kimioterapisë tek të sëmurët me kancer.

E njëjta gjë vlen edhe për personat me imunitet të dobët trupor. Studiuesit kanë zbuluar se në mënyrë të veçantë ciklet e agjëritit kanë një cilësi rigjeneruese për sistemin mbrojtës. Trupi që agjëron, pakëson shpenzimin e panevojshëm të energjisë duke u përpjekur të eliminojë qelizat e sistemit mbrojtës. Në këtë mënyrë, qelizat e rruazave të bardha që shtohen dhe rigjenerohen me ndihmën e qelizave embrionale, luajnë një rol pozitiv në luftën e trupit kundër infeksioneve dhe kancerit. Gjithashtu, është vënë re se agjërimi për tre ditë rresht i pacientëve me kancer, i ka ruajtur ata nga ndikimet e helmimit me ilaçet e kimioterapisë. Në këtë mënyrë, ndërkohë që trupi ynë që agjëron pastrohet prej qelizave të rruazave të bardha që janë vjetërsuar ose dëmtuar, në sajë të sistemit mbrojtës që shtohet e rigjenerohet, ai përpigjet të rivendosë ekuilibrin e vet. Për këtë arsye,

kërkuesit theksojnë se “ciklet e agjëritit”, janë shumë efektive në formimin e një sistemi të ri mbrojtës. Përveç kësaj, nëse koha e agjëritit zgjatet më shumë, kjo e detyron trupin të shkrijë burimet e glukozit (sheqerit) dhe të yndyrës, ndërkohë që ul edhe sasinë e qelizave të rruazave të bardha të gjakut. Gjithashtu, është vënë re se pasi trupi fillon të ushqehet përsëri në iftar, rruazat e bardha rigjenerohen dhe shtohen përsëri. Në të njëjtën kohë, është zbuluar edhe se me zgjatjen e kohës së agjëritit, pakësohet edhe enzima PKA, e cila mendohet të jetë përgjegjëse për aktivizimin e formimit të kancerit dhe të ketë lidhje veçanërisht me fenomenin e plakjes. Kjo, tregon se agjërimi ka një ndikim pozitiv në mbrojtjen e trupit nga kanceri dhe të ruajtjes së rinisë...

Specialisti në fushën e sëmundjeve të plakjes, Valter Longo, i cili ka shpallur rezultatet e kërkimit shkencor në lidhje me “ndikimin e agjëritit në trupin e njeriut”, në Universitetin e Kalifornisë së Jugut, ka thënë: “Deri më sot, nuk ka asnjë provë që agjërimi ndikon për keq. Përkundrazi, ne kemi në dorë shumë fakte në lidhje me dobritë e tij...”

Tashmë, në botën e mjekësisë alternative, agjërimi ka filluar të bëhet i njohur në kurimin e shumë sëmundjeve të aparatit të tretjes, e veçanërisht të kancerit. Një nga profesorët dhe kërkuesit shkencorë në Universitetin e Bostonit, Thomas Seyfried, këshillon një lloj agjërimi, të cilin e quan “Dietë ketonike”. Kjo dietë e rekomanduar nga Seyfried për

1. shih. Ahmed bin Hanbel. Musned. el-Fethu'r-Rabbanî, V. 10.



kancerin, konsiston në kufizimin e konsumit të karbohidrateve, të proteinave dhe të kalorive. Kjo është një formë agjërimi që mund të praktikohet për një periudhë të shkurtër.

Dieta ketonike synon që i sëmuri të arrijë në ketozë, një gjendje metabolike ku trupi në vend të karbohidrateve djeg yndyrën si burim energjie. Duhet 3 ditë agjërimit vetëm me ujë për të arritur ketozën. Qëllimi është të agjërohet derisa tumori të zhduket. Kjo mund të ndodhë pas 4 ditëve agjërimit (në raste të rralla), por ka pasur persona që u është dashur të agjërojnë mbi 30 ditë për të shëruar tumorin. Sa më i madh tumori, aq më i gjatë duhet të jetë agjërimi. Por ka edhe tumore, të cilët për shkak të madhësisë nuk mund të zhduken vetëm me agjërimit.

Çdo ditë gjatë agjërimit, personi humbet mesatarisht 400-500 gr peshë dhe zakonisht agjërimit mund të vazhdojë normalisht pa problem, derisa personi të ketë rezerva dhjamore në trup. Trupi ushqehet me këto rezerva dhjamore gjatë agjërimit. Nëse agjërohet për më shumë se 3 ditë këshillohet prania e mjekut pranë agjëruesit. Këshillimi me mjekun është i domosdoshëm përpara agjërimit për njerëzit që vuajnë nga sëmundje kronike.



SATELITËT ARTIFICIALE: SYRI YNË NË HAPËSIRË

Në këtë shekull, në të cilin ndodhemi të ndërthurur me hapësirën, satelitët zënë një vend të rëndësishëm për njerëzimin. Me informacionet që merren prej satelitëve, mund të përdorim mjetet e informacionit si televizionin, radion dhe telefonin, për të parë në moment transmetimet direkte që bëhen në cepin tjetër të botës, mund të shkëmbejmë zërin, figurën dhe të dhënat ndërmjet kontinenteve, mund të gjejmë rrugën me anë të sistemit të navigacionit në aeroplanë, anije dhe makina, mund të evidentojmë fenomenet meteorologjike, mund të vëzhgojmë trupat qiellorë në hapësirë dhe mund të arrijmë çdo informacion që dëshirojmë në internet. Kjo teknologji ka përparuar aq shumë, sa që sot mund të ndiqet edhe aktiviteti i një personi që prej hapësirës.



“O njerëz! Pa dyshim, premtimi i Allahut (Dita e Gjykimit) është i vërtetë, prandaj të mos ju mashtroni kurrsesi jeta e kësaj bote!..” (Fatir, 5)

Njeriu ka dëshira dhe instinkte që e lidhin atë pas kësaj bote, të cilat janë të gdhendura në natyrën e tij. Këto i japin formë të gjithë jetës së tij. Për sa kohë që forca dhe shëndeti i tij janë mirë, ai vazhdon të rendë pas këtyre dëshirave dhe instinkteve. Dëshira e njeriut për të vazhduar jetën dhe specien e vet, përpjekjet për t’u mbrojtur prej dëmeve, urisë, etjes etj., janë vetëm disa prej këtyre instinkteve. Gjithashtu, dëshira për arritjen e pasurisë së kësaj bote dhe mirësive të saj, si fama, ndikimi dhe sundimi i të tjerëve, arritja e sukseseve dhe e epërsisë, fitimi i respektit dhe reputacionit, etj., janë disa prej instinkteve të tjera njerëzore.

Këto ndjenja dhe instinkte, shfaqen në mënyrë të ndryshme tek njerëzit. Për shembull, synimi më i madh i jetës së disa njerëzve është pasuria. Dikush tjetër dëshiron famën dhe reputacionin dhe të gjithë jetën e shpenzon për këtë qëllim. Dikush tjetër dëshiron post dhe pozitë të lartë, arritja e të cilave është ambicia e tij më e madhe. Ndërsa synimi i dikujt tjetër, është gruaja dhe fëmijët, përveç të cilave nuk ka ideale të tjera. Ndonjëherë tek një njeri gjenden disa prej këtyre dëshirave njëherësh. Por njeriu vetëm sa sprovohet në këtë botë me këto dëshira dhe ambicie.¹ Pra, a do t’i përdorë këto si mjete apo si qëllime për arritjen e pjekurisë së tij shpirtërore. Po ashtu, a do të mund t’i kontrollojë njeriu këto ndjenja dhe dëshira?² Apo mos ndoshta do të hyjë plotësisht nën kontrollin e këtyre dhe do të bëjë një jetë pa pyetur për hallalle dhe haramet?³ Nëse këto dëshira dhe instinkte bëhen qëllimet kryesore të njeriut, ato do të përbëjnë pengesën më të madhe të tij në aspektin e devotshmërisë ndaj Zotit të vet. Për rrjedhojë, kjo gjendje, në Kuran përkufizohet si idhujtarizim i dëshirave dhe epsheve të veta.⁴ Kjo, nënkupton rënien dhe uljen e njeriut. Por nëse njeriu i përdor këto si

mjete për të fituar kënaqësinë e Allahut, në këtë rast ai ngrihet dhe lartësohet.

Në Kuran, gjendja e popujve që u nënshtuan nga dëshirat dhe epsheet e veta, tregohen në këtë mënyrë duke iu drejtuar Profetit (a.s.): **“Lëri ata të hanë e të kënaqen dhe le t’i mashtroni shpresa; ata do ta marrin vesh!”** (Hixhr, 3; shih. Teube, 69.)

Në përgjithësi, njeriu nuk merr mësim prej popujve të shkuar. Në fakt, që prej njeriut të parë e deri më sot, në këtë tokë kanë jetuar me miliarda njerëz, të cilët janë lidhur pas kësaj bote me një lakmi dhe një tamah të pakufishme. Por më në fund të gjithë janë bluar në mullirin e kësaj bote, janë bërë dhe, e nuk i kanë shpëtuar dot zhdukjes. Tashmë, në vendet ku ata kanë jetuar fryjnë vetëm erërat, emrat e tyre janë harruar, ndërsa fama e tyre është varrosur në thellësitë e historisë. Prej tyre kanë mbetur vetëm muret e kalave që kanë përdorur për t’u mbrojtur dhe për të luftuar, ose shtyllat e pallateve ku janë jetuar në luks.

Kurani flet për popujt e shkuar, të cilët kanë ndër-tuar qytetërime. Kanë gdhendur shkëmbinjtë dhe kanë ndërtuar strehime të forta e të sigurta.⁵ Në këtë mënyrë, ata kanë menduar se e kanë siguruar jetën e tyre. Sa keq! Gjithçka ishte e kotë, sepse ata kishin ardhur prej dheut dhe më në fund u kthyen në dhe, duke mos i shpëtuar dot zhdukjes.

Prej popujve të shkuar, kishte prej atyre të cilët u zhytën në kënaqësi e argëtime të pafundme të kësaj bote. Ata mendonin se do të jetonin gjithmonë aty, pranë kopshteve, të mbjellave, vreshtave dhe pemëve frutore në buzë të lumenjve.⁶ Ja pra, a nuk është pikërisht ky mendim shkaku kryesor që e largon njeriun prej Zotit të vet?

Disa prej popujve të shkuar, nuk i kishin marrë seriozisht paralajmërimet dhe thirrjet e profetëve të tyre. Ata u thoshin profetëve se nuk mund të përzihe-

1. shih. Al-i Imran, 14; Teube, 24; Tegabun, 15.

2. shih. Naziat, 40.

3. shih. Merjem, 59.

4. shih. Xhathije, 23.

5. shih. Shuara, 26.

6. shih. Shuara, 146-148.

shin në jetët e tyre dhe se ata mund të adhuronin, të hanin dhe të pinin çfarë të donin. Madje ata i thoshin profetëve se nuk mund të ndërhyenin as në fitimet e tyre, duke ua treguar hallallin apo haramin.⁷ Po ashtu, u thoshin edhe se nuk mund të përziheshin as në jetën e tyre seksuale e të vendosnin kufij duke i ndaluar të vepronin si të donin.⁸

Kjo botë është si një sallë provimi. Për shekuj me radhë shumë njerëz kanë kaluar nga kjo sallë për të kryer provimin. Dikush fitoi, e dikush humbi. Tani është radha e turnit tonë. Bota na është lënë neve amanet, ndërsa ne i jemi lënë botës. Prej Allahut kemi ardhur dhe përsëri tek Ai do të kthehemi.

Jeta e njeriut në këtë botë kalon si një garë. Ndjehet dhe instinktet që janë vendosur në natyrën e njeriut e detyrojnë atë të marrë pjesë në këtë garë. Lidhur me këtë, Kurani përdor termat “tefahur” dhe “tekathur”, që do të thonë garë për “epërsi mbi njëritjetrin, e mburrje” dhe për “zotërim të sa më shumë pasurie dhe fëmijësh”.

Në këtë jetë, njerëzit përpiqen të arrijnë epërsi ndaj njëritjetrit dhe mburren ndaj njëritjetrit me mundësitë, pozitat dhe titujt që posedojnë. Në çfarë do niveli qofshin, çdo njeri i përjeton këto ndjenja në botën e tij të brendshme. Mirëpo, njeriu nuk duhet ta harrojë garën e vërtetë duke u fokusuar vetëm në garën e kësaj bote. Dhe gara kryesore, siç thekson edhe Allahu në Kuran, bëhet për të arritur faljen e Allahut dhe xhenetet e Tij të pafundme: **“Garoni me njëritjetrin, duke kërkuar falje prej Zotit tuaj dhe një kopsht të gjerë sa qielli dhe Toka, që është e përgatitur për ata që i kanë besuar Allahut dhe të dërguarve të Tij...”** (Hadid, 21) **“Për këto (mirësi), le të përpiqen**

7. shih. Hud, 87.

8. shih. Hud, 79.

ata që përpiqen!” (Mutafffin, 26)

Në këtë botë, njeriu kërkon nder dhe dinjitet. Që prej fëmijërisë, ai dëshiron të pëlqehet dhe të vlerësohet, të fitojë reputacion dhe respekt. Për këtë arsye, rritja në karrierë, zotërimi i titujve të ndryshëm, ngritja në poste të larta dhe shoqërimi me liderë dhe njerëz të famshëm, janë gjërat që ai i dëshiron më shumë. Ja pra, njeriu nuk duhet të harrojë kurrë një gjë ndërkohë që po lufton për të qenë me reputacion në këtë botë. Dhe ajo është fakti se nderi dhe dinjiteti arrihet vetëm me sexhden dhe bindjen ndaj Allahut.

Po, epërsia dhe virtyti i vërtetë, arrihet vetëm duke iu dorëzuar plotësisht urdhrave hyjnorë. Lidhur me këtë, ky ajet është shumë domethënës: **“Kush dëshiron lavdi e pushtet, ta dijë se e gjithë lavdia e pushteti i takojnë Allahut...”** (Fatir, 10)

Në jetën e kësaj bote, njeriu jeton gjithmonë me mendje drejt së ardhmes. Ai thur ëndrra dhe bën plane në lidhje me të ardhmen. Gjithmonë përpiqet të përgatisë diçka për të ardhmen dhe në këtë mënyrë mundohet të garantojë të ardhmen e tij, sepse një nga instinktet më themelore të njeriu është vazhdimësia e ekzistencës së vet. Mirëpo, njeriu nuk duhet ta harrojë as faktin se, përtej të nesërme, ka një “të nesërme” tjetër. Dhe kjo e nesërme, është dita kur do të jepet llogari para Allahut të Madhëruar. Atëherë, përgatitja për të nesërmen e kësaj bote, nuk duhet të bëhet pengesë në përgatitjen për të nesërmen pas vdekjes. Por përkundrazi, e nesërmja e kësaj bote duhet të vlerësohet si një kapital për të nesërmen e përjetshme. Kjo është edhe e vërteta që na tregon ky ajet fisnik: **“O besimtarë, frikësojuni Allahut dhe çdo njeri le të shikojë se ç’ka përgatitur për të nesërmen!”** (Hashr, 18)



Enes bin Malik (r.a.), transmeton se i Dërguari i Allahut (a.s.), ka thënë:

“Prej njerëzve ka të tillë, të cilët janë si çelësi i të mirës dhe shul i së keqes. Por ka edhe të tillë që janë çelësi i së keqes dhe shuli i së mirës. Lum si ata, në dorën të cilëve Allahu ka vendosur çelësin e së mirës! Dhe mjerë për ata në të dorën e të cilëve Allahu ka vendosur çelësin e së keqes!” (Ibni Maxhe, Sunnet, 19)

Para nesh ka dyer të panumërta... Ka prej tyre që presin të hapen me padurim, e ka të tjera që shpresojnë të mos hapen kurrë. Para nesh ka dyer të panumërta... Secila prej tyre hap dyer të reja... Para nesh ka dyer të panumërta... Jo! Çelësat e tyre nuk janë hedhur në puset pa fund, por janë në duart tona...

- Kemi çelësa në dorë?

- Po!

- Kush e tha këtë?

- Profeti!

- Cili Profet?

- Njeriu më i mirë i gjithë njerëzimit, Profeti i fundit!

- E çfarë thotë?

- Thotë se: “Prej njerëzve ka të tillë, të cilët janë si çelësi i së mirës dhe shuli i së keqes. Por ka edhe të tillë që janë çelësi i së keqes dhe shuli i së mirës. Lum si ata, në dorën të cilëve Allahu ka vendosur çelësin e së mirës! Dhe mjerë për ata në të dorën e të cilëve Allahu ka vendosur çelësin e së keqes!” (Ibni Maxhe, Sunnet, 19.)

I tregon me dorë një nga një... Kjo është derë mirësie, kjo tjetra është komplet mirësi, ndërsa tek kjo tjetra nuk ka aspak mirësi. Na lajmëron edhe për më të mirën, edhe për më të keqen. Na njofton edhe për atë, prej së keqes së të cilës duhet të ruhemi, edhe për atë, prej së keqes së të cilës duhet të strehohemi tek Allahu. Ndonjëherë na tregon për më të mirat, e ndonjëherë për veprat. Ai e lajmëron umetin e tij që e do aq shumë edhe për të keqen që duket si e mirë, edhe për të mirën që pandehet e keqe. Me një kujdes

dhe vëmendje të madhe, pa anashkaluar asnjë detaj, pa u mërziur dhe duke treguar po aq butësi sa tregon edhe një nënë ndaj fëmijës së saj, ai na mëson edhe dyert që duhet të hapen, edhe ato që duhet të kyçen. Ai na tregon njerëzit më të mirë, të cilët marrin në dorë çelësat dhe hapin dyert e mirësive pa ngurruar aspak dhe pa pasur frikë se çfarë do të ndodhë e çdo të thonë, por vetëm duke kërkuar kënaqësinë e Allahut.

Ai i përmend si “njerëzit më të mirë”, ata që sillen më mirë me bashkëshortet e tyre¹, që japin borxh pa fyer askënd², që mësojnë Kuran dhe ua mësojnë edhe të tjerëve³, që kanë jetë të gjatë dhe vepra të mira⁴, ata që kanë moral të mirë⁵ dhe ata prej të cilëve shpresohet e mira dhe jo e keqja⁶.

Gjithashtu, ai na mëson se turpi është vetëm mirësi⁷, se njerëzit e butë posedojnë mirësi të madhe⁸, se është më mirë të heshtësh se sa të flasësh padobi⁹ dhe se prej Allahut duhet kërkuar më e mira në çdo gjë, përfshi edhe në vdekje¹⁰. Ai thotë se miku më i mirë, është ai më i dobishmi për mikun e vet dhe se fqinji më i mirë, është ai që sillet më mirë me fqinjin e vet.¹¹ Ai na njofton se cilësinë e të qenit “të mirë”,

1. shih. Ibn Maxhe, Nikah, 50.

2. shih. Ibn Maxhe, Tixhare, 62.

3. shih. Ibn Maxhe, Sunne, 16.

4. shih. Tirmidhi, Zuhd, 22.

5. shih. Buhari, Edeb, 39.

6. shih. Tirmidhi, Fiten, 76.

7. shih. Muslim, Iman, 61.

8. shih. Tirmidhi, Birr, 67.

9. shih. Muslim, Iman, 74.

10. shih. Buhari, Merda, 19.

11. shih. Tirmidhi, Birr, 28.



e fitojnë ato gra që i japin qetësi burrit të vet', ata që i fitojnë të ardhurat me djersë" dhe tregtari që e shlyen borxhin në mënyrën më të mirë¹².

Në fakt, ai, çdo njeri e orienton drejt derës së mirësisë që është më e afërt me të, duke e afruar tek ajo derë. Dhe duke ia kujtuar çelësin e mirësisë që mban në dorë, e nxit atë që ta hapë sa më parë atë derë.

- A tha Profeti se në duart tona ka çelësa?

- Po!

- Atëherë përse këto dyer janë kaq larg?

- Dyert janë pas teje, por ti je ai që largohesh prej tyre!

Dyert e panumërta të mirësisë janë para nesh, ndërsa çelësat e tyre janë në dorën tonë. Atëherë, nga vjen gjithë kjo e keqe? Nëse e shtyjme hapjen e dyerve të mirësive, nëse prej disave kemi frikë, nëse disa të tjera i nënvleftësojmë dhe nëse nuk e kuptojmë se ajo që hapim nuk është veç një derë, por një rrugë e madhe, atëherë dyert e mirësive do të jenë të dënuara të zënë merimanga. Ndërsa çdo derë e së keqes, të cilës nuk mendojmë t'i vëmë kyçin, ose kujtojmë se dikush tjetër do ta mbyllë patjetër, do të vazhdojë të njiillosete botën tonë me shpejtësi dhe pa u ndjerë fare. Pra, e gjithë e keqja, për të cilën themi nga doli kjo ndërkohë që ne jetojmë të lumtur, vjen nga e keqja që ne nuk e kemi penguar, ose e mira që e kemi neglizhuar.

Mirë, por përse të mirët janë kaq neglizhentë

ndërkohë që të këqijtë përpiqen pa pushim? Përse të mirët janë kaq të dobët, ndërkohë që të këqijtë janë kaq rezistentë? Përse mirësia është si një lule e rrallë dhe delikate në këtë kopsht, ndërkohë që e keqja është si një ferrë e keqe dhe helmuese?

E keqja lind të keqen, sepse ajo është e prirë të shtohet. Ndërkohë që çdo e keqe i jep kurajë të keqes tjetër dhe kanë kaq shumë dëshirë të mbështesin njëra-tjetrën, e mira qëndron kokulur. Pra, sot po jetojmë në kohën kur e mira rri kokulur dhe zemërthyer, sepse veprimi i saj është shumë i vështirë.

Njerëzimi po dëshmon kohë të vështira, kur nuk ndahet vetë e mira, por pamja e saj. Njerëzit ndjejnë një kënaqësi të jashtëzakonshme prej shfaqjes së çdolloj të mirë që bëjnë. Mirëpo, mirësia është diçka që duhet vetëm të veprohet, e jo të shfaqet. Madje, besohet se sa më shumë të flitet për mirësinë e bërë, aq më shumë i humbet vlera dhe sinjeriteti.

Qëllimi i mirë, mbulon çdo mirësi si një tyl i tejdukshëm dhe mbi çdo të mirë që nuk bëhet me qëllim të sinqertë, mbetet një njollë e zezë. Ngjyra e së mirës është e bardhë dhe për nga natyra e saj nuk mund të durojë asnjë lloj njolle. Nëse njolloset, ajo nuk ndryshon aspak prej së keqes. Më pas, e mira, e keqja dhe çdo gjë përzihet. Në vend të çdo mirësie ngrihet një e keqe. Prandaj, në kohë të tilla, njeriu duhet të pyesë veten, se a e ndjen veten mirë apo jo, sepse pa qenë mirë, pa e ndjerë veten mirë, nuk mund të bësh mirësi. Pa u bërë mirë, nuk mund të jesh çelës i së mirës dhe kyç i së keqes. Para nesh ka dyer të panumërta... Prej cilës derë të hymë në Xhenet?

12. shih. Nesai, Nikah, 14.

13. shih. Ahmed b. Hanbel, II/334.

14. shih. Ahmet b. Hanbel, II/19.

URTËSI NGA MIQTË E ALLAHUT

HALID-I BAGDADI

(rahmetullahi alejh)

I nderuari **Halid-i Bagdadi**, thotë:

“O Zoti im! Unë kurrë nuk mund të të falënderoj ashtu siç e meriton! Në fakt, një pretendim i tillë është budallallëk për dikë që ia ndjen erën vdekjes.

Vallahi, edhe sikur të më jepej jetë e përjetshme dhe të mos kisha asnjë punë tjetër përveç falënderimit ndaj Allahut, edhe sikur çdo qimeje në trupin tim t'i jepeshin dymijë gojë që mund të flasin mijëra gjuhë, edhe sikur të më largoheshin egoja dhe shejtani, që më japin vesvese dhe më pengojnë nga falënderimi, edhe sikur unë të falënderoj Allahun gjithë jetën pa u ndalur me gjithë qenien time, unë nuk do ta kisha plotësuar falënderimin e qoftë edhe një prej mirësi-ve të Allahut! E si mund të falënderoj për të gjitha mirësitë një nga një apo të gjitha së bashku!.. Në fakt, edhe falënderimi është një mirësi më vete!”¹

[Në këtë botë jemi të rrethuar me mirësi të panumërta që i shohim dhe nuk i shohim. Atëherë, sa falënderues

dhe mirënjohës duhet të jemi ndaj Allahu të Madhëruar, i Cili na i ka falur të gjitha këto?

Ne jemi të dobët në falënderimin ndaj Allahut, ashtu siç e meriton Ai. Megjithatë, për ta falënderuar atë sipas mundësisë që kemi, duhet të meditojmë shpesh mbi mirësitë hyjnore që na janë falur dhe duhet ta njohim mirë vlerën e tyre.

Të largohesh nga meditimi i mirësive të Allahut të Madhëruar, sjell me vete indiferentizmin dhe pakujdesinë. Me përparimin e indiferentizmit, dobësohen edhe ndjenjat e falënderimit ndaj Allahut, i Cili na i ka falur mirësitë. Madje, pas njëfarë kohe, kjo e shpie njeriun në mohimin e mirësive,

pra në mosmirënjohje. Dhe kjo pason me humbjen e mirësive dhe dënimin e Allahut.

Në një ajet fisnik urdhërohet:

“...Nëse tregoheni mirënjohës, Unë do t’jua shtoj edhe më shumë begatitë e Mia; por, nëse ju mohoni mirësitë e Mia, (atëherë dijeni se) dënimi Im është i rëndë”
(Ibrahim, 7)



1. Kavak, Divan, beyt: 1140-1146.



Nisur nga kjo, është e domosdoshme për lumturinë tonë të njohim mirësitë që na janë falur dhe të falënderojmë për to. Dhe hapi i parë për këtë, është thellimi në meditimin rreth atyre mirësive.

Për shembull, të mendojmë për mirësinë e “syririt”:

Nëse do të kishim lindur të verbër dhe vite më vonë do të na jepej mundësia për të shikuar, kushedi se çfarë gëzimi do të ndjenim në atë moment?! Kushedi se sa do të mahnitëshim përballë madhështisë dhe bukurisë së mirësisë së shikimit?! Ne do të ishim mrekulluar me Zotin tonë, i Cili na e ka falur këtë mirësi.

Me të vërtetë që kushedi se sa do të lumturoheshim, nëse do t’i shihnim për herë të parë ngjyrat dhe tonet e panumërta të dritës, tablotë e mrekullueshme që krijon dielli gjatë perëndimit të tij, yjet, dritën e hënës, natën, ditën, oqeanet, kafshët dhe çdo vepër arti që Allahu i Madhëruar ka shfaqur në gjithësi!.. Ne do të ishim dehur vetëm prej kënaqësisë dhe gëzimit të papërshkrueshëm të mirësisë së shikimit. Krijesat që do të shihnim në atë moment, nuk do t’i shihnim rëndomtë si tani, por njësoj sikur shohim një oqean të thellë, duke ndjerë mahnitjen dhe urtësinë e tyre.

Ja pra, robërit e urtë që arrijnë ta eliminojnë indiferencën prej zemrave të tyre, e shikojnë botën gjithmonë me një shikim të tillë “të lartë”. Tek ata nuk gjendet indiferenca e shikimit të shfaqjeve madhështore të fuqisë hyjnore si fenomene të rëndomta natyrore, ashtu siç bëjnë shumica e njerëz-

ve. Në fakt, një njeri i thjeshtë i shikon me admirim tablotë e një piktori që imiton natyrën. Por në të shumtën e rasteve, ai nuk e ka të njëjtën ndjenjë admirimi edhe për gjithësinë dhe Krijuesin e saj. Ai i percepton si “gjëra të zakonshme” shfaqjet e fuqisë hyjnore në gjithësi.

Ndërsa robërit e urtë, në vend të tablove që ka bërë një piktor, mbeten të mahnitur e të mrekulluar përballë Artistit të vërtetë, Allahut të Madhëruar dhe veprave të Tij madhështore. Ata arrijnë kënaqësinë e shijimit të mrekullive të pafundme të artit hyjnor që krijon në gjithësi fuqia e Allahut të Madhëruar.

Për shembull: Ata shohin gjethet dhe lulet shumëngjyrëshe të bimëve që dalin nga e njëjta tokë, natyrën e tyre, frutat e ndryshme në ngjyrë, aromë, shije e formë dhe dizajnin e mrekullueshëm në krahët e fluturave, që nuk kanë më tepër se dy javë jetë. Po ashtu, ata u vënë veshin edhe ligjërimeve të mistershme të krijesave, të cilat janë të pamundura të shihen nga syri e të kuptohen nga mendja. Për njerëz të tillë, i gjithë universi është si një libër i gatshëm për t’u lexuar.

Nëse këto fakte që përmendëm në lidhje me mirësitë e syrit, i përdorim në mënyrë të ngjashme si shabllon edhe për të gjitha mirësitë e tjera si, dëgjimi, ecja, mendja etj., duhet të na mbushet zemra me ndjenjat e mirënjohjes, aq sa të mendojmë se kemi ardhur në këtë botë vetëm për të plotësuar falënderimin e këtyre mirësive.

Nëse një njeriu me mendje të shëndoshë i thonë: “Më jep sytë, merr Stambollin!”, a t’i jep? Po edhe

Nëse një njeriu me mendje të shëndoshë i thonë: “Më jep sytë, merr Stambollin!”, a t’i jep? Po edhe sikur t’i thonë: “Më jep shëndetin, merr botën!”, kush i ndërron? Një njeri me mendje të shëndoshë nuk e pranon kurrë diçka të tillë, sepse ai e di mirë se për të, kjo nuk do të jetë gjë tjetër veçse një dënim i mbushur me vuajtje dhe tortura.

sikur t'i thonë: "Më jep shëndetin, merr botën!", kush i ndërron? Një njeri me mendje të shëndoshë nuk e pranon kurrë diçka të tillë, sepse ai e di mirë se për të, kjo nuk do të jetë gjë tjetër veçse një dënim i mbushur me vuajtje dhe tortura.

Për këtë arsye, Sulltan Sulejman Kanuni ka thënë:

Për popullin s'ka asgjë më të çmuar se shteti,

Por në këtë botë s'ka shtet (forcë) më të çmuar se një frymë shëndeti...

Dhe me të vërtetë që edhe një frymëmarrje e vetme kur je i shëndetshëm, është më e çmuar se një shtet madhështor, pra një mirësi apo lumturi e madhe. Nëse njeriu, të cilit i ka mbaruar afati i jetës do të jepte gjithë pasurinë e tij edhe për një frymëmarrje të vetme, ai nuk do të kish-te mundësi ta merrte këtë mirësi.

Mirëpo, që zemrat të arrijnë të shohin këto tablo urtësie, është e domosdoshme që ato të fitojnë nivel më të lartë shpirtëror. Sulltani Javuz Selimi, i cili edhe pse ishte sundimtar i madh, e kishte kuptuar se lumturia e vërtetë është e mundur vetëm në sajë të një zemre me nivel të lartë shpirtëror, ka thënë:

Luftë e kotë paska qenë të jesh padishah i botës,

Më mirë paska qenë të lidhesh pas një veliu.

Në këtë mënyrë, ai e ka konsideruar më të mirë lidhjen pas një njeriu të urtë, i cili do ta udhëzojë, duke i hapur sytë që të shohë shfaqjet e madhështisë dhe fuqisë hyjnore, se sa i gjithë sundimi i tij madhështor plotë fitore.

I nderuari Mehmed Emin Efendiu, në një letër që ka shkruar për një nxënës të tij, shprehet:

"...Në çdo frymëmarrje ka dy mirësi (e para është ta marrësh, e dyta është ta nxjerrësh frymën). Prandaj, për çdo frymëmarrje duhen dy falënderime. Çdo orë ka njëmijë frymëmarrje dhe e shumëzuar për dy falënderime, ne duhet të falënderojmë dyzet e tetë mijë

herë në njëzet e katër orë.

Nëse një njeri i lë të gjitha punët dhe e falënderon Allahun e Madhëruar vazhdimisht duke thënë "el-hamdulilah, elhamdulilah..." ai përsëri nuk arrin të falënderojë ashtu siç duhet. Madje, ai nuk mund të plotësojë as një të njëmijtën e falënderimit ndaj Allahut."

Këta janë disa shembuj në lidhje me borxhin tonë të falënderimit ndaj mirësive materiale që kemi. Mirëpo, në krye të mirësive më të mëdha për të cilat jemi të dobët të falënderojmë, është krijimi ynë nga asgjëja, pa paguar asnjë lloj çmimi.

Krijimi ynë si njeri, si krijesa më e nderuar ndër të gjitha krijesat e tjera, e jo si ndonjë kafshë, shpend, gjethe apo pemë. Dhe midis të gjithë

njerëzve na është dhënë besimi, e midis të gjithë besimtarëve, kemi pasur nderin të jemi umeti i prijësit dhe vulës së profetëve, Muhamedit (a.s.), duke u bërë edhe populli i Kuranit Fisnik, i cili do të vazhdojë të jetë një mrekulli hyjnore deri në Ditën e Kiametit.

Edhe nëse biem në sexhden e falënderimit ndaj Zotit tonë vetëm për këto mirësi dhe nuk e ngremë kokën gjatë gjithë jetës, kjo përsëri është pak, është e mangët dhe e papërfillshme...

Besimi, Kurani dhe Profeti ynë i dashur (a.s.), janë pasuria jonë më e madhe shpirtërore. Edhe sikur të zotërohen të gjitha mundësitë dhe mirësitë e përkohshme dhe të jetohej një mijë vite në këtë botë, por të ishim të privuar nga besimi dhe Kurani, duke mos e njohur as të Dërguarin e Allahut (a.s.), kjo nuk do të kishte asnjë lloj vlere. Në fakt edhe jeta jonë në këtë botë, edhe kjo botë, janë të dënuara me përkohshmëri... Mirëpo, paqja dhe lumturia që do të sjellë njohja e të Dërguarit të Allahut (a.s.) dhe ndjekja e tij me gjithë shpirt, janë të pafundme...

Ne gëzohemi shumë kur arrijmë një mirësi të kësaj bote. Por sa mirënjohës jemi dhe sa falënde-

*Besimi, Kurani
dhe Profeti ynë i dashur
(a.s.), janë pasuria jonë më e
madhe shpirtërore. Edhe sikur
të zotërohen të gjitha mundësitë
dhe mirësitë e përkohshme dhe të
jetohej një mijë vite në këtë botë,
por të ishim të privuar nga besimi
dhe Kurani, duke mos e njohur
as të Dërguarin e Allahut
(a.s.), kjo nuk do të kishte
asnjë lloj vlere.*

rojmë për mirësinë e besimit që do të na çojë në lumturinë e përzetshme dhe mirësinë e të qenit Umeti i Muhamedit (a.s.)?

Ja pra, të meditosh ashtu siç duhet mbi këto mirësi, të bën të kuptosh mirë se sa mosmirënjohje e thellë është kur robi ankohet, qahet e rebelohet për disa vështirësi të përkohshme.

Le të mendojmë pak; nëse dikush që zotëron trilionë, humb një pjesë të vogël të parave kur është duke ecur në rrugë, a do të hidhërohet ai për këtë? E çfarë rëndësie kanë ato pak para për dikë që zotëron trilionë? Po kështu edhe ne; kur na bie ndonjë fatkeqësi e kësaj bote, do të durojmë duke menduar se sa fatlumë jemi, që jemi robër të Allahut dhe Umeti i Profetit tonë të dashur (a.s.). Ne duhet ta harrojmë hidhërimin me tepri, shkatërrimin e vetvetes, ankimet dhe qarjen për një fatkeqësi apo humbje të përkohshme të kësaj bote. Nuk duhet të themi: “Pse ndodhi kjo. Obobo!” Përballë vështirësive dhe vuajtjeve në sprovat e kësaj bote, ne duhet të ngushëllohem, duke gjetur paqen e lumturinë në faktin se jemi pjesëtarë të Islamit, të vetmes fe të vërtetë dhe Umeti i Profetit që është dërguar si mëshirë për botët. Ne duhet ta dimë se sado që të falënderojmë ndaj mirësive të pafundme të Allahut të Madhëruar, ne kurrë nuk do të mund ta lajmë borxhin tonë të falënderimit.

Sipas një transmetimi, Musai (a.s.), i tha Allahut të Madhëruar:

“O Zot! Falënderimi im ndaj Teje, është një mirësi më vete që më është dhënë prej Teje, gjë e cila kërkon një falënderim më vete. (Atëherë si mund të të falënderoj ashtu siç e meritoj?)”

Allahu i Madhëruar, i çoi shpallje Musait (a.s.), duke i thënë:

“Kur ti e di se çdo mirësi që ke është prej Meje, edhe Unë do e pranoj si falënderim këtë dije.” (Ihja, IV, 163.)

Borxhi ynë i falënderimit, është i pafundmë, sepse, nëse Allahu i jep robit të Tij edhe mirësinë e falënderimit, kjo do të kërkonte një falënderim

më vete. Kjo do të vazhdonte kështu pafundësisht dhe njeriu kurrë nuk do të arrinte ta plotësonte falënderimin e tij. Për këtë arsye, edhe profetët të cilët nuk kanë pasur gjynahe përveç disa gabimeve, kanë kërkuar falje dhe mëshirë prej Allahut për shkak të dobësisë së tyre për të falënderuar ashtu siç duhet.

Po kështu, edhe Profeti ynë (a.s.), i është përgjyruar Allahut të madhëruar, duke thënë:

“O Allah! Strehohem tek kënaqësia Jote prej zemërimit Tënd, tek falja Jote prej dënimit Tënd dhe prej Teje po tek Ty! Unë jam i dobët në falënderimin ndaj Teje ashtu siç e meritoj! Ti je ashtu siç e ke lavdëruar dhe madhëruar Vetën Tënd!”²

Me këto fjalë, Profeti ynë (a.s.), është shprehur se jemi të dobët të falënderojmë siç duhet Allahun e Madhëruar dhe në këtë çështje duhet të strehohemi në faljen dhe mëshirën e Tij.

Një herë tjetër, Rasulullahu (a.s.), e kapi përdore Muadh bin Xhebelin (r.a.) dhe i tha:

“O Muadh! Betohe në Allahun se unë të dua shumë. O Muadh! Po të këshilloj që të mos e lësh kurrë pa e bërë këtë dua në fund të namazit:

اللَّهُمَّ اَعِنِّي عَلَى ذِكْرِكَ وَشُكْرِكَ وَحُسْنِ عِبَادَتِكَ

«O Allah! Më ndihmo të të përkujtoj, të të falënderoj dhe të të adhuroj në mënyrën më të bukur!» (Ebu Daud, Vitri, 26.)

Nga kjo kuptojmë se edhe për të falënderuar duhet të kërkojmë ndihmën e Allahut.

Nga ana tjetër, falënderimi dhe mirënjohja nuk bëhen vetëm me gjuhë. Një falënderim dhe mirënjohje e vërtetë, përbëhet nga tre elementë të lidhur me njëri-tjetrin. Këta janë, dija, gjendja dhe vepra.

- Dija: Të dish se çdo mirësi është prej Allahut.

- Gjendja: Të ndjesh madhërim, respekt dhe dashuri ndaj pronarit të vërtetë të mirësive.

2. Muslim, Salat, 222.

- Vepra: T'i jetosh këto ndjenja në mënyrën e duhur, të kryesh falënderimin me gjuhë dhe me vepra dhe t'i përdorësh mirësitë në përputhje me kënaqësinë e Allahut.

I nderuari Xhunejd-i Bagdadi, lidhur me falënderimin me vepra shprehet:

“Falënderim është të mos i rebelohesh Allahut të Madhëruar me mirësinë që të ka dhuruar dhe të mos e bësh atë mirësi shkak për gjynah.”

Pra, ne duhet ta shfaqim falënderimin dhe mirënjohjen tonë me vepra, duke treguar bindje ndaj Allahut me adhurime, sjellje dhe moral të mirë, përpjekje në rrugë të Allahut, sakrificë, devotshmëri dhe ruajtje prej gjynaheve.

Jeta e Profetit tonë (a.s.), është e mbushur plot me shembuj të tillë. Një nga këta shembuj na e tregon nëna jonë Aisheja (r.a.):

“Një natë, Rasulallahu (a.s.), më tha:

«O Aishe! Nëse më lejon, dëshiroj ta kaloj natën në adhurimin e Zotit tim.»

«Vallahi, unë dua shumë të jem bashkë me ty. Mirëpo, e dua më shumë atë që të gëzon ty.» – i thashë unë.

Më pas, u ngrit, mori abdest për bukuri dhe qëndroi në namaz, ku filloi të qante. Ai qau aq shumë, sa iu lagën rrobat, mjekra e tij e bekuar dhe vendi ku bënte sexhde. Ndërkohë që ishte në atë gjendje, vjen Bilali për ta thirrur në namazin e sabahut. Kur e pa që Profeti ynë po qante, e pyeti:

«O Rasulallah! Përse qani, ndërkohë që Allahu jua ka falur gabimet e shkuara dhe të ardhme?» Pas kësaj, Rasulallahu (a.s.), tha:

«A të mos bëhem një rob që e falënderon shumë Allahun?» (Ibn Hibban, II, 386.)

Falënderim është të njohësh pronarin e vërtetë të mirësive dhe të bësh një jetë në bindje të plotë, me fjalë dhe me vepra, ndaj Zotit tënd që t'i ka falur ato mirësi. Nisur nga kjo, ashtu siç duhet ta dish se të gjitha mirësitë janë prej Allahut dhe të falënderosh me gjuhë, ashtu edhe t'u japësh atyre që nuk i kanë ato mirësi, është një nga shprehjet më të bukura të falënderimit me vepra.

Mbi të gjitha, dëshirat dhe lakmitë e një egoje të paedukuar, nuk kanë fund. Profeti ynë (a.s.), e përshkruan kështu gjendjen e njerëzve që nuk dinë të falënderojnë dhe janë të privuar nga të qenit të kënaqur me ato që kanë:

“Nëse biri i njeriut do të zotëronte një luginë plot me flori, ai do të kërkonte edhe një luginë tjetër. Syriri

e tij nuk e ngop asgjë tjetër përveç dheut...” (Buhari, Rikak, 10; Muslim, Zekat, 116-119.)

Burimi i qetësisë shpirtërore në këtë botë, është kënaqësia me atë që posedon dhe falënderimi për mirësitë. Për këtë arsye, njerëzit e urtë e të ditur, në vend që të vuajnë për shkak të mallit për mirësitë ndaj të cilave janë privuar në këtë botë, ata jetojnë me qetësi shpirtërore duke e ditur vlerën e mirësive që zotërojnë. Ndërsa njerëzit indiferentë, jo vetëm që nuk ua dinë vlerën mirësive që zotërojnë, por jetojnë në tension e të shqetësuar për shkak të lakmisë që kanë ndaj mirësive të cilat nuk u janë dhënë. Pa e ditur se a është më mirë pakica apo shumica e mirësive që u janë dhënë, ata vazhdimisht kërkojnë dhe dëshirojnë më tepër.

Lidhur me këtë çështje, ky paralajmërim që Profeti ynë (a.s.), i ka bërë Salebes, është një mësim i mirë për të gjithë ne:

“Pak pasuri për të cilën mund të falënderosh, është më e mirë se sa shumë pasuri për të cilën nuk mund të falënderosh...” (Taberi, Xhmiu'l-Bejan, XIV, 370-372.)

Nga ana tjetër, kur njeriu largohet prej medimitit shpirtëror, që është edhe çelësi i besimit, ai fillon t'i shohë mirësitë që i janë falur, si një e drejtë e tij e natyrshme dhe jo si një dhuratë hyjnore. Dhe kjo e bën njeriun të verbër në lidhje me shikimin e mirësive të panumërta që ai zotëron.

Allahu i Madhëruar, në Kuranin Fisnik, urdhëron:

“Pastaj, atë Ditë, patjetër që do të pyeteni për mirësitë (e kësaj bote)!” (Tekathur, 8)

Në këtë mënyrë theksohet qartë përgjegjësia jonë për të gjitha mirësitë që zotërojmë. Ja pra, kur u zbrit ky ajet fisnik, një sahab që nuk kishte as një çadër për të futur kokën, u çua në këmbë dhe pyeti:

“A kam unë ndonjë gjë prej mirësive për të cilat do të japim llogari?”

Resulullahu (a.s.), tha:

“Hija e pemës, dy nallanet (që ke veshur) dhe uji i ftohtë (që pi).” (shih. Sujuti, VIII, 619.)

Në këtë mënyrë edhe njeriu që mendonte se nuk kishte asgjë, doli se kishte shumë mirësi për të cilat do të japë llogari në Ditën e Kiametit.

Nëse do të mendojmë nga kjo pikëpamje, do të kuptojmë shumë lehtë se çdo qenie prej të cilës kemi dobi drejtpërdrejt apo indirekt, është krijuar për të mirën tonë nga Allahu i Madhëruar.

Për shembull: Bimët, prej të cilave përfitojmë prej hijes, frutave, aromave që kënaqin shpirtin dhe pamjeve që ledhatojnë sytë; kafshët prej të cilave përfitojmë prej mishit, qumështit, lëkurës etj., uji i ëmbël që pimë dhe shumë mirësi të veçanta që na janë falur neve dhe jo krijesave të tjera, janë krijuar enkas për ne nga Zoti ynë. Bota, atmosfera e saj, toka, uji etj., që janë krijuar me llogari të imëta që të bëjnë të mundur jetën tonë, na janë kushtuar të gjitha neve.

Shkurtimisht, ne s'mund t'i numërojmë të gjitha mirësitë që na ka falur Allahu i Madhëruar. Lidhur me këtë, në Kuranin fisnik, urdhërohet:

“Ai ka vënë në shërbimin tuaj çka gjendet në qiej dhe në Tokë. Të gjitha janë prej Tij. Me të vërtetë, në këto ka shenja për njerëzit që mendojnë.” (Xhatije, 13)

“Ai ju jep gjithçka që i kërkoni. Edhe nëse përpiqeni t'i numëroni dhuntitë e Allahut, nuk do të mund t'i numëroni dot. Njeriu është vërtet i padrejtë dhe mosmirënjohës.” (Ibrahim, 34)

Domethënë se edhe një njeri i varfër e nevojtar, që mendon se nuk ka asgjë në këtë botë, nëse do të meditohte ashtu siç duhet, do të kuptonte se është i mbytur në mirësi të shumta për të cilat duhet të falënderojë. Si rezultat i kësaj, ai do të qetësohet dhe do të falënderojë shumë.

Përndryshe, megjithëse është i mbytur në mirësi të panumërta, nëse njeriu nuk mediton siç duhet mbi këto mirësi, do të jetojë me stres dhe vështirësi shpirtërore, sikur nuk zotëron asgjë. Kjo gjendje është një nga problemet më të rëndësishme të kohës sonë.

Kjo, sepse sistemi kapitalist, liberal dhe materialist, u imponon vazhdimisht njerëzve në nënvetëdijen e tyre, “të kërkojnë dhe të konsumojnë më shumë”. Si rezultat i nxitjes së vazhdueshme të lakmisë së egos me anë të reklamave dhe modës, njerëzit nuk e shohin të mjaftueshme asnjë mirësi, duke mos shpëtuar dot prej problemeve shpirtërore që sjell kjo pakënaqësi. Sot një pjesë e botës ndodhet në majë të mirëqenies materiale,

por në të njëjtën kohë, ndodhet edhe nën kthetrat e problemeve shpirtërore...

Ndërsa Profeti ynë (a.s.), për të arritur qetësinë shpirtërore, na ka dhënë këto këshilla të çmuara që janë receta për ne:

“Shikoni ata që janë më poshtë se ju në kushtet e jetesës, e mos shikoni ata që janë më lart se ju! Kjo është një sjellje më e mirë, me qëllim që të kënaqeni me mirësitë që ju ka dhënë Allahu.” (Muslim, Zuhd, 9.)

“...Kush shikon atë që është më lart se vetja në çështjet e fesë dhe e ndjek atë, ndërsa në çështjet e kësaj bote sheh atë që është më poshtë se vetja dhe falënderon për mirësitë që i ka dhënë Allahu, Allahu do ta shkruajë atë njeri si falënderues dhe durimtar...” (Tirmidhi, Kijamet, 58/2512.)

Ja pra, për shkak të begatisë së këtyre këshillave dhe porosive, në kohën e Profetit (a.s.), nuk është vërejtur asnjë rast i problemeve shpirtërore, pavarësisht pamundësisë të shumta që ekzistonin atëherë. Shoqëria e kohës së Profetit (a.s.), kishin arritur qetësinë shpirtërore që u jepte vetëmjaftueshmëria, devotshmëria dhe kuptimi i së vërtetës se jeta reale, është ajo e botës tjetër. Në këtë mënyrë, ata i kanë kapërcyer problemet personale dhe me një shpirt altruist iu përveshën me entuziazëm të

lartë misionit të bartjes në të gjithë botën të mesazhit të lumturisë së përrjetshme.

Shkurtimisht, ne e ndjejmë për borxh të falënderojmë edhe dikë që na jep qoftë edhe një gotë ujë. Pra, nëse thellohemi në mirësitë e panumërta që zotërojmë -të cilat i dimë dhe nuk i dimë-, duhet ta falënderojmë Allahun për të gjitha mirësitë e Tij dhe ta madhërojmë e lavdërojmë gjithmonë Atë. Dhe për shkak se ne jemi të dobët të falënderojmë ashtu siç duhet, atëherë duhet të kërkojmë falje dhe mëshirë prej Allahut të Madhëruar.]

Allahu i Madhëruar e bëftë falënderimin, madhërimin, dhikrin, kënaqësinë dhe lutjen cilësi të pandryshueshme të zemrës sonë edhe nëse ndryshojnë kushtet e jetës. Amin!..





EL-AZIZ

MË I LARTI I TË LARTËVE

Ilir Hoxha

El-Aziz, që është një nga emrat të cilët shprehin në mënyrën më të fuqishme lartësinë dhe madhështinë e Zotit tonë, ka kuptimet si, fisnikëri dhe nder, dominim dhe epërsi, lartësi dhe madhështi. Emri Aziz është e kundërta e fjalës “zelil”, që do të thotë “i dobët dhe i pafuqishëm” dhe gjendet si emër i përveçëm në dhjetë ajete të ndryshme të Kuranit, ku pas cilësive “Rahman” dhe “Rab”, është emri që përdoret më shpesh në vend të emrit Allah.¹ Gjithashtu, në më shumë se njëzet ajete të Kuranit, kur Allahu flet për Vetën e Tij, vë në plan të parë emrin “Aziz”. Të gjitha këto na tregojnë se një prej veçorive kryesore të madhësisë, është “epërsia absolute”.

Në ajetin 180 të sures Saffat, Allahu e prezanton Vetën e Tij si “Zoti i Madhësisë”. Nisur nga kjo, në emër të “Madhësisë”, Ai është zotëruesi dhe burimi i gjithçkaje që mund ta imagjinojmë ose jo.

Atë, të cilit Ai i ka dhënë madhështi, s’ka asnjë forcë që mund ta poshtërojë dhe atij, të cilin Ai e ka poshtëruar, s’ka kush t’i japë madhështi. Ata që nuk arrijnë ta kuptojnë madhësitinë e Allahut, janë në një pozitë edhe më të ulët se ajo e shejtanit, sepse edhe vetë shejtani, kur u betua, u betua për Madhësitinë e Allahut.²

Allahu, Vetë është i Lartëmadhëruar, e sigurisht që edhe libri i Tij është më fisniku. Pra, në këtë mënyrë, ne e dimë se edhe ai (libri) është Aziz/më i larti.³ Ai është mbi çdo fjalë tjetër dhe e lartëson edhe atë që e pason (atë libër). Emri Aziz është përdorur 88 herë në Kuranin Fisnik në pasazhet që theksojnë Fuqinë dhe

Epërsinë absolute të Allahut, duke u shoqëruar gjithmonë me një emër tjetër. Midis emrit Aziz dhe këtyre emrave të tjerë, ekziston një marrëdhënie e cila i konfirmon dhe i ekuilibron ata me njëri-tjetrin.

Allahu i Madhëruar, në ajete të ndryshme të Librit të Tij⁴ thekson se e gjithë epërsia dhe nderi i takojnë Atij. Mirëpo, në një ajet urdhëron se, **“Epërsia i takon Allahut, të Dërguarit të Tij dhe besimtarëve”**⁵, duke treguar se të Dërguarin e Tij dhe besimtarët i ka marrë pranë Vetes dhe i ka bërë të kenë dobi prej epërsisë së Tij. Kjo gradë është një mirësi e jashtëzakonshme, të cilën nuk mund ta japë kush tjetër përveç Allahut dhe që i përgëzon ata që i besojnë Atij, duke u treguar se në çfarë nivelesh mund të ngrihen.

Ndërsa në ajetin 139 të sures Nisa, bëhet e ditur se ata që kërkojnë epërsi dhe nder tek dikush tjetër përveç Allahut, nuk do t’ia arrijnë qëllimit të tyre. Kjo, sepse epërsia dhe nderi, është tek devotshmëria ndaj Allahut. Sa herë që i hapim duart tona drejt Tij, do të thotë se jemi duke qëndruar në derën e epërsisë dhe madhësisë. Çdo adhurimi ynë, çdo dhikër dhe çdo lutje, janë mjete që na kujtojnë epërsinë dhe madhësitinë e Tij. E gjithë epërsia dhe dinjiteti ynë janë dhuratë e Tij dhe vetëm me mirësinë e Tij mund të shtohet e të ruhet. Kush e kërkon dinjitetin e vet tek dikush tjetër përveç Tij, do të poshtërohet. Kjo, sepse një krijesë, mund t’i falë krenari një tjetre vetëm në një nivel më të ulët se vetja. Dhe ky, është vetë poshtërimi. Mirëpo, epërsia dhe madhështia që fal Zoti i botëve, e ngre njeriun sipër botëve. Dhe,

1. shih. En’am, 96; Ibrahim, 1; Shuara, 217.

2. shih. Sad, 82.

3. shih. Fussilet, 41.

4. shih. Junus, 65; Fatir, 10.

5. shih. Munafikun, 8.

të privohesh prej kësaj mirësie, po ashtu është vetë poshtërimi.⁶

Ata që mbështeten dhe mburren duke ia atribuar epërsinë vetes së tyre dhe jo epërsisë së emrit “Aziz” të Allahut, për shkak të këtyre gabimeve devijojnë nga rruga e Allahut.⁷ Ata që kanë pasur turbullirë në mendje lidhur me çështjen e burimit të epërsisë mashtruese ku njerëzimi ka rënë që prej ditëve të para të tij⁸, nuk kanë arritur të kuptojnë qoftë edhe vlerën e profetëve të Allahut.⁹

Emri “Aziz”, është përdorur në katër ajete edhe në kallëpin “azizun dhuntikam”.¹⁰ Ky kallëp shpreh se Allahu është zotëruesi i fuqisë absolute, i Cili do t’ua japë dënimin fajtorëve dhe askush nuk do të shpëtojë pa e marrë dënimin e merituar për ato që kanë vepruar. Pothuajse në të gjitha këto ajete, bëhet e ditur se ata që e kundërshtojnë vullnetin e Allahut, që përpiqen ta nënvleftësojnë Allahun dhe që u hynë në hak të dobëtëve, do të ndëshkohen patjetër prej Allahut në një moment të cilin nuk e presin aspak.

Pedagogia Dr. Ajshen Gyrxhan, në studimin e saj rreth çështjes së ndikimit të Esmau’l Husna/Emrave të bukur të Allahut në formimin e personalitetit njerëzor, ka arritur në përfundimin se për shkak të dendësisë së marrëdhënies së emrit “Aziz” me emrat e tjerë të Allahut në Kuranin Fisnik, ky emër duhet të zërë vend në qendër të personalitetit të njeriut. Siç shprehet edhe vetë Ajshen Gyrxhan, njeriu tek i cili manifestohet emri “Aziz”, është i vetëdijshëm për forcën e vet dhe nderin që i ka falur Allahu.

Fakti që në Kuran ky emër përdoret më shumë së bashku me emrat e tjerë, tregon se në ndërtimin e personalitetit, forca/epërsia është një element parësor. Ashtu siç nuk ka forcë pa pasur trup, ashtu edhe pa pasur epërsi as cilësitë e tjera nuk e gjejnë dot vendin e tyre. Në bazë të këtij evidentimi të Gyrxhanit, kur shikojmë emrat e tjerë me të cilët shoqërohet emri “Aziz”, mësojmë se me çfarë duhet t’i pajisim anët e personalitetit, qendra e të cilit është “izzeti/epërsia”. Për shembull, kur shohim Kuranin Fisnik, vëmë re se dy emra të Allahut përdoren vetëm me

emrin Aziz. Këto janë emrat “Uehhab” dhe “Kauijj”. Ndërsa emrat që përdoren më shumë së bashku me emrin “Aziz”, janë “Hakim”, “Rrahim” dhe “Alim”.

Në 46 vende, prej 88 ku kalon emri Aziz në Kuran, ai përdoret së bashku me emrin “Hakim”, i cili ka kuptimin: *“Ai që e mban veten larg prej informacioneve të pavërteta dhe dëshirave egoiste dhe i cili zotëron të menduarit dhe të vepruarit e drejtë”*. Kur ky emër përdoret për Allahun, merr kuptimin: *“Ai, fjalët dhe veprat e të Cilit janë plotësisht në bazë të drejtësisë, dijesh dhe urtësisë.”* Nisur nga kjo, kuptojmë se “urtësia” është një prej elementeve plotësues më të rëndësishëm të personalitetit, në qendër të të cilit së bashku me dijen dhe mëshirën gjendet edhe epërsia. Si përfundim, njeriu në qendër të personalitetit të të cilit ndodhet “izzeti/epërsia”, e vlerëson dijen, e merr fuqinë prej dijes së tij dhe nuk përpriqet të tregojë forcën me ato që nuk di.

Emri Rrahim, së bashku me emrin Aziz, na kujton se për të ndërtuar personalitetin, fuqia e vërtetë e bazuar në dije gjithmonë duhet të jetë bashkë me mëshirën. Fuqia pa dije, pa mëshirë dhe pa urtësi, është një forcë shkatërruese që nuk i bën dobi as të zotit, e as të tjerëve përreth tij. Për këtë arsye, epërsia e mohuesit të Zotit, e cila nuk mbështetet në dije dhe urtësi, e pengojnë atë nga ndjekja e thirrjeve të atyre që e ftojnë në rrugën e Allahut.

Përkundër kësaj, epërsia e besimtarit, e cila mbështetet në dije dhe urtësi, e ruan atë nga ndikimi i njerëzve që janë në rrugën e së keqes. Në këtë mënyrë, çdo punë që bën ai, i cili është i vetëdijshëm për epërsinë që zotëron në sajë të manifestimit të emrit “Aziz” të Allahut, i ka hije asaj epërsie. Çfarëdo që ai të prodhojë, ajo është cilësore. Ai nuk bën punë pa kujdes dhe shkel e shko sa për të kaluar radhën. Ai e di mirë se në sajë të punës që bën, është përfaqësuesi i epërsisë. Po ashtu, njeriu që zotëron këtë vetëdije, nuk e poshtëron kurrë familjen me të cilën jeton, nxënësit që edukon dhe punëtorët që janë nën drejtimin e tij. Ai e di se ashtu si t’i bëjë të ndihen vartësit e tij, ashtu do të sillen, ashtu do të punojnë dhe do të prodhojnë edhe ata. Njeriu, në sajë të epërsisë që zotëron, sheh dhe mbron edhe epërsinë e të tjerëve. Këtë ka dashur të thotë edhe Profeti (a.s.), kur është shprehur se “modestia e shton epërsinë e njeriut”.

6. shih. Al-i Imran, 126.


7. shih. Bekare, 206.

8. Nga kjo pikëpamje mund të shihet edhe ndodhia e Habilit dhe Kabililit.

9. shih. Hud, 91.

10. shih. Ali Imran, 4; Maide, 95; Ibrahim, 147; Zumer, 37.

EBUL HASAN EN-NEDVI



MYSLIMANËT NË INDI

Sipas studimeve të bëra nga SHBA, në lidhje me numrin e myslimanëve në botë, u konstatua se në Indi, vendi i dytë në botë sipas numrit të popullsisë, jetojnë plot 161 milion myslimanë. Ndërkohë myslimanët e atjeshëm na tregojnë se shifra e saktë është 250 milion. Myslimanët indianë që përbëjnë 13% të popullsisë indiane, janë njohur me Islamin që në shekullin e parë të hixhretit. Islami u përhap në kohën e Emevive dhe Abbasive, por në veçanti në kohën e Selçukëve dhe Gaznelive. India që është mozaiku i feve dhe i gjuhëve, i ka dhuruar gjeografisë islame dijetarë të suksesshëm. Njëri prej tyre është edhe personazhi i shkrimit tonë: Ebul Hasan en-Nedvi.

KUSH ISHTE EBUL HASAN EN-NEDVI?

Hasan en-Nedvi, emri i të cilit është lidhur ngushtë me Indinë, vjen nga fisi i Hz. Hasanit (r.a.), për këtë arsye ai është fisnik. Ai erdhi në jetë me 6 Muharrem të vitit 1333 (1914), në fshatin Rajberili, që është rreth 80 km larg kryeqytetit të vendit. Që në moshë shumë të vogël u njoh me librat. Edhe babai i tij ishte dijetar, por ai e humbi atë kur ishte vetëm nëntë vjeç. Nedvi ishte shumë i vogël për të përfituar nga babai i vet. Ai mbeti nën kujdesin e vëllait më të madh.

Vdekja e babait sjell me vete edhe vështirësi ekonomike. Nedvi përballet me rrezikun e pamundësisë për t'u arsimuar, por të mos harrojmë se Allahu ia hap portat e dijes njeriut që e do shkollimin me gjithë shpirt. Një prej shembujve më të mirë për atë që sapo thamë është vetë Nedviu. Princi Nur Hasan e mban nga dora dhe merr përsipër shkollimin e tij. Bile ai i ofron mundësitë më të mira për t'u shkolluar. Nedviu e mëson arabishten në mënyrë të përsosur. Flet edhe indisht dhe persisht. Mëson edhe anglishten. Ai i përfundon të gjitha mësimet që jepeshin në medrese.

Nedviu shëtit nga qyteti në qytet për të marrë pjesë në organizimet e dijes. Gjatë këtyre mbledhjeve ai kupton se dituria nuk fitohet në mënyrë individuale. Njihet me Muhamed Ikbalin dhe poezia e tij i lë gjurmë të forta. Pas njohjes me Muhamed Ihjas Kandelevi, drejtuesin e organizatës së Udhëzimit, i futet punës për krijimin e një organizatë të ngjashme me të.

Vepra me titull "Çfarë humbi bota me regresin e myslimanëve" është pika ku ai merr kthesën e jetës. Tashmë Nedviu do të njihet me këtë vepër. Pas përkthimit të kësaj vepre në arabisht, ai kthehet në libër-udhëzues. Duke qenë se libri i nxjerr të gjitha të palarat e anglezëve ndaj myslimanëve, Anglia ndalon hyrjen e librit në shumë vende.

Tashmë për Nedviun nuk kanë rëndësi vetëm problemet e myslimanëve të Indisë, por të myslimanëve të të gjithë botës. Ai bën përpjekje për t'u njohur me figurat më të famshme të epokës. Në vitin 1951 njihet me Sejjid Kutubiun më pas edhe me Muhamed Gazaliun. Falë këtyre takimeve ai formon një karakter të fortë e inteligjent. Nedviu që shkroi më shumë se 100 vepra të mëdha e të vogla, u bë një prej njerëzve më të nderuar të Indisë.

ORGANIZATAT MYSLIMANE NË INDI

Në vitin 1943, Hasan en- Nedvi themeloi Qendrën e Dijëve Islame. Në vitin 1948 ai u zgjodh për Nedvetu'l Ulema. Në vitin 1961 u bë sekretar i përgjithshëm. Në vitin 1951 formoi lëvizjen "Mesazhi Njerëzor". Ndërkohë në vitin 1986 themeloi: "Uniteti i Letërsisë Islame".

Sigurisht që organizata më e rëndësishme në Indi ishte Nedvetul Ulema. Kjo organizatë, krijuar në vitin 1311 hixhër (1893). Nedvetul Ulema që kishte kuptimin "Bashkësia e Dijetarëve", ishte krijuar për t'u marrë me problemet e myslimanëve të gjithë botës në përgjithësi dhe me ato të myslimanëve të Indisë në veçanti. Në këtë organizatë mund të gjeje dijetarë të rëndësishëm. Kjo organizatë, që ishte krijuar me baza të dijes dhe të studimit, përfshinte brenda vetes edhe organizatën Darul Ulum. Që prej momentin të krijimit kishte ndihmuar në shkollimin e mijëra njerëzve dhe kishte edukuar po aq thirrës të fesë. Organizata nuk kishte varësi ekonomike me shtetin, por në të angazhoheshin vullnetarisht plot njerëz të rëndësishëm. Njëri prej tyre ishte edhe vetë dekani. Besohet se ky ishte faktori vendimtar i suksesit të organizatës.

Në të shkuarën e organizatës mund të shihen gjurmë të forta të familjes së Nedviut. Ashtu si e kemi përmendur edhe më përpara, familja i kishte rrënjët tek Hz. Hasani dhe kishte edukuar shumë njerëz të mëdhenj e të ditur. Pra mund të themi se gjyshërit e Hasan en- Nedviut kishin lënë vepra të rëndësishme në fe, histori dhe kulturë. Babai i tij, Abdul Hajj, ka qenë kryetari i tretë i Nedvetul Ulemasë, më pas këtë detyrë e mori përsipër djali i tij i madh dhe në vitet 1950 i takon Nedviut që të marrë këtë pozicion të rëndësishëm. Pas marrjes së detyrës Nedviu themeloi degë të organizatës në vende të ndryshme të Indisë. Ai u përpoq t'u ofronte mundësi edukimi njerëzve që vinin nga vendet e ndryshme të botës, si dhe nga India.

VDEKJA DHE PERSONALITETI

Me datën 31 Dhjetor të vitit 1999 (23 Ramazan 1420), ditën e premtë ai u fut në itikaf. Mori abdest, filloi të lexonte suren Kehf dhe pa arritur që ta përfundonte, ra përmbi Kuran duke ia dorëzuar shpirtin Allahut. Jeta e tij 86- vjeçare kaloi me shërbime ndaj Kuranit dhe përfundoi me Kuran. Jeta e tij e bekuar u mbyll me një moment po aq të bukur dhe ai u bashkua me Zotin e vet. U varros në varrezën e famil-

jes. Në varrimin e tij morën pjesë mijëra njerëz. Gjithashtu edhe në shumë vende të botës iu fal namazi i xhenazës së fshehtë.

Ebul Hasan en- Nedvi ia kushtoi jetën diturisë. Gjatë gjithë kohës pyeste veten se çfarë mund të bënte më shumë për Islamin. Sipas tij, për çdo dhjetë vite mund të edukohej një brez. Sipas vlerësimeve të njerëzve të ndryshëm, kjo ishte vlera e tij më e qëndrueshme. Ndërkohë nga vepra e tij me titull: "Çfarë humbi bota me regresin e myslimanëve" patën përfitime myslimanët e të gjithë botës. Ai botoi më shumë se 700 libra dhe kërkime shkencore, 177 prej tyre ishin në gjuhën arabe. Shumë prej veprave të tij u përkthyen në gjuhë të huaja. Mendimet e tij nuk u shpërndanë vetëm në mesin e myslimanëve të Indisë, por në të gjithë myslimanët e botës. Në një reportazh të dhënë për revistën "Uniteti", ai tregoi se në këtë mënyrë ai i jepte formë karakterit të thirrësve islamë. "Metoda e thirrjes së njerëzve në fe duhet të jetë ajo e "veprave" dhe "moralit". Me "vepra" nënkuptojmë faktin se njerëzit duhet të jenë dëshmitarë të praktikave tona ndërsa me "moral" e kemi fjalën për moralin e lartë e të bukur që duhet të ketë thirrësi në fe."

Që në fillim ai u ndikua shumë nga Omer bin Abdulazizi, Ahmed bin Hanbeli, Ibni Tejmijje, Ahmed Serhendi, Shah Velijullah Dihlevi dhe Muhamed Iljasi. Ai e theksonte mendimin e vet se çështja e Palestinës nuk ishte një problem që prekte vetëm palestinezët, por myslimanët e të gjithë botës. Ai mendonte se ky problem mund të zgjidhej vetëm me anën e Selahaddin Ejjubit. Asnjëherë nuk e fshehu admirimin e madh për Selahaddin Ejubin. Ndërsa admirimin ndaj ustasë Bediuzzaman e shprehte me këta rreshta: "Shkrimet tona nuk janë të vërteta. Ne ulemi në biblioteka që përmbajnë miliona libra, kur duam të shkruajmë për një çështje të caktuar, marrim pjesë nga libra të tjerë dhe i shkruajmë duke nxjerrë në pah një libër. Nga ana tjetër, biblioteka e Bediuzzamit ishte e përbërë nga malet e lumenjtë. Ky është shkrimi i vërtetë. Ai është ustai i të gjithë shkrimtarëve; ai është ustai i të gjithë hoxhallarëve, ai është shejhu."

Idetë e këtij njeriu me karakter të lartë, që ia kushtoi jetën shërbimit ndaj fesë, vazhdojnë të jenë udhërrëfyese të thirrësve në Islam. Bëjmë dua që ai të bekohet me të mirat e Allahut.



BEGATIA DHE FUQIA *e një rekati namaz*

Xhemal Nar

Begatia dhe forca e një rekati namaz përmban thesarin e fesë islame. Në sajë të një rekati namaz, robi hyn në bisedë me Allahun e Madhëruar. Fjala hyjnore që lexohet, rrjedh në mënyrë të vazhdueshme si dallgët e baticave dhe zbaticave prej Allahut tek adhuruesi, prej adhuruesit tek Allahu. Një rekat i namazit siguron një rrjedhë të përjetshme dhe një frymë hyjnore që nuk mbaron kurrë. Një rekat, të zhyt në oqeanin e njëshmërisë së Allahut. Një rekat, na tërheq drejt aromës së ëmbël të Xhenetit. Një rekat, na ofron dhuratën e mrekullueshme të Miraxhit. Një rekat, përmban thesarin e fesë Islame.

Në një rekat, trupi merr katër pozicione themelore. Çdonjëra prej këtyre pozicioneve formon një germë të alfabetit arab. Këto germa janë ato me të cilat shkruhet emri “Allah”. “Elifi”, është kijami, “Lami” është rukuja, ndërsa “He” është sexhdja dhe në të njëjtën kohë është edhe pozicioni i uljes dhe pushimit.

Kijami (qëndrimi në këmbë), është simboli i botës së njerëzve, që është prej Allahut. Rukuja (përkulja), është simboli i botës së kafshëve, që është orientim drejt Allahut. Sexhdja (vënia e ballit në tokë), është simboli i bimëve, që do të thotë të ndjesh Allahun. Ndërsa ulja, është simboli i mineraleve, që është për Allahun. Si përfundim, trupi merr këto pozicione gjatë një rekati dhe me lëvizjet e tij formon fjalën “Allah”.

Falja e një rekati me sinqeritet, të bën të ndjesh përbrenda ëmbëlsinë e të vërtetave hyjnore. Me qëndrimin në kijam, përgatitim veten për Ditën e Kiame-

tit, Ditën e Ringjalljes dhe të Llogarisë. Me leximin e sures Fatiha në fillim të namazit, edukojmë veten që të na hapet botëkuptimi hyjnor. Me anë të rucusë, e mësojmë veten me devotshmëri, ku zhvishemi prej çdo gjëje të kësaj bote dhe përkulemi para Allahut të Madhëruar. Me sexhden mësohemi të sakrifikojmë veten, të zhvishemi prej egos dhe të kuptojmë se jemi “asgjë”. Me anë të tahijjatit, e përgatisim veten për t’iu afruar Allahut dhe për të biseduar me Të. Me anë të shehadetit (dëshmisë), forcojmë besimin dhe përpiqemi të arrijmë gradën e besimit të palëkundur. Ndërsa me anë të salavateve, zbusim zemrat tona për të përfutuar prej bukurisë dhe dashurisë hyjnore.

Në sajë të një bisede që ka ndodhur në Natën e Miraxhit, dimë se ndërkohë që ne falim namazin, të gjitha shtresat e Xhenetit mbushen me melekë që falin namaz së bashku me ne, duke qëndruar në kijam, duke u përkulur në ruku dhe duke rënë në sexhde. Madje, ata falin namaz pas nesh duke formuar xhemat. Përreth nesh qëndron një orkestër simfonike e mrekullueshme e përbërë prej melekëve të panumërt, të cilët përkujtojnë dhe falënderojnë Allahun së bashku me ne.

Adhurimi i namazit, është urdhëruar që ne të marrim pjesë në rrjedhën e rregullit hyjnor. Në sajë të një namazi të falur me sinqeritet dhe përkushtim, kemi nderin të marrim pjesë në korin e falënderimit të të gjithë melekëve. Në të njëjtën mënyrë, edhe melekët marrin pjesë në madhërimin, falënderimin dhe përkujtimin tonë ndaj Allahut, në duatë dhe leximin tonë të Kuranit.

Pozicionet që merr trupi në namaz, plotësojnë njeri-tjetrin në një harmoni të mrekullueshme dhe çdonjëri prej tyre, përgatit pozicionin e radhës. Pa parë “asgjësimin” dhe “shkrirjen” e egos, nuk mund të arrijmë ekzistencën dhe pafundësinë. Pa qëndruar në kijam, nuk mund të shkohet në ruku. Pa u përkulur para Allahut, nuk mund të ulesh në sexhde. Në kalimin e trupit nga një gjendje në tjetrën kur robi fal një rekat namaz, ai arrin mëshirën dhe frymëzimin hyjnor dhe, kur e plotëson një rekat, ai fillon nga e para. Një rekat, simbolizon pafundësinë, sepse fundi i tij të çon në fillim dhe në këtë mënyrë formohet rrjedha e përrjetshme. E shprehur ndryshe, njeriu që fal namaz, gjatë një rekati rrjedh dhe kalon prej emrave të Allahut të Madhëruar.

Pozicioni i kijamit, është fillimi i namazit. Prandaj, me qëndrimin në kijam dhe këndimin e sures Fatiha, hyjmë në sarajin madhështor të Allahut dhe dalim para Madhërisë së Tij. Kijami shpreh qëndrimin fisnik, të çmuar dhe të dalluar të njeriut. Kijami simbolizon ringjalljen pas vdekjes. Lidhur me kijamin në namaz, Profeti (a.s.), ka thënë: “Bëhuni të drejtë, që mëshira e Allahut të bjerë mbi ju!” Shprehja “bëhuni të drejtë”, nënkupton moralin, sinqeritetin, qëndresën, durimin dhe drejtësinë. Për të përjetuar ringjalljen e vërtetë, besimtarët duhet të shtypin egon e tyre, duke e çuar në zero.

Me qëndrimin në kijam, përgatitemi për Ditën e Ringjalljes. Me kijam përgatitemi për Kiametin, pra, kijami siguron përgatitjen e njerëzve për të përballuar Ditën e Kiametit. Kijami përfaqëson gjendjen e njeriut vertikalisht, ndërsa ata që qëndrojnë në kijam në rreshta, nënkuptojnë bashkimin përpara madhësisë së Allahut. Në këtë mënyrë, para Tij, i gjithë xhemati përjeton një ndjenjë të ngjashme me Ditën e Ringjalljes në një atmosferë shpirtërore dhe vëllazërore, duke e lënë pas shpine botën. Domethënë se, shqetësimi i Rasulullahut (a.s.), për umetin e tij, është në lidhje me atë që do t'i ndodhë në Ditën e Gjykimit. Xhelaledin Rumi, thotë: “Thelbi i të gjitha dijeve është që njeriu të dijë se çdo të ndodhë në Ditën e Kiametit.”

Përveç kësaj, kijami na përgatit për t'i kryer ashtu siç duhet edhe pjesët e tjera të namazit. Pasi të qëndrojmë para Allahut ashtu siç duhet, në fazën e rukusë pas kijamit, mund të kalojmë duke u përkulur me ndjenjën e mirënjohjes dhe modestisë. Rukuja simbolizon devotshmërinë, sinqeritetin, përkuljen dhe bindjen vetëm ndaj Allahut të Madhëruar. Përkulja e kokës sonë para Tij, shpreh dorëzimin me gjithë shpirt, modestinë e plotë dhe pranimin nga ana jonë e nënshtrimit ndaj Tij.

Pas rukusë, themi “semi Allahu limen hamide/Allahu i dëgjon ata që e falënderojnë.” Dhe drejtohem përsëri. Pastaj e përsërisim përgjigjen që Allahu na ka premtuar neve dhe melekëve pas nesh. Ndërsa melekët, ia kthejnë: “Rabbena lekel hamd/Falënderimi të takon Ty o Zot,”. Ky dialog hyjnor na përgatit për lëvizjen e tretë që është qëndrimi i mrekullueshëm në

sexhde. Në këtë fazë, ne kalojmë prej pozicionit më të lartë të trupit, në pozicionin më të ulët të tij, duke dëshiruar të asgjësohem dhe të shkrihem plotësisht.

Sexhdja është dëshira për t'u bashkuar me të Dashurin tonë. Ajo përfaqëson asgjësimin e plotë të robit përpara Zotit dhe Sunduesit të tij dhe dorëzimin ndaj Tij. Në kuptimin e plotë të fjalës, sexhdja është pikërisht gjendja e Rasulullahut (a.s.). Për këtë arsye, Profeti tonë (a.s.), i është bërë e dashur aroma e mirë dhe namazi. Ndërsa vënia e ballit në tokë gjatë sexhdes, simbolizon qëllitjen nga toka dhe asgjësimin e tij në barkun e tokës. Duke u mbledhur dhe zvogëluar, njeriu përpiket të strehohet në mëshirën dhe dhembshurinë e Zotit të tij.

Pasi egoja t'i jepet plotësisht Allahut, besimtari qëndron në pozicionin ulur. Duke ia dorëzuar veten të Përrjetshmit, adhuresi gjen përsëri jetë në pafundësi. Është ekzistencë brenda ekzistencës. Siç shprehet edhe në Kuranin Fisnik: **“Do të mbetet vetëm Fytyra e Zotit Tënd, plot Madhëri dhe Nderim.”** (Rrahman, 27) **“...Ngado që të ktheheni, andej është Fytyra (ana) e Allahut...”** (Bekare, 115) **“...S'ka zot tjetër të vërtetë përveç Tij! Çdo gjë do të shkatërrohet, përveç Fytyrës së Tij!”** (Kasas, 88)

Në atë çast shumë të çmuar, robi këndon tahijjatin, njësoj si biseda midis Profetit tonë (a.s.) dhe Allahut të Madhëruar në natën e Miraxhit. Gjatë thënies së shehadetit, robi arrin majat shpirtërore dhe feston kënaqësinë në aspektin shpirtëror. Kjo është skena finale e namazit. Robi feston qëndrimin para Allahut ashtu siç bëri shehadetin Profeti ynë (a.s.) në qiell së bashku me melekët. Pas kësaj bisede hyjnore që zhvilloi me Allahun e Madhëruar, robi i dërgon salavate Ibrahimit dhe Muhamedit (alejhima selam), duke e mbushur zemrën e tij me dashuri.

Në një aspekt namazi lidhet edhe me haxhin. Në dukje, namazi është një qetësi, por brenda tij, është një haxh. Haxhi, është një veprim me orientim të jashtëm, ndërsa namazi është një veprim me orientim të brendshëm. Namazi është një haxh i palëvizshëm, ndërsa haxhi është një namaz që ka kaluar në lëvizje. Namazi dhe haxhi, janë prej adhurimeve me të cilat Allahu e ka nderuar robin duke e thirrur në prezencën e Tij. Brenda kuptimit simbolik, namazi është një haxh i vërtetë. Namazi është një haxh që bëhet në atdheun e vërtetë të shpirtit, në thellësitë e zemrës. Miraxhi që arrin njeriu gjatë faljes së namazit, është një haxh i brendshëm. Në këtë mënyrë, edhe haxhi, në thelb është një miraxh.

Nëse ia përkushtojmë veten namazit, nëse tregojmë dorëzim të plotë, nëse kemi entuziazmin e devotshmërisë, nëse falënderojmë vazhdimisht, nëse kemi frikë-respektin e duhur ndaj Allahut dhe nëse tregojmë modesti brenda kufijve, atëherë Allahu do të na falësuksese nga ana e Tij.

Allahu ma dërgoi Islamin në shtëpi

Një punonjëse amerikane e policisë zbulon Islamin

Linda Delgado (Widad)

Pesë vite të shkuara isha pesëdhjetë e dy vjeçe dhe kristiane. Nuk isha bërë kurrë anëtare e ndonjë kisha kristiane, por tërë jetën kisha qenë në kërkim të së vërtetës. Pata vënë këmbën në shumë kisha, e kisha studiuar me mësuesit e tyre. Asnjë nuk ia doli, e unë nuk njoha asgjë që të jetë e vërteta rreth Allahut. Biblën e kisha lexuar çdo ditë që nëntë vjeç. Nuk mund t'ju tregoj sa herë e kam kërkuar të vërtetën përgjatë shumë viteve. Studiova shumë besime fetare në kërkimin tim për të vërtetën. Një vit

të tërë studiova dy herë në javë me një prift katolik, por nuk munda ta pranoja besimin katolik. Çova një vit tjetër duke studiuar me Dëshmitarët e Jehovait, e nuk e pranova as besimin e tyre. Kalova thujse dy vite me Shenjtorët e Ditëve të Mëvonshme, (pra, me mormonët), e përsëri nuk e gjeta të vërtetën. Kisha një mik hebre, dhe kishim shumë diskutime mbi besimin hebraik. Vajta në shumë kisha protestante, në përpjekje për t'u gjetur përgjigje pyetjeve të mia.



Zemra më thoshte se Jezusi nuk ishte Zot, por një profet, se Adami dhe Eva ishin përgjegjës për mëkatin e tyre, jo unë. Më thoshte se duhej t'i lutesha Zotit, e asnjë tjetri. Arsyeja më bënte të ditur se unë isha përgjegjëse për punët e mia të mira e të këqija, e se Zoti nuk do të merrte kurrë formën e një njeriu për të më treguar se nuk isha përgjegjëse. Ai nuk kishte nevojë të jetonte dhe të vdiste si një krijesë njerëzore; tekefundit, Ai është Zoti!

E kështu, isha plot pyetje, dhe i lutesha Zotit për ndihmë. Kisha vërtet frikë se mos vdisja pa e ditur të vërtetën. U luta pa fund. Mora nga predikues dhe priftërinj përgjigje të tilla si, "Ky është një mister." E ndjeja se Zoti dëshironte që njerëzit të shkonin në parajsë, kështu që nuk mund ta fshihte mënyrën si të shkohej atje, si të çohej jeta në përputhje me të, e si të kuptohej Ai. E dija në brendësi se gjithçka që po dëgjoja ishte e pavërtetë.

Zbulimi im

Rreth katër mote më parë u tërhoqa nga detyra pas njëzet e katër viteve si punonjëse policie. Im shoq po ashtu u tërhoq si një punonjës policie. Punonjësit e policisë anekënd botës kanë një lidhje të përbashkët, të cilën ne e quajmë vëllazëria apo motëria e zbatimit të ligjit. Ne gjithmonë e ndihmojmë njëri-tjetrin, pa marrë parasysh departamentin apo vendin. Atë vit mësova se ca punonjës policie nga Arabia Saudite që kishin ardhur në Shtetet e Bashkuara për të mësuar anglisht në një universitet lokal dhe për të ndjekur një akademi policie po kërkonin ndihmë. Ata ishin në kërkim të shtëpive ku t'u hapej dera e të jetonin me familjet pritëse për të mësuar zakonet amerikane e për të praktikuar anglishten.

Im bir po e rriste i vetëm mbesën time. E ndihmuam atë të gjente një shtëpi afër nesh, për t'iu ndodhur pranë. Biseduam me tim shoq dhe vendosëm se do të qe mirë t'i ndihmonim këta punonjës policie. Do të ishte dhe një mundësi për mbesën tonë që të mësonte mbi njerëz nga një vend tjetër. Më thanë se të rinjtë ishin myslimanë, dhe qeshë shumë kureshtare.

Një përkthyes i Universitetit Shtetëror të Arizonës na solli një djalë të ri, të quajtur Abdul, për

të na takuar. Ai nuk mund të fliste anglisht. I treguam një dhomë gjumi dhe një banjë, që do të ishin të tijat gjatë qëndrimit me ne. Sjellja e tij e njerëzishme dhe plot respekt më bëri për vete.

Më pas në shtëpinë tonë sollën dhe Fahdin. Ai ishte më i ri dhe më i turpshëm, por i mrekullueshëm. Unë u bëra kujdestarja e tyre, dhe ne patëm shumë diskutime të përbashkëta mbi punën e policisë, mbi SHBA-të, mbi Arabinë Saudite, mbi Islamin, etj. Vura re si e ndihmonin njëri-tjetrin, si dhe gjashtëmbëdhjetëvjeçarët e tjerë që kishin ardhur për të mësuar anglisht.

Gjatë vitit që ishin këtu, do t'i admiroja dhe respektoja Abdulin dhe Fahdin për moslënien e kulturës amerikane që të kishte ndikim mbi ta. Shkonin në xhami, kryenin lutjet e tyre sado të lodhur të ishin, dhe ishin gjithmonë të kujdesshëm për atë që hanin. Më treguan si të gatuj ca ushqime tradicionale saudite, e më morën në tregjet e restorantet arabe. Me mbesën time ishin shumë të dashur. Mua dhe tim shoq na trajtuan me shumë respekt.

Një ditë u kërkova një Kuran. Doja të lexoja se ç'thoshte. Nga ambasada e tyre në Uashington më sollën një Kuran në anglisht, kaseta magnetofoni, e libra të vegjël. Me kërkesën time, ne filluam të flisnim mbi Islamin (ata duhej të flisnin anglisht, dhe ky u bë fokusi i sesioneve tona të mësimëve private).

"Bijtë për shpirt" do të ktheshin në Arabinë Saudite, dhe unë bëra një darkë me të gjitha ushqimet e tyre tradicionale më të pëlqyeshme (ca i mora të gatshme, ngaqë nuk dija t'i gatujta të tëra). Bleva një *hixhab* dhe një *abaja*. Doja që ata të ktheheshin në vendin e tyre duke më kujtuar të veshur siç duhet, si një motër myslimane. Përpara se të hanim, thashë shehadetin. Djemtë klithën e qeshën, dhe kjo ishte shumë e veçantë. Besoj brenda meje se Allahu i dërgoi djemtë në përgjigje të lutjeve të mia për vite me radhë. Besoj se Ai më zgjodhi mua për ta parë të vërtetën me dritën e Islamit. Besoj se Ai ma dërgoi Islamin në shtëpi. E lëvdoj Atë për mëshirën, dashurinë dhe dhembshurinë ndaj meje.

Ngjanë shumë ndryshime

Djemtë e mi sauditë ikën rreth një javë pas konvertimit tim. Më mungonin shumë, por prapë isha e lumtur. I isha bashkuar xhamisë lokale thujse menjëherë pas kthimit në Islam. Kisha ndeshur një pritie të ngrohtë nga bashkësia ime e re mys-

limane. Mendoja se të gjithë myslimanët ishin si djemtë e mi sauditë, e si oficerët e tjerë sauditë që kisha takuar e me të cilët kisha kaluar kohë gjatë vitit të shkuar.

Familja ime ishte ende e tronditur. Ata kujtonin se do të jepesha për njëfarë kohe pas kësaj feje të re, do të pezmatohesha, e do të lëvizja në një fe tjetër, siç kisha bërë gjatë jetës sime si e rritur. U habitën me ndryshimet që nisa të bëja në jetën time të përditshme. Bashkëshorti im është një njeri i kuptueshëm, e thoshte, “në rregull,” kur tregoja se do të shkonim të hanim ushqime hallall, apo të eliminonim ushqimet haram.

I shkruajta një letër familjes sime jomyslimane. U tregova mbi konvertimin tim, e se ç’do të ndryshonte e çfarë nuk do të ndryshonte në marrëdhëniet tona familjare. Nuk më thanë gjë, dhe unë vazhdova të punoj për të mësuar faljen e namazit, e të lexoj Kuran. U bëra aktive në grupe motrash në internet, dhe kjo ma lehtësoi mësimin e besimit të ri.

Po ashtu, kur mund të largohesha nga puna, shkoja në xhami në orët e mësimin të “Pari-meve bazë të Islamit”. Isha ende një punonjëse policie, dhe ishte e vështirë, jo, e pamundur, të mbulohesha. Kjo u bë një burim shqetësimi dhe pakënaqësie për mua. Duheshin vetëm tetë muaj për t’u tërhequr nga detyra, dhe kërkova që të punoja në shtëpi e të komunikoja që andej. Kërkesa m’u plotësua.

Jeta ime ka ndryshuar fort gjatë këtyre katër viteve. Familja ime e ka pranuar me maturi dhe zemërgjerësi që unë jam myslimane dhe do të mbe-tem myslimane. Të gjitha falënderimet i takojnë Allahut që më kurseu nga sprovat e aq shumë të konvertuarve, që duhet të merren me familjen, e cila përpiket t’ua prishë mendjen e t’i largojë prej Islamit.

Pasi vizitova një numër xhamish dhe më ra në sy se ato ishin si Kombe të Bashkuara të vogla, fillova të shoh se grupet brenda tyre ishin përgjithësisht të formuara për shkak të gjuhës dhe kulturës, e jo nga pëlqimi apo mospëlqimi i një personi. U ndjeva mirë se pavarësisht këtyre dallimeve, unë

mund të shpresoja gjithmonë për një buzëqeshje dhe një *Esselamu Alejkum!*

Kohë më pas fillova të jepem pas motrave myslimane të kthyera në Islam si unë. Ne kemi shumë të përbashkëta, kalojmë të njëjtat sprova, si të qenit anëtarë të familjeve jomyslimane, vështirësitë në shqiptimin e arabishtes, të qenit vetëm në festat islame, dhe mospasjen e një anëtari të familjes me të cilin të ulesh për të ngrënë pas mbarimit të agjërimit gjatë ramazanit.

Teksa isha më pak në gjendje për të bërë shërbime komunitare, kërkova mënyra të reja për të kontribuar për bashkësinë myslimane. Vijova të kërkoja ndihmën e Allahut për këtë. Një ditë, mbesa më sugjeroi të shkruaj një libër mbi djemtë sauditë, mbi Islamin, e mbi përvojën e familjes sime me Islamin. Vendosa të shkruaja libra, e të

përfshija gjithashtu histori të një grupi vajzash të reja, myslimane dhe jomyslimane, që ishin mikështa.

Historitë do të kishin pjesë të tyre problemet e ndeshura nga vajzat në shkollë dhe në shtëpi, dhe unë do të shfrytëzoja dijen time mbi Islamin si një udhëzuese për këto karaktere të librave. Krijova një grup në internet me motra autore, e kjo çoi në formimin e një lidhjeje, të një organizate ndërkombëtare, të marrë formë për t’u siguruar mbështetje autoreve myslimane. Bëra në mend

që një pjesë të madhe të fitimeve të mia nga shitja e librave ta shpenzoj për të blerë libra për bibliotekat islame të fëmijëve. Kisha zbuluar se libraritë e tilla kishin shumë raftë bosh, në të cilat duhej të gjendeshin librat islamë.

Unë kam ende shumë për të mësuar mbi Islamin. Kurrë nuk lodhem së lexuari Kuranin, dhe më pëlqen që në kohë të lirë të lexoj mbi figurat e spikatura, historike, myslimane. Kur jam e pasigurt për diçka mbi Islamin, shoh në Sunnetin e Profetit (paqja qoftë mbi të). Vështroj si ai u përgjigjej situatave, dhe e përdor këtë si udhërrëfyes për mua.

Udhëtimi im në Islam ka për të vazhduar dhe unë shoh përpara për përvoja të reja. Unë e falënderoj Allahun çdo ditë për mëshirën dhe dashurinë e Tij.

*Arsyeja më bërë
të ditur se unë isha përgjegjëse
për punët e mia të mira e të këqija,
e se Zoti nuk do të merrte kurrë formën
e një njeriu për të më treguar se nuk isha
përgjegjëse. Ai nuk kishte nevojë
të jetonte dhe të vdiste si një krijesë
njerëzore; tekefundit,
Ai është Zoti!*



Diagnoza dhe kurimi

Idris Arpat

Nëse ekziston një sëmundje, një vështirësi apo një problem, veprimi më i domosdoshëm që mund të bëhet, është të studiosh burimin e tyre dhe të prodhosh zgjidhje për eliminimin e atyre problemeve.

Në fakt, ndërkohë që ekziston Islami si shërim për sëmundjet dhe si zgjidhje për problemet, si është e mundur që myslimanët po përjetojnë tablonë më të dhimbshme mbase të të gjithë historisë? Nuk ka nevojë të shkruhet e të shprehet me gojë kjo tablo e dhimbshme që po përjetohet sot, sepse e vërteta po hakërrrohet vetë pa i lënë vend fjalës dhe shkrimit.

Nëse kemi një zjarr, një tërmet apo një përmytje, tashmë nuk ka nevojë të diskutohet ekzistenca e tyre, sepse ngjarja është duke ndodhur konkretisht.

Gjendja e botës islame sot, është siç e ka shprehur edhe poeti iranian, Enveri, i cili thotë: *“Nëse prej qiellit një fatkeqësi zbret si mysafir, më parë shtëpinë e Enverit do të pyesë. Sikur Enveri ka lidhje farefisnore me fatkeqësitë!”*

Kurani Fisnik, këtë Umet, e përshkruan në këtë mënyrë: **“Ju jeni populli më i mirë i dalë për njerëzimin: (sepse) ju urdhëroni që të bëhen vepra të mira, i ndaloni të këqijat!..”** *“Kështu, Ne ju kemi bërë një bashkësi të ekuilibruar (mesatare), që të bëheni dëshmitarë përmbi njerëzit dhe që i Dërguari të jetë dëshmitar përmbi ju.”*²

1. Al-i Imran, 110.

2. Bekare, 143.

Umeti që përkufizohet si më i miri, më i ekuilibruari, e Umeti dëshmitar dhe që i ka bartur këto cilësi gjatë gjithë historisë, përse sot ndodhet në një gjendjet për të ardhur keq, duke u bërë shënjestra e dhimbjeve, shigjetave ogurzeze dhe e fatkeqësive? Ndërkohë që dje urdhëronim dhe ndihmonim, përse sot marrim urdhra dhe presim ndihmë nga të tjerët?

Allahu është i pastër nga padrejtësia. Ai nuk i bën padrejtësi askujt: **“...Nuk ishte Allahu që u bëri atyre padrejtësi, por ata i bënë vetvetes padrejtësi.”**³ **“Çfarëdo fatkeqësie që ju godet, është si pasojë e asaj që keni bërë vetë; por Ai fal shumë.”**⁴

Nga këto ajete kuptojmë se shkaku i këtyre dhimbjeve dhe poshtërimeve që po përjetojnë sot myslimanët janë vetë ata. Dje, për shkak se jetonin në rrugë të drejtë, gëzonin nderin dhe ndihmën hyjnore, ndërsa sot, për shkak se janë ndarë nga rruga e drejtë, kanë rënë në poshtërim. Të gjitha këto fatkeqësi që po përjetojnë, janë për shkak se i kanë kthyer shpinën së vërtetës.

“E si t’i udhëzojë Allahu në rrugë të drejtë njerëzit që u bënë mohues, pasi më parë patën besuar e dëshmuar se i Dërguari është i vërtetë dhe u kishin ardhur provat e qarta?! Allahu nuk i udhëzon në rrugë të drejtë ata që janë keqbërës.” (Al-i Imran, 86)

Nëse një Umet, që ka gëzuar një dritë si Islami, miqësinë, solidaritetin vëllazëror, burimin e mëshirës dhe ka parë të gjitha dobitë e këtyre gjatë gjithë historisë, ia kthen shpinën kësaj mirësie e cila ishte burimi i nderit, respektit dhe fuqisë, do të përballet me poshtërimin dhe fatkeqësitë.

Njerëzit, drejtohen nga drejtues të cilët ata i meritojnë. Prandaj thuhet: **“Veprat tuaja, janë drejtuesit tuaj!”** Të mirat dhe të këqijat që përjetojnë, janë si rezultat i të mirave dhe të këqijave që bëhen. Çfarë të mbjellësh, atë do të korrësh. **“Çdo njeri është peng i veprave të veta.”** (Tur, 21)


Allahu është i drejtë. Kush punon dhe vepron me drejtësi, qoftë ai mohues apo besimtar, Allahu do t’i japë shpërblimin e plotë të punës së tij. Ai nuk bën kurrë padrejtësi.

“Sa për atë që dëshiron këtë botë, Ne shpejtojmë që t’i japim çfarë të dëshirojmë atij që duam. Pastaj ia caktojmë atij Xhehenemin, në të cilin ai do të përveçohet, duke qenë i turpëruar dhe i dëbuar. Sa për atë që dëshiron botën tjetër dhe përpiqet për të me gjithë shpirt e duke qenë besimtar, përpjekja e tij do të shpërblehet. Ne i mbështesim të gjithë me dhuratat e Zotit tënd: edhe këta, edhe ata. Dhuratat e Zotit tënd nuk i mohohen askujt.” (Isra, 18-20)

Dikush që duket si mysliman, por në thelb nuk është, që e mbulon myslimanizmin e vërtetë me myslimanizmin formal, duke e përdorur fenë për qëllimet e tij të ulëta, është një mashtrues. Njeriu, siç thotë edhe Mevlana i nderuar, **“ose do të bëhet si duket, ose do të duket si është”**. Sot myslimanët po vuajnë dënimin e kësaj dyfytërsie. Feja është sinqeritet. Syfaqësia është e kundërta e sinqeritetit. Qëndrimi dhe dukja e myslimanëve në kundërshtim me sinqeritetin, është në dizavantazh edhe për vetë ata, edhe për Islam. Dënimi i përfaqësimit të keq të fesë, është i rëndë. Prandaj nuk duhet të gjendemi në një pozitë të tillë: **“O Zoti ynë, mos na bëj sprovë për jobsimtarët dhe falna ne. O Zot! Vërtet, Ti je i Plotfuqishmi dhe i Urti.”** (Mumtehine, 5)

Madje edhe gjynahu i atyre që heqin dorë nga pranimit i Islamit duke parë gjendjen tonë të mjerë, rëndon mbi supet tona. Sot, myslimanët po përjetojnë një problem serioz të përfaqësimit. Ata që therin njerëz para kamerave, që sillen me gratë që kanë rrëmbyer si të ishishin robëresha, që e kanë bërë profesion terrorizmin dhe që me paturpësinë më të madhe thonë se po veprojnë në emër të Islamit, janë vetë tradhtarët e Islamit. Ata të cilët e tregojnë si fe terrori Islamit tonë të bukur, që edhe emrin e ka paqe, i mallkojnë edhe Allahu, edhe melekët, edhe të gjithë njerëzit. Sot Islami po dëmtohet më tepër prej këtyre myslimanëve të rremë. Ndërsa faturën e këtyre e paguajnë të gjithë myslimanët. Prandaj, parandalimi i këtij mashtrimi, pikësëpari është detyrë e myslimanëve të vërtetë. Ndërsa neglizhimi i kësaj detyre, po vuhet si dënim. Profeti ynë (a.s.), dënimin e këtij neglizhimi, na e shpjegon me këto fjalë:

“Beto hem në Allahun, me lejen dhe fuqinë e të cilit jetoj, se ose urdhëroni për të mirë dhe ndaloni prej



Nëse një mysliman nuk di më tepër se një jomysliman rreth Islamit dhe bën çdo gjë që bën edhe jomyslimani, atëherë përse të jetë më i mirë se ai? Të jesh edhe mysliman edhe injorant, edhe mysliman edhe skllav, edhe mysliman edhe mashtrues etj., është sikur një send të jetë edhe i bardhë edhe i zi.

3. Rum, 9.

4. Shura, 30.

të këqijave, ose Allahu do t'ju dërgojë së shpejti një dënim prej Tij. Pastaj do t'i luteni e përgjëroheni Allahut, por lutja juaj nuk do të pranohet.” (Tirmidhi, Fiten, 9.)

Ata që i mbyllin sytë ndaj të këqijave dhe që nuk mbajnë qëndrim kundër tyre, në njëfarë mënyre konsiderohen se janë bërë ortakë në të keqe.

Sot gjendja e botës islame, është e prishur, qoftë në aspektin individual, ashtu edhe në atë shoqëror. Vendet islame, në radhitjen e rregullit dhe moralit, ndodhen mbrapa shumë vendeve. Ku është Umeti më i mirë, Umeti më i ekuilibruar, më mesatari, e Umeti dëshmitar dhe ku është Umeti i sotëm!?

I ndjeri Muhamed Kutub, ka shkruar një libër me titull “A jemi myslimanë?”, në të cilin vë në pikëpyetje myslimanizmin tonë.

Edhe i ndjeri Hasan Ali Nedevi, ka shkruar një libër me titull, “Përsëri drejt Islamit”, ku edhe ai bën një vetëllogari serioze. Ndërsa i ndjeri Meududi, në librin e tij me titull “Ejani të bëhemi përsëri myslimanë”, bën evidentime interesante. Dhe siç shprehet ai, “një mysliman nuk bëhet mysliman i vërtetë vetëm duke lindur si mysliman. Myslimani nuk bëhet mysliman vetëm sepse i përket një race të caktuar. Myslimanizmi nuk është thjesht me të lindur. Askush nuk mund të bëhet mysliman pa marrë dije dhe pa e njohur kuptimin e Islamit. Mysliman bëhesh duke ndjekur Islamin.

Nëse një mysliman nuk di më tepër se një jomysliman rreth Islamit dhe bën çdo gjë që bën edhe jomyslimani, atëherë përse të jetë më i mirë se ai? Të jesh edhe mysliman edhe injorant, edhe mysliman edhe skllav, edhe mysliman edhe mashtrues etj., është sikur një send të jetë edhe i bardhë edhe i zi. Të gjithë duhet ta përcaktojnë mirë pozitën e vet.”

Kelime-i Teuhdi, është besëlidhja me Allahun. Është hyrje brenda kufijve të Islamit. Nëse njeriu qëndron brenda këtyre kufijve, ai është mysliman. Myslimanizmi është një përkatësi dhe identitet. Për rrjedhojë, bartja e këtij identiteti dhe përfaqësimi sjell me vete edhe përgjegjësitë e veta. Nëse në këtë botë nuk ka asnjë dallim midis jetës së myslimanit dhe jomyslimanit, përse duhet të ketë dallim në botën tjetër!?

Problemet që po përrjetojmë sot burojnë nga dobësitë tona të besimit, moralit dhe veprave. Por në vend që të përdorim ilaçet sipas përshkrimit, ne merremi ende me përsëritjen e emrave të ilaçeve.

Myslimanizmi nuk është vetëm të thuash kelime-i teuhidin. “**Vërtet mendojnë njerëzit, se do të lihen të thonë “Ne besojmë”, pa u vënë në provë!?**” (Ankebut, 2) Nuk mund të jesh mysliman vetëm me emër e me foto. Fotoja nuk ka shpirt. Padyshim se luani të cilit i është rrjepur lëkura dhe është mbushur me kashtë për t’u vënë në muze, nuk është i njëjtë me luanin e gjallë që hungërin. Feja është dinamikë. Një fetari e bërë kufomë, është barrë për jetën.


Po ashtu edhe Muhamed Ikbali, ankohet prej myslimanit të sotëm që ka humbur entuziazmin dhe i drejtohet me këto fjalë:

“O ti që nuk ke përbrenda asgjë prej dëshirës, mallëngjimit dhe hallit. A e di se çfarë na ka bërë shekulli ynë? Shekulli ynë na bëri të huaj për njëri-tjetrin. Na privoi prej dritës së Mustafait. Kur dashuria për të u fshi nga zemrat, ato u kthyen në pasqyra që u ka ikur ndriçimi. Sa fatkeq është ai popull që bëhet kurban i mendimeve dhe ideve të tjerëve. Puna e tij është të shkatërrojë veten dhe të rregullojë të tjerët. Ai që ka lindur në harem, shkon e bëhet ithtar i kishës, duke njoollur nderin dhe namusin tonë. Madje, me tullat e Qabesë bën edhe kishën.”

Shërimi i të sëmurit, varet nga përdorimi i ilaçeve sipas përshkrimit. Përveç kësaj, morali është ilaçi i parë për t’u shëruar. Ai që nuk beson se do të shërohet, nuk shërohet. Le t’i vëmë veshin Ikbalit, i cili e ndjen hallin e të sëmurit më tepër se të sëmurët:

“Ki parasysh shekullin në të cilin jetojmë dhe ringjalle shpirtin e Omerit. Kalo prej shkretëtirës, qytetit e malit dhe vendose çadrën në pronën tënde. Mprehe veten si shpatë. Pastaj hidhu në prehrin e kaderit. Mprehe veten, sepse esenca jote nuk është e keqe.”

Sytë e botës islame dhe të gjithë botës, janë tek Umeti që Kurani e ka përkufizuar “Umeti më i mirë, më i ekuilibruar dhe dëshmitar”. Xhemati pret imam, karvani pret udhërrëfyes.





A ka NJERI që dëshiron të më KUPTOJË?

Miku im!

Nëse e ke përzemër veten,

nëse dëshiron ta ndihmosh veten,

nëse dëshiron të jesh i lumtur, i suksesshëm, i fuqishëm, me dinjitet dhe i lirë,

nëse nuk do të humbasësh kohë me provë-sprovë, por dëshiron të përfitosh prej përvojës së të tjerëve,

atëherë dëgjo me të pesë shqisat, me mendjen, zemrën dhe me shpirtin tënd!

Këshilla e parë është të dish të njohësh veten në mënyrë të drejtë.

Je duke u përpjekur të gjesh rrugën në një qytet, por nëse nuk e di se ku je në hartë, nuk e di edhe se ku do të ikësh. Në të njëjtën mënyrë, nëse nuk e njeh veten në mënyrë të drejtë, vendimet që do të marrësh më vonë nuk do t'i shërbejnë qëllimit tënd. Jeta të kalon përmes rrugicave dhe rastësitë drejtojnë jetën tënde.

Njeriu që njeh veten, i vlerëson drejt anët e tij të forta, dobësitë, mundësitë, aftësitë, shanset dhe rreziqet. Të mund të vëzhgosh veten dhe të bësh analiza të drejta, nuk është talent i lindur, por një aftësi që duhet mësuar.

Synimi yt le të jetë piramida!

Në majë duhet të vendosësh synimin tënd më të rëndësishëm, çështjen tënde më parësore!.. Prioritetet duhet t'i vendosësh sipas radhës së rëndësisë dhe në vendimet që do marrësh, duhet t'i testosh gjithmonë këto prioritete. Për të mos rënë në pengesat, joshjet dhe kurthet e kënaqësive që të dalin përpara në rrugën drejt synimit, këtë dosje duhet ta mbash gjithmonë të hapur në trurin tënd.

Truri ynë programon veten e tij. Nëse jemi shoferë, e mendojmë dhe e planifikojmë se ku duam të shkojmë që para se të hipim në makinë dhe të dalim për udhëtim. Më pas mendojmë gjëra të tjera. Ndërkohë që jemi duke menduar, truri ynë në mënyrë automatike na çon në vendin ku dëshirojmë. Ata që e programojmë saktë trurin që në fillim, janë njerëz që i kanë përcaktuar synimet e jetës, qofshin ato afatshkurtra apo afatgjata. Njerëz të tillë u japim drejtim ngjarjeve. Ndërsa njerëzit që nuk kanë qëllim drejtohen prej ngjarjeve. Synimet në majë, duhet të jenë abstrakte. Për shembull, çfarë njeriu dëshiron të jesh, çfarë dëshiron të shkruhet në gurin e varrit tënd, etj?

Planifiko të ardhmen tënde!

Pas përcaktimit të synimit, duhet të kesh një har-të për rrugën e jetës. Ndërkohë që përgatit hartën e rrugës tënde, bëj kujdes nga kurthet e detajeve. Edhe suksesi, edhe shejtani janë fshehur në detaje... Detajet që nuk i shërbejnë qëllimit, mund të jenë të këqija. Ndërsa detajet që i shërbejnë qëllimit, të pengojnë nga gabimet dhe të ndihmojnë në marrjen e vendimeve të duhura.

Ndërkohë që skicon hartën e rrugës tënde dhe bën planin e lëvizjes, mendo të marrësh shembuj dhe modele, por mos harro të jesh vetvetja. Gjatë skicimit të hartës, duhet të arrish të marrësh diçka prej çdo luleje, ashtu si bleta. Familja jote, rrethi shoqëror, mësuesit, prijësit fetar e kulturor, duhet të jenë burime nga ky frymëzohesh.

Projektin bëje me pasion!

Gjëja më e rëndësishme që e motivon dhe e vë në lëvizje njeriun, është një projekt real i bërë me pa-sion. Mbajtja në këmbë e shpresës, është e mundur në sajë të projekteve konkrete dhe abstrakte për të cilat ia vlen të jetosh. Forcimi i vetëbesimit arrihet me anë të idealeve. Vetëm kështu mund të arrish ekuilibrin idealist, aktivist dhe realist.

Duro vështirësitë për të arritur suksesin!

Në anglisht është një fjalë që thotë: “No pain no gain!”. Pra, “Nëse s’ka vuajtje, s’ka as fitim!”. Jeta shpërblen vetëm ata që durojnë vështirësitë. Nëse dëshiron të ecësh ballëllartë dhe të jetosh me nder, duhet të përpiqesh të fitosh me punë.

Bëhu i ndjeshëm!

Studimet neurologjike kanë vërtetuar se ndjenjat janë një kategori shkencore. Në bazë të paradigmeve të ndryshueshme në psikologjinë e komunikimit, 70-80% të komunikimit nuk është verbal. Në sajë të tonit të zërit, shikimeve, mimikës dhe gjeleve, mund të transmetosh informacione emocionale duke krijuar komunikim me njerëzit e tjerë. 20-30% e komunikimit është informativ, pra ka lidhje me fjalët dhe kuptimet e transmetuara. Shkaku i autizmit, është moszhvillimi i alfabetizimit emocional në tru. Komunikim empatik, do të thotë alfabetizëm emocional. Emocionet sociale dhe forca e ndikimit kanë lidhje me zhvillimin e alfabetizimit emocional.

“Neuronet reflektuese”, që funksionojnë si internet pa kabull në trurin e njeriut, janë qelizat nervore që perceptojnë emocionet e forta. Qelizat e trurit njerëzor, punojnë si gjeneratorë të vegjël dhe gjatë prodhimit të elektricitetit, ofrojnë edhe frekuen-cat e ndjenjave dhe mendimeve në formë valësh. Neuro-filozofia, neuro-teologjia, neuro-ekonomia dhe neuro-marketingu, tashmë ndodhen në rrezen e shkencës. Në vitin 2002, çmimin Nobël në ekonomi e mori një psikolog. Tema e tij, ishte “Faktorët psiko-logjikë në administrimin e krizës”. Sot jetojmë në një kohë kur është vërtetuar shkencërisht se emocionet ndikojnë në ekonomi. Tashmë paradigma se “*mendja është gjithçka*”, ka ndryshuar.

Emocionet mendoji në formë gjashtë dimensionale.

Zhvillimi i vetëdijes emocionale nuk është aspak i lehtë. Nëse nevríkoseni në një çështje, do të thotë se ju keni nevojë për një mendim që ju nevríkosi. Pasi t’i keni analizuar me zgjuarsia emocionet, është shumë e lehtë t’i administrosh ato.

Emocionet mund t’i administroni duke i menduar në formë gjashtë dimensionale. Mendoji ato në di-mensionet para-mbrapa, majtas-djathtas dhe poshtë-lart. Nëse analizon mirë të ardhmen-të shkuarën, anën e fortë, anën e dobët, mundësitë dhe rreziqet, mund të vendosësh më lehtë se në cilën anë do të drejtohesh.

Formo vlera etike!

Bëhu i sinqertë, i përzemërt, i hapur dhe i natyr-shëm!

Duaji njerëzit, vlerësoji dhe ndaj me ta!

Bëhu i ndershëm, punëtor dhe besnik i fjalës!

Bëhu i drejtë dhe ndarës!

Mendohu, a është më mirë të jesh interesaxhi apo i virtytshëm! Ndërkohë që interesaxhinjtë dalin të fituar në kohë afatshkurtra, të virtytshmit dalin gjithmonë të fituar në kohë afatmesme dhe afatgjata. Në betejat midis të mirëve dhe të këqijve, në fillim fitojnë të këqijtë, ndërsa të mirët fitojnë gjithmonë në fund.

Kujdes kur të madhërosh pasurinë!

“Mbaje në dorë, por jo në zemër!”- thotë Rumi. Zotëro shumë gjëra, por mos lejo të të zotërojnë ato. Nëse nuk harron se paraja nuk është qëllim,

por mjet, pasuria, kamja, fama dhe pozita do të të shërbejnë. Por, nëse i vendos në qoshe të zembrës kënaqësitë dhe pasuritë e përkohshme, atëherë ato do të fillojnë të të drejtojnë.

I pasur nuk është ai që zotëron shumë, por ai që ua di vlerën atyre që zotëron. Pasuria e vërtetë, është ajo e qëndrueshmja. Tregtia fitimprurëse për të arritur një kapital social dhe psikologjik, është një lloj pasurie. Pasurimi në dy fusha, konkrete dhe abstrakte, është pasuria më e mençur dhe më e dobishme.

Formo vlera estetike!

Tek njerëzit ekziston dashuria për të përsosurën dhe të bukurën si një prirje gjenetike. Një nga qëllimet e ekzistencës së njeriut, është ta bëjë botën të bukur dhe të jetueshme. Armiku më i madh i vlerave estetike, është ekzagjerimi. Makijazhi i ekzagjeruar dhe veshja ekstravagante mund të tërheqin vëmendjen, por nuk janë estetike. Botëkuptimi yt estetik duhet të jetë në përputhje me pozitën tënde.

Mos shko pas kulturës dominuese!

Ata që modernizohen duke ruajtur identitetin e tyre kulturor, janë si ata që zhvillohen duke ruajtur personalitetin e tyre. Ata që e ruajnë identitetin dhe personalitetin e tyre, nuk mund asimilohen. Ata që i japin rëndësi gjuhës së vet, janë më të suksesshëm edhe në ruajtjen e kulturës. Shoqëritë që kanë qëllime kombëtare, që e njohin historinë dhe kulturën e vet, përbëhen prej individëve me ideale, personalitet dhe që janë krenarë me të kaluarën e tyre identitare. Ndrysho, por mos u tjetërso!

Bëhu novator!

Të bëhesh novator është shumë e rëndësishme! Studimet shkencore kanë vërtetuar se personat që janë të hapur ndaj përvojave të reja, janë edhe më me fat. Frika për të rrezikuar, pengon edhe zhvillimin. Vendosja e ekuilibrit midis lëvizjeve të sakta dhe mos bërjes së gabimeve është shumë e rëndësishme.

Të rrezikosh për të bërë gjënë e duhur, është më etike, më e vlefshme dhe më e rëndësishme se sa të mos rrezikosh fare për të mos bërë gabime. Të bësh gjëra të reja dhe të ndryshme, bazohet në të vërtetë të sigurt. Bëhu novator, por jo aventurier. Ata që kanë frikë nga bërja e gjërave të reja, bëjnë gabimin e të bërit asgjë dhe për rrjedhojë, as nuk përparojnë dhe as nuk e zhvillojnë mendimin. Si përfundim, ata mbesin skllëvër të së shkuarës.

Njih kodin e memories së fortë!

Përdorimi i gjashtë rojeve të memories është i domosdoshëm. Këto gjashtë roje, janë pyetjet: “Kush, çfarë, ku, kur, si, pse?”. Ushtrimi i mendjes me këto pyetje, përbën sekretin e një memorieje të fortë. Gjithashtu, ato sigurojnë përvetësimin dhe qëndrueshmërinë e informacioneve të fituara.

Ji i lirë, por ki besim tek njerëzit!..

Fitorja jote e parë, duhet të jetë ajo kundër dëshirave joshëse. Liria e vërtetë, është të jesh i lirë në dëshirë. Rendja pas synimit të plotësisht të dëshirave dhe kënaqësive personale, ishte paradigma e vjetër e psikologjisë. Shemb muret dhe thyje zinxhirët, por mos u bëj skllav i kënaqësive. Mos u bëj si anije me vela por si anije me motor. Pra, mos të të drejtojnë të tjerët, por të drejtosh veten.

Ki besim tek njerëzit, por mos lejo të përdosh. Besimi të jetë rregull, mosbesimi përjashtim. Siç shprehet edhe Nejzeni: “*Ngrihuni o patriotë thamë, u ngritëm! Por ç’të shohim, në vendin nga ku u ngritëm ishin ulur të tjerët!*”

Me miqtë ndaj gjithçka, ndërsa me armiqtë vetëm rregullat. Të mirës përgjigju me të mirë, të keqit mos i bëj mirë, sepse e ushqen. Mos bëj padrejtësi goftë edhe ndaj të keqit, sepse gabimi me gabim nuk korrigjohet.

Grumbullo kapitalin tënd shoqëror!

Përndimi tani i ka zbuluar ndjenjat sociale. Ata flasin për arritjen e lumturisë duke treguar empati. Studimet lidhur me trurin social nxorën në pah rëndësinë e shtimit të kontaktit social për arritjen e shëndetit shpirtëror dhe trupor.

Pikësëpari gjallëro vlerat e kulturës së Lindjes, që ende vazhdojnë, si solidaritetin, ndarjen me të tjerët dhe dhurimin. Po ashtu, kujdesu edhe për të afërmit e tu. Duhet të bësh projekte lidhur me përgjegjësinë sociale.

Ne na ngrenë ato që japim, jo ato që marrim. Pra, shtojë kapitalin shoqëror që punon për të dhënë, e jo për të marrë. Suksesi arrihet kur jep, jo kur merr. Solidariteti është një nga gjuhët e dashurisë. Kjo është dashuria që tregohet me sjellje. Kjo është dashuri me zemër, jo me fjalë. Të kesh zemër të mirë, është shumë më e rëndësishme se të jesh i përsosur. Puno shumë për të shtuar besimin social. Sillu miqësisht me njerëzit, bëhu dëgjues i mirë dhe mbaji premtimet.

Suksesi është në përpjesëtim të drejtë me besimin e rrethit tënd shoqëror.

Dy pjesët më të këqija dhe të mira të njeriut



Një ditë i urti Llokman së bashku me një nxënës të tij doli për gjah. Gjatë kthimit një prijës i një fisi i ftoi të qëndronin për darkë në shtëpinë e tij. Llokmani pranoi të qëndronte atë natë aty. Prijësi i fisit theri një dash për Llokmanin. Llokmani i tha nxënësit: “Shko dhe sill dy pjesët më të mira të kafshës!” Nxënësi shkoi dhe u kthye me gjuhën dhe zemrën e dashit në dorë.

“Të lumtë!”, i tha Llokman Hakimi, “e gjete.”

Një ditë tjetër, kur bujtën në shtëpinë e një fisi tjetër, Llokmani i tha përsëri nxënësit t’i sillte dy pjesët më të këqija.

Nxënësi shkoi dhe solli përsëri gjuhën dhe zemrën.

“Të lumtë!”, i tha Llokman Hakimi, “përsëri e gjete.”

Në të vërtetë, pjesët më të këqija dhe të mira të njeriut janë gjuha dhe zemra.

“ NJË LUTJE ”

“I kërkoj mbrojtje Allahut, me fjalët e tij të plota, nga zemërimi i Tij, nga e keqja e robërve të Tij, nga vesveset e shejtanëve dhe nga ardhja e tyre te unë!”

(Ebu Davud, Tîb, 19)

“ AFORIZËM ”

“Pasuria i ngjason ujit të detit: sa më shumë të pish, aq më shumë etje ke.”

Arthur Schopenhauer

FAKTE INTERESANTE

* Pirja e ujit ka efekt parandalues ndaj paralizës dhe krizës në zemër.

* Marsi bën pjesë tek planetët që shikohen nga toka me sy të lirë. Kur është afër tokës mund të shikohet shumë qartë. Ngjyra e tij është e kuqe.

* Milingonat kanë dy stomakë, në njërin stomak ruajnë ushqimin për vete, kurse në stomakun tjetër depozitojnë ushqimin që do të ndajnë me milingonat e tjera.



10 përgëzime

për atë që e fal namazin e sabahut me xhemat

PËRGËZIMI I PARË

Drita e plotë në Ditën e Gjykimit. Prej atij momenti që namazliu del nga shtëpia e tij, e rrethojnë përgëzimet nga të gjitha anët. Pejgamberi (a.s.), ka thënë: “Përgëzoi ata të cilët ecin nëpër errësirë për në xhami me një dritë (nur) të plotë në Ditën e Kiametit.”¹

PËRGËZIMI I DYTË

Ky namaz ka vlerë më të madhe sesa e gjithë bota dhe çfarë ka në të. Pejgamberi (a.s.), ka thënë: “Dy rekatet e sabahut (sunet) janë më të vlefshme se e gjithë bota dhe çka ka në të”.²

PËRGËZIMI I TRETË:

Përfitimi i të mirave. Kur njeriu ulet dhe pret namazin, ai është në namaz. Pejgamberi (a.s.), ka thënë: “Kush del nga shtëpia e tij për në xhami, për çdo hap që bën atij i shënohen dhjetë të mira. Ai që ulet në xhami që ta presë namazin është sikurse ai që bën namaz dhe regjistrohet si namazli, derisa të kthehet në shtëpinë e tij”.³

Kush nuk e fal namazin e sabahut me xhemat humb shumë shpërblime e të mira të mëdha, si: të mirat e dy rekateve para namazit të sabahut, shpërblimin e hapave për në xhami, shpërblimin e leksimit të Kuranit derisa të thirret ikameti për namaz, shpërblimin e pritjes së namazit në xhami deri në ikamet. E nëse llogarit të gjitha këto të mira, do të

bëhen me miliona, ngase një e mirë shpërblehet me dhjetë të mira.

PËRGËZIMI I KATËRT:

Dëshmia e melekëve. Allahu i Madhëruar thotë: “Kryejë namazin prej kthimit të Diellit (nga gjysma e qiellit) deri në errësirën e natës dhe këndo Kuran në agim; me të vërtetë, falja e mëngjesit është e dëshmuar (nga engjëjt)”.⁴ Pejgamberi (a.s.), ka thënë: “Tubohen melekët e natës dhe melekët e ditës në namazin e sabahut”.⁵

PËRGËZIMI I PESTË:

Hyrja në xhenet dhe shpëtimi nga xhehenemi. Pejgamberi (a.s.), ka thënë: “Nuk do të hyjë në zjarr ai që falet para lindjes së diellit dhe para perëndimit.”⁶ d.m.th. në namazin e sabahut dhe të ikindisë. Pejgamberi (a.s.), ka thënë: “Kush e fal namazin e sabahut dhe të ikindisë (berde tejni), hyn në xhenet”.⁷

PËRGËZIMI I GJASHTË:

Shikimi i Allahut (xh.sh.). Shpresohet se ai që kujdeset për faljen e namazit të sabahut dhe të ikindisë do të fitojë shikimin e Allahut të Madhëruar. Transmetohet nga Xherir bin Abdullahu (r.a.), se ka thënë: “Ishim te Profeti (a.s.), një natë, shikoi hënën e plotë dhe tha: “Ju do shihni Zotin tuaj ashtu siç po e shihni këtë hënë, nuk do të keni asnjë lloj vështirësie në

1. Ebu Daudi, Tirmidhiu.

2. Muslimi.

3. Ahmedi.

4. Isra, 78.

5. Muttefekun alejh.

6. Muslimi.

7. Muttefekun alejh.

shikimin e Zotit. Nëse mundeni që mos t'ju habisë djalli nga namazi (ta anashkaloni atë) para lindjes së diellit dhe para perëndimit të tij, faleni atë (dhe largojuni intrigave të djajve).” D.m.th. namazin e sabahut dhe të ikindisë. ⁸ Pastaj lexoi ajetin: **“Maddhëroje Zotin tënd e falënderoje Atë para lindjes së diellit dhe para perëndimit.”** ⁹

Hafidh ibn Haxheri, Allahu e mëshiroftë, thotë: “Kanë thënë dijetarët: ‘Arsyeja e përmendjes së këtyre dy namazeve me tregimin e shikimit të Allahut është ngase namazi konsiderohet nga adhurimet më me vlerë. Është vërtetuar se këto dy namaze janë të vlefshme se në këto dy namaze bashkohen melekët, ngrihen veprat etj.’

PËRGËZIMI I SHTATË:

Arritja e shpërblimit të namazit të natës. Nga Uthman bin Afani (r.a.), transmetohet se ka thënë: “E kam dëgjuar Pejgamberin (a.s.), duke thënë: ‘Kush e fal namazin e jaxisë me xhemat ka shpërblim sikur të falej gjysmën e natës, ndërsa kush e fal namazin e sabahut me xhemat ka shpërblim sikur të falej tërë natën.” ¹⁰

PËRGËZIMI I TETË:

Duaja e melekëve. Nga Ali bin Ebi Talibi (r.a.), transmetohet se ka thënë: “E kam dëgjuar Pejgamberin (a.s.), duke thënë: “Kush e fal namazin e sabahut pastaj qëndron në xhami, për të luten melekët.” Duaja e tyre për të është: “O Allah, fale atë, O Allah mëshiroje atë!” ¹¹

PËRGËZIMI I NËNTË:

Arritja e shpërblimit të haxhit dhe umres. Pejgamberi (a.s.), ka thënë: “Kush e fal sabahun me xhemat pastaj ulet dhe e përkujton Allahun derisa dielli të lindë, e pastaj fal dy rekate, ai fiton shpërblimin sikur të ketë kryer haxh dhe umre të plotë, të plotë, të plotë” ¹²

PËRGËZIMI I DHJETË:

Mbrojtja e Allahut (xh.sh.). Pejgamberi (a.s.) ka thënë: “Kush e fal namazin e sabahut, ai është në mbrojtjen e Allahut. Të mos marrë guximin askush ta cenojë këtë mbrojtje të Allahut (duke e sulmuar këtë njëri) me asgjë, ngase kush e merr guximin ta cenojë këtë mbrojtje, Allahu do të hakmerret ndaj tij e më pas e hedh me fytyrë në zjarr të xhehenemit.” ¹³

8. Muttefekun alejh.

9. Kaf, 39.

10. Muslimi.

11. Ahmedi.

12. Tirmidhiu.

13. Muslimi.



Jeta e yjeve dhe VRIMAT E ZEZA

— *Elsad Cukali* —

Universi ynë është i mbushur me galaktika gjithandej. Galaktikat në vetvete janë të përbëra nga miliarda e miliarda yje. Si çdo gjë tjetër në univers, edhe yjet kanë fundin e tyre. Ato kanë përmasa dhe madhësi nga më të ndryshmet, ku si masë standarde po marrim masën e Diellit. Nëse një yll ka masë deri në 1.4 herë më të madhe se masa e Diellit, që ndryshe quhet edhe limiti i Chandrasekhar-it, fundi i tij do jetë shumë i bukur.

Të gjitha yjet janë në ekuilibër termodinamik, ose me fjalë të tjera trysnia e gazeve në Diell që synon nga jashtë balancohet nga forca tërheqëse gravitacionale e Diellit. Pasi një sasi e konsiderueshme e masës së yllit të jetë transformuar në energji sipas ekuacionit të famshëm të Ajnshtajnit, $E=mc^2$, forca gravitacionale tërheqëse e yllit drejt qendrës së rëndesës së tij do dobësohet aq shumë saqë trysnia e gazeve të po atij ylli do zmadhohet gradualisht në raport me forcën tërheqëse. Si pasojë e saj, në hapësirë do ketë një shpërndarje gazesh dhe jonesh gjithandej në hapësirë.

Për shkak se Dielli ndodhet brenda këtij limiti, llogaritet se ai do fryhet aq shumë, saqë sipërfaqja e tij do mbërrije deri mbi kokët tona, madje do e tejkalojë këtë distancë! Në këtë mënyrë, i gjithë Dielli do të shpërndahet nëpër qiell duke formuar një re shumë të madhe që quhet nebulozë planetare dhe që nga larg do duket me ngjyra shumë të bukura. Ajo çfarë do të ngelet nga Dielli është vetëm një bërthamë e shndritshme me përmasa sa Toka. Ky objekt qiellor në gjuhen shkencore quhet xhuxhi i bardhë.

Përmbajtja kimike i këtij objekti është karbon i ngjeshur, ose me fjalë të tjera diamant. Pas ca miliona viteve kur ky objekt qiellor të jetë ftohur, ai do shndërrohet në një objekt të zi që emërtohet xhuxhi i zi. Nëse një yll ka masë më të madhe sesa limiti i Chandrasekhar-it, atëherë ylli do evoluojë në një drejtim tjetër. Për shkak se ylli ka masë të madhe, në brendësi të tij temperatura është aq e madhe saqë

fillojnë të formohen edhe elemente të rënda si Kalciumi, Kaliumi, metale etj. Bërthama e yllit gradualisht bëhet më e dendur, ajo e tkurr yllin deri në atë pikë, saqë në një moment ylli shpërthen me një shpërthim spektakular që quhet supernova. Astronautët e lashtë kinezë me datën 4 Korrik 1054 vërejtën në qiell një yll shumë të shndritshëm që u shfaq papritmas dhe pas ca ditëve u zhduk. Ylli i mistershëm ishte aq i shndritshëm saqë dukej edhe ditën.

Ajo çfarë ka ngelur sot nga ai yll i mistershëm që u zhduk papritmas është një nebulë e mahnitëse që quhet Nebula Krab dhe nuk është gjë tjetër dhe nuk është gjë tjetër veçse një mbetje e një supernove. Nëse masa e një ylli do ishte shumë më e madhe, e cila cilësohet dikund pesë herë më e madhe sesa masa e Diellit, atëherë tkurrja e yllit do vazhdoje e do vazhdojë derisa përmasat e tij të arrijnë një limit që quhet limiti i Schwarzschild. Në këtë stad, nga sipërfaqja e yllit të tkurrur nuk mund të largohet asgjë, madje as vetë drita.

Për pasojë ky objekt do dukej i zi, pasi asgjë nuk mund të arratiset nga ai. Për shkak se forca gravitacionale në këtë objekt të zi është tmerrësisht e fuqishme, tkurrja e tij do vazhdojë derisa e gjithë materia që ndodhet në të, përqendrohet vetëm në një pikë pa dimensione që fizikanët e quajnë, pika singulare. Dendësia në pikën singulare ka vlerë infinit. Sipas teorisë së përgjithshme të relativitetit të Ajnshtajnit, koha në këtë zonë ndalon. Ajnshtajni ka nxjerrë një ekuacion matematikor në të cilën kuptohet qarte se koha tek njerëzit që ndodhen në sipërfaqen e Tokës ecën më ngadalë sesa koha tek astronautët që ndodhen atje lart! Si provë që kjo teori është e saktë, kemi rastin e satelitëve që përdorin sistemin GPS.

Në qofte se nuk do merrej parasysh ky shkurtim kohe, nuk do mund të përcaktonim me saktësi vendndodhjen tonë në hartë si dhe nuk do kishim një komunikim të mirëkoordinuar. Për të pasur idenë sesi formohet një vrimë e zeze, imagjinoni planetin Tokë

të shtypur derisa të tkurret dhe të arrijë përmasat e një kikiriku. Në këtë stad objekti i formuar është një vrimë e zezë.

STRUKTURA E NJË VRIMË TË ZEZË

Të gjitha vrimat e zeza kanë një strukturë shumë të thjeshtë. Shekullin e kaluar Stephen Hawking dhe Roger Penrose nxorën një teoremë të tyre e cila në thelb pohon që përreth çdo pike singulare në një distancë sa rrezja e Schwarzschild-it egziston një sipërfaqe që quhet kufiri i vrimës së zezë. Secila vrimë e zezë posedon këtë sipërfaqe. Në atë pjesë asgjë, madje as drita vetë nuk mundet të arratiset. Çdo gjë që bie brenda kësaj sipërfaqeje humbet plotësisht kontaktin me pjesën tjetër të universit. Megjithatë, ekuacionet e Ajnshtajnit na përshkruajnë një fenomen të çuditshëm. Kur një objekt arrin tek pika singulare, ai mund të arrijë në çdo pjesë tjetër të universit përmes hapjes së një ure lidhëse midis pikës singulare dhe universit.

ÇFARË NDODH BRENDË VRIMËS SË ZEZË?

Për të kuptuar se çfarë ndodh brenda një vrimë të zezë le të imagjinojmë dy astronautë. Njëri prej tyre nisat drejt vrimës së zezë. Vëzhguesi jashtë vrimës së zezë do e vërejtë kohën e astronautit që është drejt vrimës së zezë të ecin ngadalë e më ngadalë, ngjyra e tij do të bëhet e kuqe si pasojë e një efekti që quhet efekti Doppler. Pasi astronauti e tejkalon kufirin e vrimës së zezë ai do zhduket njëherë e përgjithmonë nga sytë e vëzhguesit, ndërkohë që ai e sheh normal vëzhguesin. Për shkak se këmbët e astronautit janë më afër vrimës së zezë sesa koka e tij, vrima e zezë do e tërheqë atë derisa trupi i tij të degradohet deri në atome sa i gjithi të arrijë tek pika singulare e të kalojë në një pikë pa dimensione. Nëse astronauti do mbërrinte shëndosh e mirë ne pikën singulare, ai nuk do mundet të lëvizë më pasi kufizohet hapësira që njohim ne, nuk është më hapësirë tre dimensionale, dhe ç'është më e rëndësishme ai do ketë mundësi të lëvizë lirisht nëpër kohë. Astronauti do ketë mundësi të udhëtojë lirisht në të shkuarën ose në të ardhmen ashtu sikur lëvizim ne nëpër hapësirën tonë tre dimensionale.

NGA E DIMË SE VRIMAT E ZEZA EKZISTOJNË?

Astrofizikanët dikund nga vitet 70 po studionin një yll të çuditshëm në qiell dhe që e quajtën Cygnus X-1. Në përgjithësi yjet nuk lëshojnë një sasi të konsiderueshme të rrezeve X. Pas shumë studimeve u arrit në përfundimin se nuk ishte ylli ai që lëshonte këto rreze X por një vrimë e zezë që kishte masë të paktën gjashtë herë më të madhe se masa e Diellit. Shkaku i emetimit të rrezeve X ishte se vrima e zezë po thithte material nga ylli i vet shoqëruar aq shpejt saqë gazet fërkohen me njëra tjetrën dhe temperatura e tyre të arrijë milion e miliona gradë gjë e cila

shpie në formimin e rrezeve X. Kjo ishte një provë e qartë që vrimat e zeza ekzistojnë. Një tjetër provë në lidhje me vrimat e zeza është edhe një pamje që vjen nga qendra e galaktikës sonë dhe që mendohet se e njëjta gjë ndodh edhe në galaktikat e tjera. Edhe pse vrimat e zeza nuk shihen, nuk duhet të harrohet se efekti i saj gravitacional është i dukshëm qartë. Në qendër të galaktikës sonë vërehen disa grupe yjesh që vërtiten rreth një qendre të padukshme me një shpejtësi marramendëse. Kjo qendër e padukshme nuk është gjë tjetër veçse një vrimë e zezë supergjigande. Ekuacionet e Njutonit tregojnë se masa e kësaj vrimë supergjigande është të paktën një milion herë më e madhe sesa masa e Diellit!

ROLI I VRIMAVE TË ZEZA

Edhe pse vrimat e zeza duken të frikshme, ato kanë një rol thelbësor në formimin e galaktikave. Në qoftë se nuk do ekzistonin vrimat e zeza, as ne nuk do kishim ekzistuar!

Në përgjithësi vrimat e zeza që janë në qendër të galaktikave pengojnë formimin e yjeve të stërmëdhenj, e mbrojnë galaktikën nga shpërbërja duke kontrolluar numrin e yjeve që ndodhen në të. Roli më thelbësor i vrimave të zeza është riciklimi i universit. Ata janë pastrueset e kozmosit tonë, për këtë le të mësojmë rrezatimet Hawking.

RREZATIMI HAWKING

Stephen Hawking u mundua ta aplikonte fizikën kuantike tek vrimat e zeza dhe zbuloi diçka të mrekullueshme, që sot mban mbiemrin e tij “Rrezatimi Hawking”. Sipas tij asnjë pjesë në univers nuk është bosh, për të fjala boshllëk nuk ka kuptim. Në çdo pjesë të universit në një fraksion tepër të shkurtër kohe formohen njëkohësisht materie dhe antimaterie që ndryshe quhet “luhatje kuantike”. Antimateria ka një veti që kur bashkohet me materien shkatërrojnë njëra tjetrën. Në kufirin e vrimës së zezë, formohet edhe materie edhe antimaterie. Sipas Hawking, antimateria bie në vrimë të zezë dhe duke u bashkuar me materien që ndodhet atje e shkatërron atë dukë shkaktuar avullimin e vrimës së zezë në një rrezatim valësh elektromagnetike. Ky lloj rrezatimi që vjen nga vrima e zezë quhet rrezatimi Hawking. Ky fakt na lë të kuptojmë se vrimat e zeza avullojnë dhe nuk janë aq të zeza sa kanë emrin. Pas një farë kohe, i gjithë material i thithur nga vrimat e zeza riciklohet përsëri dhe hidhet në univers në formë rrezatimi. Deri tani ky lloj rrezatimi akoma nuk është zbuluar eksperimentalisht. Ekuacionet matematikore e vërtetojnë se ekzistojnë dhe ne i besojmë matematikës por gjithsesi shpresojmë që ky rrezatim të zbulohet sa më shpejt dhe zbuluesi i saj Stephen Hawking të marrë çmimin Nobel sa është gjallë.



Trëndafili i egër, MREKULLIA E NATYRËS

Kokrrat e trëndafilit të egër kanë një përdorim të gjërë mjekësor. Ato janë të pasura me vitamina, acide yndyrore, antioksidantë, madje përbëjnë një metodë domethënëse për përfitimin e vitaminës C

Kokrrat e trëndafilit të egër janë nga bimët medicinale me efektet më të fuqishme në organizmin e njeriut. Vetë fruti piqet nga muajve të verës dhe mbledhet në natyrë në muajt e vjeshtës. Trëndafilin e egër e gjejmë në çdo cep të Shqipërisë dhe përdorimi kryesor është ai mjekësor. Kokrrat e trëndafilit të egër më pas thahen dhe janë të gatshme për të përcjellë të gjitha vlerat e tyre të pakrahasueshme tek njerëzit, kryesisht në formën e çajit. Me qindra familje shqiptare e kanë aktivitetet jetësor mbledhjen e trëndafilit të egër, por edhe të bimëve të tjera mjekësore, të cilat pas grumbullimit kanë si destinacion eksportin, por edhe tregun vendas.

Prejardhja

Trëndafili i egër ose Rosa Canina ka vendlindjen në Europë dhe Shqipëria është një nga vendet e bekuara me këtë super bimë. Kjo shkurre e egër është me degë gjëmbore dhe arrin nga 2 në 4 metra lartësi. Ka një rrënjë të gjatë dhe fibroze. Degët e saj çelin lule të bardha ose ngjyrë rozë me nga pesë deri në shtatë petale nga fillimi i pranverës deri në mes të verës. Kokrrat e trëndafilit të egër kanë një përdorim të gjërë mjekësor. Ato janë të pasura me vitamina, acide yndyrore, antioksidantë, madje përbëjnë një metodë domethënëse për përfitimin e vitaminës C. Kokrrat e trëndafilit të egër mund të përdoren për çaj, mund të bëhen reçel ose marmaladë dhe mund të përfshihen në shumë ushqime të tjera. Varianti i tyre i thatë që përdoret në çaj është kryesisht më popullori.

Vlerat shëndetësore

Janë plot me antioksidantë, këto kokrra që kanë përmasat e qershive janë thesari i vërtetë që trëndafilat e fundit të verës u dhurojnë njerëzve. Zakonisht i gjejmë në ngjyrë të portokalltë dhe të kuqe. Ato janë të pasura me vitaminë C që është një antioksidant i fortë. Ato përmbajnë karotenoidë dhe substance të tjera bioaktive. Shkencëtarët hungarezë testuan gjashtë antioksidantët e gjetur tek trëndafili i egër: beta-karotenin, luteinën, likopenin, neokromin, rubiksanthinë dhe zeaksanthinën. Të gjithë këto substanca rezultoi që kishin vlera të mëdha, për gjithësecili prej tyre kishte një karakteristikë që e veçonte nga tjetri. Sipas shkencëtarëve përzierja e këtyre antioksidantëve tek trëndafili i egër ofronte avantazhe të shumta shëndetësore.

Sëmundjet

Parandalon diabetin. Ekspertë të bimëve mjekësore në Turqi e kanë përdorur shpesh trëndafilin e egër për të trajtuar sëmundje të diabetit. Shkencëtarët në Universitetin Gazi kryen disa eksperimente tek minjtë për të ekzaminuar rolin e trëndafilin të egër në parandalimin e këtyre simptomave dhe vunë re që ekstrakti i ethanolit tek trëndafili i egër shërben si antioksidant, hipoglicemik dhe anti-diabetik. Rezultatet e eksperimenteve i bënë ekspertët më optimist për përbërësit e trëndafilin të egër dhe vlerat e tyre kundër diabetit.

Parandalon melanomën e lëkurës. Kur lëkura e njeriut lëndohet nga rrezet e tepërta të diellit, krijohet terren për melanomën, që është një nga sëmundjet kancerogjene më të rrezikshme të lëkurës. Sipas shkencëtarëve japonezë përbërësit e trëndafilin të egër kanë një efekt pengues ndaj enzimës dhe ndaj procesit të prodhimit të qelizave kancerogjene. Quercetina për shembull e cila gjendet në sasi të larta tek trëndafili i egër shërben si armë e fortë në luftën kundër melanomës.

Vlera anti-inflamatore. Një grup shkencëtarësh Italianë zbuluan që se trëndafili i egër mund të përdoret me sukses në terapitë kundër artritetit dhe inflamacioneve të tjera. Shkencëtarët panë që efektet anti-inflamatore të ekstrakteve të trëndafilin të egër ishin të ngjashme me indomethacinën, një ilaç farmaceutik mjaft i fuqishëm ndaj inflamacionit.

Ndihmon punën e zemrës. Trëndafili i egër përmirëson shëndetin e zemrës tek pacientët obezë. Sipas të dhënave, trëndafili i egër ul nivelin e tensionit të gjakut dhe kolesterolin e keq. Si rrjedhojë trëndafili i egër ul shanset për sëmundjet vaskulare dhe vdekje si pasojë e këtyre sëmundjeve.


Trajton problemet e lëkurës. Përdorimi i ekstrakteve të trëndafilin të egër është mjaft i mirë në trajtimin e disa problemeve të lëkurës. Vajrat e trëndafilin të egër janë terapeutike. Shuajnë njollat e lëkurës, e hidratojnë atë dhe zbut shenjat në lëkurë.

Trajton çrregullimet në stomak. Trëndafili i egër mund të përdoret për të trajtuar sëmundjet e stomakut, spazmat, iritimet dhe ulcerat. Kryesisht është përdorur si një tonik për stomakun dhe për tretjen. Ai ka qetësuar dhe trajtuar probleme dhe simptoma si diarea, zorrët, fshikëzën e urinës dhe infeksionet në traktin urinar.

Forcon sistemin imunitar. Trëndafili i egër është një nga elementët që duhen përdorur në mekanizmat mbrojtës të trupit. Parandalon infeksionet bakteriale dhe virale. Lufton temperaturën, forcon funksionet imunitare, lodhjen, rrit qarkullimin e gjakut në gjymtyrë, rrit fluksin e qarkullimit të ujit në trup dhe shuan etjen.

Studimet

Shumë studime janë bërë tek njereëzit mbi peshë (që sipas Organizatës Botërore të Shëndetësisë arritën në 1.5 miliardë në të gjithë botën) që kishin nivele të larta të kolesterolit dhe të tensionit dhe zbuluan rolin pozitiv dhe superior të trëndafilin të egër në krahasim me ilaçet farmaceutike për këto dy simptoma. Lufton të ftohtin. Trëndafili i egër ka një përmbajtje të lartë të vitaminës C. Si rrjedhojë mund të përdoret në kurat kundër të ftohtit. Për më tepër trëndafili i egër i vjen në ndihmë gjakut dhe kockave.



Mendo për Ditën,
kur askujt
nuk do t'i bëjë dobi
as pasuria, as fëmijët.
Atë Ditë do të ketë
fund të mirë
vetëm ai që vjen
me zemër të pastër
tek Allahu!”

(Shuara, 88-89)